



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 41/2019 regjistër (JR)
Datë 06.09.2019

Nr. 4 i vendimit
Datë 09.02.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 09.02.2021, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 41 (JR), datë 06.09.2019 që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 4, pika 1, 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 47, 51, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi dhe më pas në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesit ligjor të tij, z. Ardian Leka, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 171, datë 26.06.2019, bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë. Këtë vendim Komisioni e ka mbështetur mbi konkluzionet e arritura në kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të pasurisë, si më poshtë.

1.1 Për kriterin e kontrollit të figurës:

Subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës dhe ka fshehur fakte dhe rrethana të ndodhura para dorëzimit, sipas ligjit të këtij formulari. Subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

1.2 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjete monetare të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera në vitet 2007, 2009 dhe 2014; subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tij dhe është përprjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim të tij; subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e personit tjetër të lidhur, sipas paragrafit 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

2. Komisioni, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arriti në përfundimin se:

(i) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të pasaktë, bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e shkronjës “g” të kreut V “Të dhëna për sigurinë”, si dhe ka fshehur fakte të ndodhura sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

- (ii) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
- (iii) *Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe deklarim të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për burimin e krijimit të këtyre pasurive.*
- (iv) *Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe të pasurisë.*

II. Shkaqet e ankimit

3. Kundër vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, të Komisionit është ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji) nga subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi, i cili kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmim në detyrë.
4. Nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit gjithashtu ka kërkuar shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, duke pretenduar çeljen e hetimit edhe për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, pasi mosvlerësimi i këtij kriteri ka cenuar procesin e rregullt ligjor, si dhe për arsyetimin e drejtë të vlerës provuese të provave të paraqitura prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision.
5. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë si vijon.
 - A. Lidhur me procesin e rregullt ligjor, subjekti në ankim pretendon se:
 - i) *vendimi i marrë nga Komisioni bazuar në shqyrtimin e vetëm 2 (dy) kriterëve, atij të kontrollit të pasurisë dhe të figurës, është në kundërshtim me parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 për zhvillimin e një procesi rivlerësimi të plotë e të gjithanshëm, në pajtim me të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, për pasojë procesi i rivlerësimit është i parregullt edhe në referim të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit nr. 1 të saj;*
 - ii) *vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, pasi gjatë gjithë procesit, u hetua nga e njëjta trupë gjyqësore që mori dhe vendimin;*
 - iii) *vendimi i Komisionit është rezultat i mosmarrjes në konsideratë dhe mosanalizimit të disa prej provave të paraqitura prej subjektit, duke bërë interpretim të gabuar dhe që nuk i përgjigjet realitetit të ndodhur. Vendimi i Komisionit përmban konkluzione, të cilat nuk janë shprehur asnjëherë nga Komisioni, as në fazën e hetimit administrativ e as në seancë dëgjimore publike, si dhe në kundërshtim me një proces të rregullt e objektiv, pasi subjekti nuk është njohur me asnjë akt ekspertimi të kryer dhe as ka mundur të parashtrrojë prapësime apo pyetje mbi konkluzionet e një eksperti;*
 - iv) *edhe nëse supozohet se në pikëpamjen formale qëndrojnë gjetjet e Komisionit, ato kanë të bëjnë me burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave sipas nenit D, pika 3 e Aneksit*

të Kushtetutës dhe jo me pikën 4 të po këtij neni, ku ligjvënësi ka përcaktuar dyfishin e pasurisë së ligjshme, si kufi për t'u prezumuar fajtor për shkelje disiplinore;

- v) *paragjykimi për rezultatin e vlerësimit ka shtyrë Komisionin të kërkojë rivlerësimin e figurës së tij.*

B. Shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës:

- i) *Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e figurës është rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit. Komisioni jo vetëm që nuk ka marrë në konsideratë faktet dhe rrethanat e paraqitura prej subjektit, por ka argumentuar duke pasqyruar në mënyrë jo të drejtë pikërisht atë rrethanë që ai ka kundërshtuar dhe është bërë shkak për të arritur në një konkluzion të gabuar.*
- ii) *Subjekti parashtron se në asnjë rast nuk ka fshehur një fakt apo një rrethanë për sa i përket kontrollit të figurës dhe kjo provohet lehtësisht nga shpjegimet e tij, të cilat ia ka dërguar Komisionit menjëherë me fillimin e hetimit administrativ dhe ka dorëzuar gjithashtu menjëherë edhe kopje të pasaportës së tij, të cilën nuk e ka ndërruar apo dëmtuar.*

C. Shkaqet e ankimit për vlerësimin e kriterit të pasurisë:

- i) *Për pasurinë apartament me sipërfaqe 82,3 m², faktet dhe konkluzionet e konstatuara nga Komisioni janë të pabazuara, e mbi të gjitha nuk pasqyrojnë realitetin mbi gjendjen e pronës, duke mos marrë në konsideratë të gjitha provat, si dhe duke shtrembëruar faktet në provat ekzistuese.*
- ii) *Në lidhje me kontratën për shkëmbimin e apartamentit me sipërfaqe 83,2 m² me një apartament me sipërfaqe 169,65 m², Komisioni në arsyetimin e tij ka interpretuar pa të drejtë provat e administruara për këtë kontratë dhe, për rrjedhojë, ka arritur në konkluzione të pabazuara në ligj.*
- iii) *Për analizën financiare të vitit 2009, Komisioni nuk duhet të konsideronte shpenzimet për shkollimin e fëmijëve pasi këto shpenzime nuk janë kryer prej tij. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, subjekti nuk kishte si të deklaronte një shpenzim që nuk e kërkonte formulari dhe ligji, pasi shpenzimi për shkollimin e fëmijëve atë vit, është më i ulët se 300.000 lekë, vlerë e kërkuar për deklaram të shpenzimeve.*
- iv) *Konstatimet e Komisionit në lidhje me një kredi të marrë në Bankën e Tiranës, janë rezultat i një keqkuptimi, pasi gjatë hetimit ai ka deklaruar se ky likuiditet ka pasur si qëllim mobilim apartamenti.*
- v) *Në lidhje me pasurinë e personave të tjerë të lidhur, pavarësisht prapësimeve të tij pas barrës së provës, bindja e brendshme e Komisionit, pa u bazuar në asnjë provë, rrethanë apo fakt të administruar gjatë hetimit, ka sjellë një konkluzion të pasaktë mbi burimin e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur. Komisioni nuk ka arsyetuar se cilën pasuri të personave të tjerë të lidhur, subjekti nuk ka deklaruar saktësisht apo plotësisht.*

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit mbi shkaqet e ankimit që lidhen me procesin e rregullt ligjor

6. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i marrë nga Komisioni bazuar në shqyrtimin e vetëm 2 (dy) kriterëve, të kontrollit të pasurisë dhe të figurës, është në kundërshtim me parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016 për zhvillimin e një procesi rivlerësimi të plotë e të gjithanshëm, në pajtim me të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit. Për pasojë, procesi i rivlerësimit është i parregullt edhe në referim të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Protokollit nr. 1 të saj.*

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 06.06.2019, ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit dhe ta njoftojë atë se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e këtij hetimi.

Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka njoftuar subjektin për mbylljen e hetimit administrativ, mbështetur në dy kriterë vlerësimi, atë të pasurisë dhe të figurës. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit të protokolluara në Komision me nr. {***} prot., datë 17.06.2019, nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim për përfundimin e hetimit administrativ vetëm për dy kriterë vlerësimi.

Më tej, ky fakt u deklarua dhe nga relatorja e çështjes gjatë seancës dëgjimore të datës 24.06.2019, se Komisioni vendosi të përfundojë hetimin kryesisht për kriterin e pasurisë dhe figurës, pasi provat për këto kriterë kanë arritur nivelin e provueshmërisë sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë seancë dëgjimore, subjekti, pasi ka shprehur qëndrimin e tij lidhur me dy kriteret e vlerësuar, ka përshkruar edhe karrierën e tij si prokuror në sistemin e drejtësisë. Kryesuesja e trupës gjyqësore i ka bërë të qartë që procesi i tij i rivlerësimit nuk e përfshinte kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale, prandaj nëse ai kishte një kërkesë të veçantë procedurale, do të duhet ta paraqiste në mënyrë të plotë e të qartë, e më pas Komisioni të tërhiqej për të nxjerrë një konkluzion. Në përgjigje të kësaj kërkesë të kryesueses, subjekti është shprehur: *Jo, unë thjesht doja të paraqisja atë çfarë ka në koncept të procesit të rivlerësimit dhe figurës dhe profesional. Kërkesë të veçantë unë nuk kam, thjesht doja t'ju bëja me dije disa pjesë dhe e ndërpres këtu.*

7. *Në ankim subjekti i rivlerësimit pretendon se nga Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, nuk u mor në konsideratë dhe nuk u hetua apo vlerësua kriteri i aftësisë profesionale, madje edhe në seancë dëgjimore, trupi gjykues u shpreh se po vlerëson bazuar vetëm në dy kriterë. Për këtë arsye, subjekti kërkon nga Kolegji çeljen e hetimit dhe kalimin në seancë gjyqësore publike, me qëllim hetimin e plotë dhe objektiv edhe për kriterin profesional.*

Në analizë të këtij pretendimi, Kolegji ka tashmë një qëndrim të konsoliduar të mbajtur edhe në çështje të tjera të ngjashme të shqyrtuara prej tij, duke e konsideruar të drejtë qëndrimin e Komisionit për këtë aspekt procedural dhe duke e konsideruar të rregullt procesin e rivlerësimit të kryer që përfshin dhe një apo dy kriterë vlerësimi.

Referuar sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se përfundimi i procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit nga Komisioni, bazuar vetëm në kriterin e kontrollit të pasurisë dhe të figurës, është një vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për këtë arsye, nuk e gjen të

bazuar kërkesën e subjektit për *çeljen e hetimit dhe kalimin në seancë gjyqësore publike, me qëllim hetimin e plotë dhe objektiv edhe për kriterin profesional.*

8. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, pasi gjatë gjithë procesit, ai u hetua nga e njëjta trupë gjykuese që mori dhe vendimin.*

Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve të administruara nga Komisioni, konstaton se ky pretendim i subjektit nuk është ngritur gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, por ngrihet për herë të parë në ankim. Edhe për këtë shkak ankimi të subjektit, Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar tashmë në jurisprudencën e tij, se kompetenca e Komisionit për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces administrativ i nisur kryesisht, në përputhje me kompetencën që i njeh Kushtetuta dhe kreu VII, “Procedura e rivlerësimit”, i ligjit nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit. Sa më sipër, pretendimi i ngritur nga subjekti i rivlerësimit është i pabazuar.

9. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i Komisionit është rezultat i mosmarrjes në konsideratë dhe mosanalizimit të disa prej provave të paraqitura prej tij, duke bërë interpretim të gabuar dhe që nuk i përgjigjet realitetit të ndodhur. Vendimi i Komisionit përmban konkluzione, të cilat nuk janë shprehur asnjëherë nga Komisioni, as në fazën e hetimit administrativ e as në seancë dëgjimore publike, si dhe në kundërshtim me një proces të rregullt e objektiv, pasi subjekti nuk është njohur me asnjë akt ekspertimi të kryer dhe as ka mundur të parashtojë prapësime apo pyetje mbi konkluzionet e një eksperti.*

Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti, shkakun e ankimit e ka përqendruar kryesisht në pretendimin se jo vetëm gjatë hetimit administrativ, por edhe në vendim Komisioni nuk ka përmendur dhe nuk ka përdorur si provë në vlerësimin e pasurisë, qëndrimin e shoqërisë “{***}” ShA, e cila ka konfirmuar çdo rrethanë të shpjeguar nga subjekti, si dhe në pretendimin se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë disa prova të paraqitura prej tij, si deklaratat e vëllezërve të tij apo deklarin e prindërve të bashkëshortes së tij.

Lidhur me këto pretendime të subjektit, referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.11.2018, i ka kërkuar informacion shoqërisë “{***}” ShA mbi llojin e pasurisë së paluajtshme që subjekti i rivlerësimit apo të afërm të tij mund të kishin porositur pranë kësaj shoqërie, kopje të kontratave, marrëveshjeve, mandatpagesave për shumat e paguara, datat e pagesave, detyrimet e mbetura nëse kanë etj. Shoqëria “{***}” ShA, përmes shkresës së protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 21.11.2018, ka dërguar informacionin dhe dokumentacionin përkatës, i cili është i njëjtë me atë që subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*.

Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni nuk e ka përmendur specifikisht kërkesën për informacion drejtuar shoqërisë “{***}” ShA, por ka shpjeguar se për pasurinë apartament me sipërfaqe 83,2 m² në ish-pronësi të subjektit të rivlerësimit, rezultati i hetimit është bazuar në: *deklarimet e bëra pranë ILDKPKI-së; provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; dokumentacionit të dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit; deklarimet e bëra prej tij gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni; provat shkresore të administruara në dosje.*

Gjatë seancës dëgjimore të datës 24.06.2019, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur pretendim në lidhje me mospërmendjen specifike prej Komisionit në rezultatet e hetimit administrativ, të përgjigjes së kthyer nga shoqëria “{***}.” ShA.

Edhe pse në arsyetimin e tij në vendim, Komisioni nuk ka përmendur informacionin e përcjellë nga shoqëria “{***}.” ShA, nga përmbajtja e vendimit rezulton se nuk jemi para kushteve të pretenduara prej subjektit për mosanalizim të provave, pasi informacioni i përcjellë nga shoqëria “{***}.” ShA, i cili ishte rezultat i hetimit të kryer nga vetë Komisioni, nuk sillte asgjë të re për hetimin administrativ, pasi i njëjti dokumentacion ishte paraqitur më parë nga subjekti, në cilësinë e provës.

10. Për sa u përket akteve të paraqitura nga subjekti në mbështetje të deklarimeve të tij gjatë hetimit administrativ, si deklaratat e vëllezërve të tij, apo deklarin e prindërve të bashkëshortes së tij, nga përmbajtja e vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, të Komisionit, konstatohet se ky i fundit ka shpjeguar pse u ka dhënë vlerë të kufizuar provuese deklaratave të sipërpërmendura për efekt të konsiderimit të burimeve financiare që vëllezërit e tij dhe prindërit e bashkëshortes pretendojnë se i kanë dhënë subjektit.
11. Në analizë të konstatimeve të mësipërme, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, në përputhje me nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, ka marrë në konsideratë provat dhe i ka vlerësuar sipas bindjes së tij për vlerën e tyre provuese. Mënyra se si janë vlerësuar e interpretuar provat, është në diskrecion të trupit gjykues të Komisionit. Një vendimmarrje që nuk plotëson pritshmërinë e subjektit, nuk e bën inekzistent apo të cenueshëm procesin e shqyrtimit dhe të vlerësimit të provave, siç pretendon subjekti në ankim. Vendimi i Komisionit është në përputhje të plotë me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, pasi përmban bazën ligjore mbi të cilën bazohet procesi i rivlerësimit, analizën e provave të administruara, vlerësimin e Komisionit në lidhje me hetimin administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe caktimin e masës disiplinore. Në vendim është bërë një analizë e plotë e provave, të cilat janë përdorur për vlerësimin e pasurisë. Pretendimi i subjektit për mosanalizimin nga Komisioni të provave të paraqitura prej tij, nuk cenon rregullsinë e procesit të rivlerësimit të tij, për rrjedhojë ky pretendim gjendet i pabazuar.
12. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se analiza financiare për vitin 2007 është bërë nga Komisioni në kundërshtim me çdo procedurë ligjore, pasi subjekti nuk është njohur me asnjë ekspert apo ekspertim të kryer në lidhje me këtë analizë dhe as nuk ka pasur mundësi të parashtronte pyetje apo prapësime për konkluzionet e një eksperti. Subjekti ka pretenduar se një analizë e bërë nga një ekspert pranë Komisionit e bën procesin të parregullt e joobjektiv, pasi eksperti i Komisionit nuk mund të ketë cilësitë e domosdoshme procedurale si i paanshëm.*

Nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, rezulton se këtë pretendim subjekti nuk e ka ngritur gjatë hetimit administrativ në Komision, si kërkesë procedurale, as në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ e as në seancën dëgjimore publike të datës 24.06.2019, megjithëse rezultatet e hetimit kishin në përmbajtjen e tyre disa analiza financiare, të cilat kishin prodhuar një rezultat negativ për burimet e krijimit të pasurive të subjektit. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, konstatohet se, ndryshe nga sa pretendon, subjekti ka paraqitur prapësimet e tij në lidhje me analizën financiare të vitit 2007.

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, pavarësisht situatës faktike të pasqyruar më sipër, duhet të nënvizojmë se Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar tashmë, të shprehur në jurisprudencën e tij, se Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur Komisionin dhe Kolegjin me të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe

shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Referuar arsytimit të mësipërm, edhe këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e gjen të pabazuar.

13. *Subjekti ka pretenduar se analiza financiare për vitin 2007 iu bë me dije vetëm në vendim, pasi në asnjë rast tjetër nuk i është bërë me dije një analizë e tillë.*

Nga analizimi i akteve të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën për sa vijon: *Hartimi i kontratës së sipërmarrjes dhe çmimi i vendosur në të u përdorën për të aplikuar dhe përfituar kredinë e butë, të përfituar nga "Raiffeisen Bank".*

Ka mospërputhje deklarimesh në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin me deklaratimet e vitit 2007 për: çmimin e blerjes së apartamentit; garazhin e porositur dhe pagesën e një pjese të çmimit për të; mënyrën e shlyerjes së pagesës për apartamentin.

Ekziston dyshim i arsyeshëm se subjekti ka zhvilluar dhe zbatuar një sistem, i cili përbëhet nga një gamë e gjerë veprimesh të ndryshme fiktive me qëllim përfitimin e kredisë së butë.

Për kredinë e marrë në Tirana Bank, subjekti i rivlerësimi ka bërë deklaram të rremë gjatë hetimit administrativ.

Po me rezultatet e hetimit, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës edhe për analizën financiare të vitit 2007, sipas së cilës ai ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 151.036 lekë.

Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka shpjeguar se për marrjen e kredisë në vlerën 5.000.000 lekë, nuk ka përdorur asnjë kontratë tjetër sipërmarrjeje përveç asaj reale, që përputhet me banesën në të cilën u strehua nga z. M., apartament i cili kaloi në pronësi të tij më pas, sipas kontratës së shitjes.

Në vendim¹, Komisioni, në lidhje me analizën e vitit 2007, ka shpjeguar se: *Në kushtet kur kontrata e sipërmarrjes u vlerësua si një kontratë fiktive, e cila nuk ka pasur për qëllim krijimin e efekteve midis palëve, por vetëm plotësimin e kushteve për përfitimin e kredisë së butë nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vendosi, pas rezultateve të hetimit, që analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme ta bëjë duke u bazuar në kontratën e shitjes së vitit 2007.*

Në analizën e vitit 2007, të pasqyruar në vendim, subjekti rezulton me mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 4.051.036 lekë.

Nga krahasimi i të dyja analizave financiare, rezulton se në asnjërin prej tyre, Komisioni nuk ka përlogaritur si të ardhur kredinë në vlerën prej 5.000.000 lekë, të përfituar nga subjekti në formën e kredisë së butë.

Nga situata faktike si më sipër, rezulton se, në kundërshtim me sa pretendon subjekti, Komisioni i ka kaluar barrën e provës mbi analizën financiare të vitit 2007. Rezultatit e analizës financiare të vitit 2007 në vendim, Komisioni e ka prodhuar si rezultat i vlerësimit të të gjitha të dhënave të mbledhura gjatë hetimit, të të gjitha shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive të të provuarit prej vetë subjektit të rivlerësimit, në përfundim edhe të seancës dëgjimore publike. Interpretimin dhe vlerësimin përfundimtar të provave dhe kryerjen e analizës financiare përfundimtare mbi bazën e tyre,

¹ Shih paragrafin 71 të vendimit nr. 171, datë 26.06.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Komisioni e bën në vendim, pasi subjekti ka ezauruar plotësisht barrën e provës. Sa më sipër, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit, analizën financiare të vitit 2007, duke i kaluar edhe barrën e provës për elementet e kësaj analize dhe subjekti ka dhënë shpjegimet e veta në lidhje me to, të cilat janë të njëjta me pretendimet që subjekti ka dhënë dhe në ankim.

Bazuar në këtë situatë faktike, pretendimi i subjektit se Komisioni i ka bërë me dije analizën e vitit 2007 për herë të parë në vendim, nuk është i bazuar në aktet e hetimit administrativ.

14. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se edhe nëse supozohet se në pikëpamjen formale qëndrojnë gjetjet e Komisionit, ato kanë të bëjnë me burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe jo me pikën 4 të po këtij neni, ku ligjvënësi ka përcaktuar dyfishin e pasurisë së ligjshme, si kufi për t'u prezumuar fajtor për shkelje disiplinore.*

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, referuar gjithë arsyetimit dhe përmbajtjes së vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, në asnjë rast nuk rezulton që në arsyetimin apo dispozitivin e tij, Komisioni të ketë mbajtur qëndrim lidhur me pasjen e dyfishit të pasurisë së ligjshme nga subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, referuar dispozitivit të këtij vendimi, rezulton që masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit është dhënë bazuar në parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion, mbështetur edhe në qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit, të mbajtur në çështje të ngjashme, duke qenë se konstatohet që përcaktimi i nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet dhënia e masës së shkarkimit nga detyra për rastet kur rezulton se subjekti ka më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme, nuk është aplikuar në këtë rast nga Komisioni, pretendimi i subjektit për zbatim të gabuar të kësaj dispozite, është i pabazuar.

15. *Subjekti ka pretenduar se paragjykimi për rezultatin e vlerësimit ka shtyrë Komisionin të kërkojë rivlerësimin e figurës së tij. Subjekti i rivlerësimit, në këtë shkak ankimi, ka kontestuar qëndrimin e Komisionit të shprehur në paragrafët 18 dhe 19 të vendimit nr. 171, datë 26.06.2019. Në këta paragrafë, Komisioni ka pasqyruar këtë situatë faktike: 18. Trupi gjykues i Komisionit konstatoi se raporti i parë i sjellë nga ky institucion referonte gabim emrin e subjektit, ndaj iu kërkuar Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar rishikimi dhe saktësimi i këtij raporti.*

*19. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.04.2019, ka dërguar në Komision raportin e rishikuar për kontrollin e figurës, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 02.04.2019 të KDZH-së, me konkluzionin si më poshtë vijon: [...]. Subjekti vijon më tej, duke pretenduar se kriteret formale në këtë rast, duket se krijojnë dyshime për objektivitetin e hetimit e më pas gjykimin.*

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në *Raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Eugen V. Beçi nr. {***} prot., datë 30.10.2017*, i deklasifikuar plotësisht me vendimin e KZHD-së nr. {***}, datë 14.05.2019, DSIK-ja, ka referuar nominalisht një subjekt tjetër rivlerësimi dhe faktet e rrethanat e konstatuara në vazhdim të raportit lidhen pikërisht me këtë subjekt.

Në *Raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Eugen V. Beçi nr. {***} prot., datë 19.03.2019*, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KZHD-së nr. {***}, datë 02.04.2019², DSIK-ja ka pasqyruar si vijon:

² Ky raport është përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 04.04.2019 të DSIK-së.

*1.Me shkresën nr. {***} prot., datë 30.10.2017, është përcjellë në Komision raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Eugen V. Beçi, me konstatimin për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga ky subjekt rivlerësimi.*

*2. Në vijim përcillet raporti i rishikuar për kontrollin e figurës, me kërkesën nga Komisioni nr. {***} prot., datë 23.10.2018.*

Në përfundim, DSIK-ja konstaton papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit.

Në referim të sa më sipër, rezulton se Komisioni ka pasqyruar drejt situatën faktike në paragrafët 18 dhe 19 të vendimit.

16. Pretendimin e paraqitur në ankim, se paragjykimi për rezultatin e vlerësimit ndaj subjektit duket se ka shtyrë Komisionin të kërkojë rivlerësimin e figurës së tij, e për këtë arsye krijohen dyshime për objektivitetin e hetimit dhe më pas gjykimit, subjekti nuk e ka paraqitur në asnjë fazë procedurale të procesit të rivlerësimit në Komision, as në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet e hetimit administrativ e as në seancën dëgjimore të datës 24.06.2019. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit do të ishte më i besueshëm nëse do të kishte gjetur reflektim gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit përpara njohjes me vendimin përfundimtar të Komisionit. Në vlerësim të Kolegjit, subjektit i janë garantuar të gjitha të drejtat procedurale për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur në kuadër të një procesi të rregullt ligjor.
17. Në analizë të pretendimit të subjektit, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, rezulton se Komisioni, në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti, nuk i ka kërkuar DSIK-së rivlerësimin e figurës për subjektin, por ka kërkuar rishikimin e raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, pasi raporti ka referuar nominalisht një subjekt tjetër rivlerësimi dhe faktet e rrethanat e konstatuara në vazhdim të raportit lidhen pikërisht me këtë subjekt. Komisioni ka vepruar brenda kompetencave të tij kushtetuese e ligjore, në kërkimin e rishikimit të raportit nga DSIK-ja, pasi autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës, është Komisioni që vepron në bashkëpunim me DSIK-në, bazuar në parashikimin e nenit 36, pika 1 e ligjit nr. 84/2016³, dhe arsyetimin në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese⁴. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit është i paargumentuar dhe i pambështetur në aktet e hetimit administrativ.
18. Trupi gjykues i Kolegjit, më datë 19.01.2021, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, çështjen me nr. 41/2019 (JR), datë 06.09.2019, mbi ankimin e subjektit të rivlerësimit dhe në vijim, edhe pse nuk konstatoi shkelje procedurale të procesit të rivlerësimit në Komision, bazuar në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, me vendim të ndërmjetëm vendosi të kalojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit, pasi çmoi se debati gjyqësor ishte

³ Neni 36, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “1. Institucionet e rivlerësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar janë autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës. [...]”.

⁴ Në vendimin nr. 2/2017, Gjykata Kushtetuese shprehet se: “Gjykata vlerëson se institucionet kushtetuese të rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës, si dhe për të pasur akses te të gjitha materialet përkatëse. [...] Sipas nenit 14 të ligjit (nr. 84/2016) relatori në çdo rast duhet të ndërmarrë të gjitha procedurat për të siguruar provat e nevojshme për procesin e vendimmarrjes së trupës gjyqësore. [...] Në përfundim, Gjykata vlerëson se dispozitat e ligjit garantojnë aksesin në të gjithë informacionin dhe dokumentet e disponuara nga grupi i punës, dhe garantojnë kontrollin efektiv mbi veprimtarinë e grupeve të punës nga KPK-ja. Organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (KPK-ja dhe KA-ja) të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme”.

i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes. Seanca gjyqësore publike u zhvillua më datë 02.02.2021, gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit paraqiti parashtimet e tij, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor z. Ardian Leka.

IV. Vlerësimi i Kolegjit mbi kontrollin e figurës dhe shkaqet e ankimit lidhur me këtë kriter

19. Komisioni, në vendim, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, bazuar në analizën e provave dhe fakteve, ka arritur në përfundimin se:

i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të shkronjës “g” të pjesës nr. 5 të “shtojcës 3”, “Të dhëna për sigurinë”, të ligjit nr. 84/2016.

ii) Subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 4 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, ka bërë deklarime të pasakta duke fshehur fakte të ndodhura deri ditën e deklarimit, sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se “Subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

20. Bazuar në përcaktimet kushtetuese e ligjore, përkatësisht nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 35, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të këtij ligji. Nga hetimi administrativ i kryer në Komision dhe shqyrtimit të çështjes në Kolegj, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar këtë deklaratë dhe e ka paraqitur pranë dy institucioneve përgjegjëse për këtë kriter, përkatësisht Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Komisionit.

21. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit konstaton si vijon.

21.1 Subjekti i rivlerësimit Eugen Beci ka dorëzuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës pranë DSIK-së më datë 27.01.2017, i regjistruar në regjistrin e dorëzimit të formularëve me nr. {***}.

21.2 DSIK-ja, në raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Eugen V. Beçi nr. {***} prot., datë 30.10.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KZHD-së nr. {***}, datë 14.05.2019, ka referuar nominalisht një subjekt tjetër rivlerësimi dhe faktet e rrethanat e konstatuara në vazhdim të raportit lidhen pikërisht me këtë subjekt.

21.3 Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.10.2018, i drejtohet DSIK-së, me kërkesën për rishikimin e raportit.

21.4 Subjekti i rivlerësimit, më datë 20.11.2018, pasi kishte filluar procesi i rivlerësimit, ka paraqitur në Komision deklarinimin me objekt “Sqarim mbi një përgjigje në formularin e deklarimit të kontrollit të figurës”, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 20.11.2018, në të cilin shprehet: [...] *Siç edhe ligji e kërkonte më datë 27.01.2017, me nr. {***} prot., kam dorëzuar pranë DSIK, formularin e deklaratës për kontrollin e figurës. Në këtë formular, në pjesën 5, tek “Të dhënat për sigurinë”, pyetjes “g. Gjatë 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s?” i jam përgjigjur me mohim, pra “JO”. Por, para datës 27.01.2017, mua, zyra konsullore pranë Ambasadës Amerikane në Tiranë, më njoftoi për revokimin e një vize trevjeçare që kisha marrë pranë kësaj ambasade, duke bërë dhe shënimet përkatëse. Fakt ky i dokumentuar*

edhe te kopja e pasaportës që ju kam dërguar. Përpara jush dua të shpjegoj se këtë përgjigje mohuese në lidhje me refuzimin për të hyrë në një shtet anëtar të NATO-s, e kam dhënë sepse: Së pari, viza më është dhënë pas një kërkesë të OPDAT-it, për një vizitë studimore në ShBA, dhe qëllimi i marrjes së kësaj vize është realizuar, pasi nga data 17.10.2016 - 28.10.2016 unë kam hyrë në territorin e ShBA-së për një vizitë studimore për prokurorët dhe punonjësit e zbatimit të ligjit që merren me çështjet e terrorizmit dhe të luftëtarëve të huaj terroristë, organizuar nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë. Më tej, unë as kam ndërmarrë ndonjë vizitë ku realisht të më jetë refuzuar hyrja në ShBA.

Faktin që i kam thënë jo kësaj pyetjeje, e kam argumentuar në bindjen time duke iu referuar informacionit zyrtar në faqen e qeverisë amerikane, ku sipas ligjeve amerikane shpjegohet koncepti i vizës dhe hyrjes në një pikë kalimi kufitar në shtetin amerikan, ku më konkretisht citoj: “Një vizë amerikane të jep mundësinë të udhëtosh në një port, aeroport, apo kufi, dhe të kërkoh leje nga inspektorët e Departamentit të Sigurisë, Doganës dhe Mbrojtjes së Kufirit, që të hyni në ShBA. Të pasurit e vizës nuk garanton hyrjen në ShBA, por është provë se një oficer konsular tek një Ambasadë Amerikane ka vendosur që ju jeni i pranueshëm të kërkonti leje hyrje në ShBA”.

Në këtë kontekst kam menduar të jap atë përgjigje dhe kur të niste procesi të jepja shpjegime të hollësishme. Pasi edhe pyetja kishte të bënte me një grup vendesh anëtare të BE-së, ku shtetasit shqiptarë nuk kanë nevojë për vizë dhe në këtë këndvështrim, pyetjen e konsiderova të lidhur ngushtësisht me situatë konkrete kthimi në kufi, ku realisht merr fuqi fjala “refuzim”.

Gjithsesi, për të shmangur çdo keqinterpretim që mund të konsiderohet pasaktësi në deklaram të kësaj situatë, kërkoja të jap këtë shpjegim të hollësishëm pikërisht në këtë moment. Dhe për këtë gjë, kam paraqitur përpara jush dhe kopje të pasaportës sime, ku është dhe vula e revokimit të vizës”.

21.5 Të njëjtën përgjigje, subjekti e ka dhënë edhe në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit, protokolluar në këtë të fundit me nr. {***} prot., datë 26.12.2018

21.6 DSIK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.04.2019, ka përcjellë në Komision raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Eugen V. Beçi nr. {***} prot., datë 19.03.2019, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. {***}, datë 02.04.2019, të KDZH-së, sipas të cilit:

1. Me shkresën nr. {***} prot., datë 30.10.2017, është përcjellë në Komision raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Eugen Beçi, me konstatimin për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga ky subjekt rivlerësimi.
2. Në vijim, përcillet raporti i rishikuar për kontrollin e figurës, me kërkesën e Komisionit nr. {***} prot., datë 23.10.2018.

Së fundmi, pas verifikimeve të kryera rezulton se:

- Në datën 26.01.2017, subjektit të rivlerësimit i është revokuar viza e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. (Subjekti i rivlerësimit është njoftuar personalisht ose me shkrim, në datën 26.01.2017, për revokimin e vizës).
- Subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi ka plotësuar dhe kryer dorëzimin fizik të deklaratës për kontrollin e figurës në DSIK, më datë 27.01.2017 (një ditë pas revokimit të vizës), arsye që tregon se subjekti i rivlerësimit ka qenë në dijeni të faktit.

Sa më sipër, në vlerësim të të dhënave mbi subjektin e rivlerësimit, gjykojmë se:

Referuar parashikimeve të bëra në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në nenin Dh “Kontrolli i figurës”, pika 4, subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, evidentohet se ka bërë deklaram të pasaktë në plotësimin e Deklaratës për Kontrollin e Figurës, konkretisht në shkronjën “g” të pjesës nr. 5, “Të dhëna për sigurinë”, pasi nuk ka deklaruar revokimin e vizës amerikane si fakt i ndodhur para ditës së dorëzimit të formularit për kontrollin e figurës. Mosdeklarimi në këtë

rast, e ngarkon subjektin, z. Eugen Beçi, me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe me plotësimin jo me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës.

Mbështetur në sa më sipër, Grupi i Punës rishikon konstatimin fillestar të figurës së subjektit të rivlerësimit dhe arrin në përfundimin mbi papërshtatshmërinë e vijimit të ushtrimit të detyrës nga Eugen V. Beçi.

22. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, me rezultatet e hetimit administrativ, i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit lidhur me pasaktësinë në deklaram për kontrollin e figurës. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, *theksoj se mbi bazën e koncepteve juridike, gjuhësore dhe logjike, në asnjë rast nuk i është refuzuar hyrja jo vetëm në ShBA, por në asnjë vend tjetër anëtar apo jo anëtar i Bashkimit Evropian. Për këtë mbetet i bindur bazuar në fakte, prova dhe shpjegime të këtyre koncepteve nga vetë ligjzbatuesit e shtetit për të cilin ju bëni fjalë, pra ShBA-së [...].* Më tej, subjekti paraqet të njëjtat deklarime me ato që kishte paraqitur pranë Komisionit më datë 20.11.2018, me objekt “Sqarim mbi një përgjigje në formularin e deklaramit të kontrollit të figurës”, sipërcituar.
23. Përgjatë analizimit të kësaj deklarate për vlerësimin e kontrollit të figurës në Kolegj, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në pjesën nr. 5, “Të dhëna për sigurinë”, germa ”g”: *Gjatë 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s, ka deklaruar “JO”.*
24. Sipas deklarameve të vetë subjektit të paraqitura në Komision më datë 20.11.2018, ai ishte njoftuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë për revokimin e vizës trevjeçare që kishte marrë pranë saj, përpara datës së dorëzimit të formularit për kontrollin e figurës. Pavarësisht kësaj dijenie, subjekti ka dorëzuar formularin sipas shtojcës së ligjit nr. 84/2016, pa e reflektuar refuzimin/*cancelled without prejudice* të vizës trevjeçare nga Ambasada e ShBA-së në Tiranë (vend anëtar i NATO-s), të plotësuar në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e pjesës 5, shkronja “g” e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Referuar datës kur subjekti ka marrë njoftim për refuzimin e vizës nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, pikërisht më datë 26.01.2017 dhe 27.01.2017, që korrespondon me datën e dorëzimit të deklaratës për kontrollin e figurës pranë DSIK-së, rezulton se subjekti i rivlerësimit ditën e deklaramit ka pasur dijeni për faktin e refuzimit të vizës, dhe nuk e ka deklaruar këtë fakt.
25. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka argumentuar se nuk i është refuzuar hyrja në një shtet anëtar të NATO-s, duke iu referuar informacionit zyrtar në faqen e qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku sipas ligjeve amerikane shpjegohet koncepti i vizës dhe hyrjes në një pikë kalimi kufitar në shtetin amerikan, duke pretenduar se atij i është revokuar vetëm mundësia dhe propozimi për të filluar një udhëtim, i cili ka rregulla të tjera procedurale për të arritur deri te hyrja apo jo në ShBA. Subjekti, në vijim të pretendimit të mësipërm, ka parashtruar se viza e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i është dhënë për një vizitë studimore në ShBA për prokurorët dhe punonjësit e zbatimit të ligjit që merren me çështjet e terrorizmit dhe të luftëtarëve të huaj terroristë, organizuar nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë dhe qëllimi i marrjes së kësaj vize është realizuar, pasi ai ka qëndruar në territorin e ShBA-së nga data 17.10.2016 - 28.10.2016. Më tej, ai nuk ka ndërmarrë ndonjë vizitë ku realisht t’i jetë refuzuar hyrja në ShBA.
26. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, konstatohet se thelbi i pretendimit qëndron në konceptimin e refuzimit të hyrjes në një vend anëtar të NATO-s, si një refuzim në momentin e paraqitjes në kufirin e një shteti të caktuar anëtar të NATO-s, konkretisht ShBA. Nga verifikimi i pasaportës së dorëzuar nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit standard të Komisionit, konstatohet se ai ka qenë mbajtës i një vize të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e tipit B 1, e lëshuar nga Ambasada e ShBA-së në Tiranë, për qëllime zyrtare. Për shkak

se mbi vizën është vendosur shënimi i revokimit të saj, nuk mund të konstatohen të dhëna të tjera lidhur me të. Vetë subjekti ka deklaruar se kjo vizë ka qenë trevjeçare.

27. Në analizë të pretendimit të subjektit në raport me legjislacionin federal të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vërehet se normat rregulluese për pajisjen me vizë për të huajt joemigrantë, gjenden në Aktin për Imigrimin dhe Shtetësinë, në nenin 221, në titullin 8, USC paragrafi 1201⁵, i cili në nënndarjen “(i)”, me titull “Revokimi i vizave ose dokumenteve”, parashikon se: *Pas lëshimit të vizës ose dokumentacionit tjetër për çdo të huaj, zyrtari konsullor ose Sekretari i Shtetit mund në çdo kohë, sipas gjykimit të tij, të revokojë një vizë. Njoftimi për një revokim të tillë i komunikohet Prokurorit të Përgjithshëm dhe një revokim i tillë zhvlerëson vizën që nga data e lëshimit [...].* Në Kodin e Rregulloreve Federale (CFR), në titullin 22 “Marrëdhëniet me jashtë”, në seksionin 41.122 “Revokimi i vizave”, paragrafi “(c)” me titull “Njoftimi për revokim”⁶, parashikohet se: *(c). [...], një zyrtar konsullor do të njoftojë, nëse është e mundur, të huajin për të cilin është lëshuar viza se viza është revokuar ose është revokuar për kohësisht. Pavarësisht nga dorëzimi i një njoftimi të tillë, pasi revokimi i vizës të jetë regjistruar në Sistemin Konsullor të Departamentit të Kontrollit dhe Mbështetjes (CLASS), viza nuk do të konsiderohet më e vlefshme për të udhëtuar në Shtetet e Bashkuara. Data e revokimit tregohet në CLASS dhe në çdo njoftim dërguar të huajit, të cilit i është lëshuar viza.*
28. Ndërsa rastet e revokimit dhe procedurat e njoftimit të të huajit për revokimin e vizës, parashikohen në Manualin e Marrëdhënieve me Jashtë⁷ të Departamentit Amerikan të Shtetit.
29. Në arsyetim të dispozitave të mësipërme, si dhe në mbështetje të përkufizimit të “vizës” të dhënë nga Departamenti Amerikan i Shtetit, sipas të cilit: *Një shtetas nga një vend i huaj që kërkon të hyjë në Shtetet e Bashkuara, duhet në fillim të marrë një vizë amerikane, e cila vendoset në pasaportën e udhëtarit, që është edhe dokumenti për udhëtim i lëshuar nga vendi i shtetësisë së udhëtarit⁸* – rezulton se refuzimi i vizës ka si qëllim moslejimin e personit që të hyjë në shtetin e caktuar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pra është një refuzim hyrjeje në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
30. Subjekti e ka mbështetur mbrojtjen e pretendimit të tij se nuk i është refuzuar hyrja në ShBA, në referim të informacionit të dhënë në faqen zyrtare në internet të Departamentit Amerikan të Shtetit, dhe ka parashtruar bindjen e tij se nuk i është refuzuar hyrja në një shtet anëtar të NATO-s, por duke pretenduar se atij i është revokuar vetëm mundësia dhe propozimi për të filluar një udhëtim, i cili ka rregulla të tjera procedurale për të arritur deri te hyrja apo jo në ShBA.
31. Nga informacioni zyrtar i cituar nga subjekti, rezulton se është i drejtë perceptimi i tij që të pasurit e vizës nuk garanton hyrjen në ShBA, por informacioni i referuar nga subjekti, në fakt vazhdon edhe më tej, duke cituar se: *Oficerët e Doganave dhe Mbrojtjes së Kufirit në Departamentin Amerikan të Sigurisë Kombëtare kanë autoritetin që të lejojnë ose të refuzojnë hyrjen në Shtetet e Bashkuara.*
32. Oficerët e Doganave dhe Mbrojtjes së Kufirit kryejnë inspektimet në pikat hyrëse të kufirit amerikan, duke përdorur të njëjtat kritere për të gjithë të huajt që vizitojnë ShBA-në. Janë ata që

⁵ <https://uscode.house.gov/view.xhtml?req=granuleid:USC-prelim-title8-section1201&num=0&edition=prelim>

⁶ <https://www.govinfo.gov/content/pkg/CFR-2012-title22-vol1/pdf/CFR-2012-title22-vol1-part41-subpartL.pdf>

⁷ <https://fam.state.gov/fam/09FAM/09FAM040311.html>

⁸ <https://travel.state.gov/content/travel/en/us-visas/visa-information-resources/frequently-asked-questions/what-is-us-visa.html>

vendosin nëse të huajt lejohen të hyjnë në ShBA ose jo, edhe në rast se të gjitha dokumentet e udhëtimit, duke përfshirë dhe vizën, janë të rregullta⁹.

Arsyet pse një i huaj nuk mund të pajiset me vizë nga një ambasadë apo konsullatë e ShBA-së, apo të mos lejohet të hyjë në ShBA nga oficerët e Doganave dhe Mbrojtjes së Kufirit, parashikohen në Aktin për Imigrimin dhe Kombësinë, në nenin 212, në titullin 8, USC paragrafi 1182 “Të huajt e papranueshëm”¹⁰. Në pikën 7 të këtij paragrafi parashikohet se:

(7) *Kërkesat për dokumentim*

(B) *Joemigrantët*

(i) *Të përgjithshme*

Është i papranueshëm çdo joemigrant që:

[...] (II) nuk ka në posedim një vizë të vlefshme joemigruese ose kartë identifikimi të kalimit kufitar në kohën e aplikimit për pranim.

33. Nga leximi në harmoni i informacioneve zyrtare dhe legjislacionit të sipërcituar, rezulton se të pasurit e vizës nuk garanton hyrjen në ShBA, por kjo nuk nënkupton kurrsesi të anasjellën, se mungesa e vizës lejon hyrjen në ShBA. Pasja e një vize të Shteteve të Bashkuara të Amerikës është hapi i parë për t’u lejuar të hysh në ShBA, i cili pasohet nga hapi tjetër, që është paraqitja e të huajit në kufirin amerikan, ku do t’i nënshtrohet inspektimit nga oficerët e Doganave dhe Mbrojtjes së Kufirit, të cilët vendosin nëse i huaji i pajisur me të gjithë dokumentacionin përkatës, plotëson apo jo kushtet për të hyrë në ShBA. Mungesa e një vize apo revokimi i saj e klasifikojnë të huajin si të papranueshëm për të hyrë në ShBA, duke mos i krijuar mundësinë atij të kërkojë t’i lejohet hyrja në ShBA. Në kundërshtim me sa pretendon subjekti, atij i është revokuar mundësia për të kërkuar hyrjen në ShBA, pasi i është revokuar viza – instrumenti që do t’i lejonte atij vazhdimin e çdo procedure tjetër me qëllim hyrjen në shtetin amerikan. Revokimi i vizës dhe njoftimi i revokimit të saj bëhen me qëllim që i huaji të mos ndërmarrë asnjë procedurë tjetër për të hyrë në ShBA, sepse në të kundërt kjo konsiderohet në kundërshtim me ligjin. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, pretendimi i subjektit se nuk i është refuzuar hyrja në një shtet anëtar të NATO-s, por vetëm mundësia dhe propozimi për të filluar një udhëtim, i cili ka rregulla të tjera procedurale për të arritur deri te hyrja apo jo në ShBA, nuk gjendet i mbështetur.
34. Bazuar në analizën dhe arsyetimin e mësipërm, trupi gjykues i Kolegjit nuk gjen të bazuar edhe pretendimin tjetër të subjektit, se *shtojca nr. 3 e ligjit nr. 84/2016, në pyetjen dhe nënpyetjen sipas shkronjës “g” ka pasur në konsideratë të njëjtën gjendje të pretenduar nga subjekti, refuzimin e hyrjes në kufirin e një shteti anëtar të NATO-s.*

Lidhur me sa parashtron subjekti i rivlerësimit, vërehet se shtojca 3 e ligjit nr. 84/2016 “Deklarata për kontrollin e figurës”, në pjesën 5 “Të dhëna për sigurinë”, në shkronjën “g” drejton pyetjen: *g. Gjatë 10 viteve të fundit, a ju është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s?*

Po *Jo*

Nëse po, jepni detaje për periudhën kohore kur ka ndodhur, vendin dhe rrethanat.

Subjekti pretendon se ai nuk mund t’i përgjigjej një rrethane të tillë se i është refuzuar hyrja për në ShBA nga territori i Shqipërisë. Ky pretendim nuk qëndron, pasi si analizuar më sipër, revokimi i vizës do të thotë refuzim i hyrjes në një shtet të caktuar. Në kushtet në të cilat ndodhej në raport me këtë pyetje të deklaratës për kontrollin e figurës, subjekti do të duhej të përgjigjej me pohim dhe të deklaronte si periudhën kohore datën 26.01.2017, në lidhje me vendin - shtetin ShBA, dhe

⁹ <https://www.usa.gov/enter-us>

¹⁰ <https://uscode.house.gov/view.xhtml?req=granuleid%3AUSC-prelim-title8-section1182&num=0&edition=prelim>

në lidhje me rrethanat - revokimin e vizës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga Ambasada e ShBA-së në Tiranë.

35. *Në ankim, subjekti gjithashtu pretendon se nuk ka fshehur në asnjë rast një fakt apo një rrethanë për sa i përket kontrollit të figurës dhe që sipas subjektit kjo provohet lehtësisht nga shpjegimet e tij, të cilat ia ka dërguar Komisionit menjëherë me fillimin e hetimit administrativ dhe ka dorëzuar gjithashtu menjëherë edhe kopje të pasaportës së tij, të cilën nuk e ka ndërruar apo dëmtuar.*

Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar personalisht formularin e deklaramit për kontrollin e figurës pranë DSIK-së më datë 27.01.2017, i regjistruar në regjistrin e dorëzimit të formularëve me nr. {***}. Sipas deklaramive të vetë subjektit të paraqitura në Komision më datë 20.11.2018, ai ishte njoftuar nga Ambasada e ShBA-së në Tiranë për revokimin e vizës trevjeçare që kishte marrë pranë saj, përpara datës së dorëzimit të formularit për kontrollin e figurës. Pavarësisht kësaj dijenie, subjekti ka dorëzuar formularin të plotësuar në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e pjesës 5, shkronja “g” e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Mosdeklarimi i kësaj rrethane, në përputhje me kërkesat e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përcakton se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, në mënyrë të pasaktë dhe jo me vërtetësi, e cila sjell si pasojë papërshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës.

36. Subjekti ka dorëzuar fotokopjen e pasaportës së tij, në kuadër të pyetësorit standard gjatë hetimit administrativ. Argumenti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, si edhe argumenti se ai nuk e kishte dëmtuar apo ndërruar pasaportën, nuk mund të konsiderohet se është i vlefshëm në drejtim të shfajësimit apo mungesës së përgjegjësisë së subjektit për deklaramin e pasaktë dhe jo me vërtetësi të fakteve në deklaratën e kontrollit të figurës.

Trupi gjykues çmon se mosdeklarimi i kësaj rrethane si detyrim kushtetues i subjektit të rivlerësimit, i cili ishte i përfshirë në një proces të rëndësishëm, siç është procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, dhe mosdeklarimi nga ana e tij e refuzimit të vizës, si kërkesë e kësaj deklarate e shprehur mjaft qartë, në përputhje me kërkesat e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përbën pasaktësi dhe pavërtetësi në plotësimin e formularit të deklaramit për kontrollin e figurës, veprim që sjell si pasojë dhe mosbesueshmërinë e këtij subjekti, si dhe papërshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës.

37. Sa më sipër, në analizën e provave dhe fakteve, trupi gjykues i Kolegjit çmon se konkluzioni i Komisionit është i saktë dhe duhet lënë në fuqi, pasi subjekti i rivlerësimit Eugen Beci nuk ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të germës “g”, të pjesës nr. 5, të “shtojcës 3”, “Të dhëna për sigurinë”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, ka bërë deklaramime të pasakta duke mos treguar vërtetësinë e këtij fakti të ndodhur para ditës së depozitimit të deklaramit, sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

38. Lidhur me shkakun e ankimit se *konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e figurës është rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit. Komisioni, jo vetëm që nuk ka marrë në konsideratë faktet dhe rrethanat e paraqitura prej subjektit, por ka argumentuar duke pasqyruar në mënyrë jo të drejtë pikërisht atë rrethanë që ai ka kundërshtuar dhe është bërë shkak për të arritur në një konkluzion të gabuar*, trupi gjykues i Kolegjit çmon se Komisioni, për sa i përket vlerësimit të pasaktësisë në deklaram nga subjekti, ka bërë analizë të plotë, faktet dhe rrethanat sipas analizës së bërë më sipër flasin qartë dhe konkluzioni i Komisionit është i drejtë.

39. Referuar sqarimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pranë Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se shpjegimet e subjektit në këtë moment procedural, përgjatë hetimit administrativ në Komision, nuk janë argumente bindëse ligjore që justifikojnë pasaktësinë në deklarin e kryer nga subjekti, si dhe afatet në deklarin janë përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe kanë qenë të qarta për subjektin e rivlerësimit, kështu që pretendimet e tij për këtë shkak të ankimit janë të pabazuara në ligj, prova dhe argumente ligjore.
40. Bazuar në analizën më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit dhe dëgjoi parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, Eugen Beci, në seancën gjyqësore publike të datës 02.02.2021, si dhe pasi shqyrtoi provat e administruara për këtë çështje, për kontrollin e kriterit të figurës, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe të pavërtetë në deklaratën sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pjesa 5 “Të dhëna për sigurinë”, shkronja “g”, faktin e refuzimit të hyrjes në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nëpërmjet anulimit të vizës nga ambasada e këtij shteti në Tiranë. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit gjendet në shkelje të parashkimeve të nenit Dh, pika 4, fjalia e dytë e Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e figurës. Situatë faktike kjo që çon në zbatimin e prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi subjekti dështoi jo vetëm të provojë të kundërtën e kësaj situatë, por edhe të shpjegojë besueshëm arsyet e revokimit të vizës nga ambasada e ShBA-së në Tiranë.

A. Vlerësimi i Kolegjit mbi vlerësimin e pasurisë dhe shkaqet e ankimit për këtë kriter

41. Subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
 - *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - *Nuk ka kryer deklarin të rremë.*
 - *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
42. Komisioni, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, ka çmuar se: [...] (iii) *Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe deklarin të rremë në Deklaratën-Vetting, për burimin e krijimit të këtyre pasurive.* (iv) *Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.*
43. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se faktet dhe konkluzionet e konstatuara nga Komisioni për pasurinë apartament me sipërfaqe 82,3 m² janë të pabazuara e mbi të gjitha nuk pasqyrojnë realitetin mbi gjendjen e pronës, duke mos marrë në konsideratë të gjitha provat, si dhe duke shtrembëruar faktet në provat ekzistuese.*

*Komisioni, në vendim¹¹, pas kryerjes së analizës financiare, ka arritur në përfundimin se subjekti rivlerësimi ka pasur mungesë të të ardhurave në vlerën 4.051.036 lekë, për të justifikuar blerjen e apartamentit me sipërfaqe 82,3 m², në vitin 2007. Për të arritur në këtë konkluzion përfundimtar, Komisioni ka arsyetuar se kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.2006, lidhur mes subjektit të rivlerësimi dhe shoqërisë së ndërtimit “{***}.” ShA, është një veprim “fiktiv” midis palëve. Në kushtet kur kontratën e sipërmarrjes e ka vlerësuar si një kontratë fiktive, e cila nuk ka pasur për qëllim krijimin e efekteve midis palëve, por vetëm plotësimin e kushteve për përfitim të kredisë së butë nga subjekti i rivlerësimi, Komisioni ka kryer analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, duke u bazuar në kontratën e shitjes së vitit 2007 të lidhur mes subjektit dhe z. M. Z. dhe, për pasojë, nuk ka marrë në konsideratë në përllogaritje, kredinë e butë në vlerën 5.000.000 lekë, që subjektit të rivlerësimi i është akorduar për blerje banese.*

44. Në analizë të shkakut të ankimit të sipërcituar të subjektit të rivlerësimi, nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstaton situatën faktike si vijon.

Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin *vetting*, subjekti ka deklaruar se ka fituar në pronësi apartamentin e banimit me sipërfaqe 169,65 m², me adresë: rruga {***}, {***}, ap. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, si pasojë e shkëmbimit të kësaj pasurie me një apartament me sipërfaqe 82,3 m², me adresë rruga “{***}”, shkalla {***}, kati {***}, ap. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***} me vlerë 5.200.000 lekë, si dhe 7.200.000 lekë. *Burimi i krijimit: Apartamenti i shkëmbyer me sipërfaqe 82,3 m² është blerë me kredinë e marrë pranë bankës Raiffeisen prej 5.000.000 lekësh dhe 200.000 lekë kursimesh të miat. Vlera 5.200.000 lekë.*

Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë për rivlerësimin, subjekti ka depozituar dokumentacionin, si vijon.

44.1 Kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2004, e lidhur mes shoqërisë së ndërtimit “{***}.” ShA, përfaqësuar nga z. A. M. në cilësinë e sipërmarrësit dhe komunitetit të pronarëve të një trualli në rrugën “{***}”, të familjeve Z., M., M., etj. Sipas nenit 1 të kësaj kontrate, sipërmarrësi zotohet të kryejë realizimin e investimit të objektit godinë polifunksionale, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, si dhe specifikime teknike, ndërsa porositësi kërkon përfitim fizik nga ky objekt të pjesës së tij, sipas raportit të përcaktuar në këtë kontratë, në shkëmbim të truallit të ofruar për ndërtimin e godinës. Sipas nenit 2, pika 2.5 e kontratës, porositësi do të përfitojë në fizik 25% të sipërfaqes bruto të ndërtimit të objektit që do të ndërtohet në truallin e tyre, pjesë e cila konsiston në garazhe, lokale, zyra e apartamente. Përcaktimi i garazheve, zyrave, lokaleve e apartamenteve do të bëhet me një aneks-kontratë, që palët do ta realizojnë menjëherë pas miratimit të projektit nga KRrT-ja.

44.2 Kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.2006, e lidhur mes shoqërisë së ndërtimit “{***}.” ShA, përfaqësuar nga z. A. M. në cilësinë e sipërmarrësit investitor dhe z. Eugen Beçi në cilësinë e porositësit. Sipas nenit 1 të kësaj kontrate, sipërmarrësi merr përsipër që t’i ndërtojë porositësit një apartament në katin e pestë, shkalla 1, ap. nr. 3, me sipërfaqe 90,5 m². Apartamenti, së bashku me aksesoret dhe sipërfaqet e pjesët e tjera në bashkëpronësi, do të ndërtohet me një çmim total prej 5.900.000 lekësh, sipas nenit 2 të kësaj kontrate. Ky çmim do të paguhet në këtë mënyrë: Kësti i parë do të paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate në shumën 900.000 lekë, ndërsa kësti i dytë do të paguhet deri më 20 dhjetor 2006, në shumën 5.000.000 lekë (neni 4 i kontratës). Sipas nenit 3 të kësaj kontrate, porositësi do të fitojë pronësinë e apartamentit me sipërfaqe 90,5 m², pas pagimit të këstit të fundit të çmimit të ndërtimit dhe pasi të jetë përfunduar ndërtimi i krejt godinës, deri në nëntor 2006. Kalimi i pronësisë do të bëhet nëpërmjet

¹¹Shihni paragrafët 76 dhe 102, nënndarja “iii” e vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, të Komisionit.

një kontratë të veçantë, të nënshkruar nga palët para noterit. Ndërsa, sipas nenit 7, sipërmarrësi mund t'i kalojë këtë kontratë, pa i ndryshuar asnjë kusht, një tjetër personi fizik ose juridik, të cilit do t'i transferohen marrëdhëniet kontraktore dhe pagesat me porositësin, të cilit kjo gjë do t'i komunikohet me një akt të shkruar.

44.3 Kontratë kredie bankare dhe hipoteke (blerje shtëpie banimi ose rikonstrukcion), nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.12.2006, e lidhur mes z. Eugen Beçi e znj. I. B. në cilësinë e bashkëkredimarrësve dhe Bankës Raiffeisen në cilësinë e kredidhënësës.

Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, banka është dakord t'i japë kredimarrësit një kredi në shumën deri në 5.000.000 lekë. Qëllimi i dhënies së kredisë është përdorimi i saj për blerje apartamenti. Kredia akordohet për një afat 300 muaj dhe ky afat do të fillojë që nga dita e disbursimit të parë. Kredimarrësi do të hapë një llogari rrjedhëse pranë bankës, në të cilën banka do të bëjë disbursimin e fondeve dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet disbursimi i kredisë. Përdorimi i kredisë do të bëhet me kërkesë të thjeshtë të kredimarrësit.

44.4 Kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.06.2007, e lidhur mes z. M. Z. në cilësinë e shitësit dhe z. Eugen Beçi në cilësinë e blerësit. Objekti i kontratës së shitjes është apartamenti i regjistruar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Tiranë, Zona Kadastrale {***}, me nr. pasurie {***}, me sipërfaqe 82,3 m² neto dhe 90,5 m² bruto. Apartamenti ka në përbërje dy dhoma dhe një kuzhinë, në katin e katërt, shkalla 1, si dhe pjesa takuese e truallit në godinën 9-katëshe në rrugën “{***}”, Tiranë. Shitësi deklaron se këtë pronë ia shet blerësit me një çmim prej 5.200.000 lekësh, shumë e cila, palët deklarojnë se është likuiduar jashtë kësaj zyre noteriale.

45. Nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se:

o ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 09.10.2018 dhe nr. {***} prot., datë 28.02.2019, ka përcjellë në Komision praktikën e regjistrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme, të apartamentit me sipërfaqe 82,3 m² në katin e {***}, shkalla {***}, në godinën me {***} kate në rrugën “{***}”, Tiranë. Informacioni konfirmon dokumentacionin e paraqitur nga subjekti bashkëlidhur deklaratës së pasurisë për rivlerësimin, por konstatohet gjithashtu se apartamenti me sipërfaqe 82,3 m² ka kaluar në pronësi të z. M. Z., në bazë të kontratës së shkëmbimit të pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.05.2007, të lidhur mes tij dhe shoqërisë “{***}.” ShA. Z. M. Z. është një nga pronarët e truallit mbi të cilin është ngritur godina polifunksionale {***}-katëshe në rrugën “{***}”, pjesë e së cilës është dhe apartamenti nr. {***} me sipërfaqe 82,3 m², shkalla {***}, kati i {***}, i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 24.05.2007, zona kadastrale {***}, me nr. pasurie {***}. Si pasojë e kontratës së shkëmbimit, shoqërisë “{***}.” ShA i ka kaluar në pronësi truallit i përshkruar më sipër, ndërsa z. M. Z. i ka kaluar në pronësi ndër të tjera edhe apartamenti si më sipër, me sipërfaqe 82,3 m². Pasuria është regjistruar në emër të z. Z. më datë 11.06.2007 dhe më pas, si rezultat i kontratës së shitjes së pasurisë të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.06.2007, është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit më datë 06.07.2007.

o Sipas informacionit të përcjellë nga Banka Raiffeisen me shkresën nr. {***} prot., datë 19.11.2018, kredia e marrë nga subjekti i rivlerësimit sipas kontratës së kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.12.2006, është disbursuar në llogarinë e subjektit më datë 26.12.2006. Kredia prej 5.000.000 lekësh në emër të subjektit të rivlerësimit ka interes 12% në vit, nga ku 3% paguhet nga subjekti dhe 9% nga Ministria e Financave, sipas marrëveshjes së lidhur më datë 20.06.2005, mes Ministrisë së Financave dhe Bankës Raiffeisen.

- Sipas të dhënave të llogarisë së kredisë në emër të subjektit të rivlerësimit në Bankën Raiffeisen, pas disbursimit të kredisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer këto transaksione:
 - datë 26.12.2006, disbursuar kredia në shumën 5.000.000 lekë;
 - datë 26.12.2006, konvertuar shumën 3.090.000 lekë në 25.000 euro;
 - datë 27.12.2006 është tërhequr *cash* shuma 25.000 euro;
 - datë 28.12.2006, kaluar në depozitë bankare fleksi shumën 1.700.000 lekë;
 - datë 4.1.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 500.000 lekë;
 - datë 5.1.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 500.000 lekë;
 - datë 15.3.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 500.000 lekë;
 - datë 16.3.2007, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 201.285 lekë.

○ Shoqëria “{***}.” ShA, me kërkesë të Komisionit, ka përcjellë informacionin¹², sipas të cilit: *Apartamenti që ka porositur shtetasi Eugen Beçi është me sipërfaqe 90,5 m² në katin {***}, shkalla {***}, apartamenti nr. {***}, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria në lagjen “{***}”. Këtë apartament shtetasi Eugen Beçi e ka porositur me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.2006. Duke u nisur nga kontrata e sipërmarrjes, të gjitha detyrimet shtetasi në fjalë i ka shlyer pranë firmës {***}. Por ndryshe nga kontrata e sipërmarrjes, ku ishte planifikuar dhe porosia e një garazhi, ky garazh nuk iu dha në pronësi porositësit dhe për këtë arsye ai ka paguar te firma {***}, gjithsej shumën prej 5.200.000 lekësh dhe jo 5.900.000 lekë, siç ishte parashikuar në kontratën e sipërmarrjes. Këto para janë shlyer: 3.200.000 lekë në vitin 2006 dhe 2.000.000 lekë në vitin 2007. Këto para janë paguar *cash* nga porositësi dhe pas shlyerjes së detyrimeve prej tij, më datë 11.06.2007, është përpiluar kontrata e shitjes përfundimtare të këtij apartamenti me nr. {***} rep., nr. {***} kol. Kjo kontratë shitjeje është përpiluar mes porositësit Eugen Beçi dhe shitësit M. Z., i cili ishte bashkëpronar i truallit ku u ndërtua pallati. Theksojmë se firma {***}, si shoqëri ndërtuese referuar dhe kontratës së sipërmarrjes (neni 7) dhe kontratës së sipërmarrjes me pronarët e truallit, kishte marrë përsipër dhe shitjen e apartamenteve takuese në pronësi të pronarëve të truallit dhe në rastin konkret të shitjes së apartamentit të shtetasit M. Z.. Apartamenti që i ka shitur shtetasi M. Z. shtetasit Eugen Beçi, është i njëjti apartament që përshkruhet në kontratën e sipërmarrjes. [...] Dokumentacionin si mandate, fatura etj., shoqëria nuk i disponon pasi ka kaluar një kohë shumë e gjatë e nuk janë më objekt kontrolli. Aktualisht shoqëria është me status pasiv.*

46. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2006, dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*Apartament banimi nr. {***}, shkalla {***}, kati {***}, sipërfaqe 90,5 m², lagjja “{***}”, pallati i ri pranë ish-ateliesë, me vlerë 5.900.000 lekë (kontratë sipërmarrjeje me {***}).*

Depozitë Banka Raiffeisen, depozituar 1.700.000 lekë nga kredia e marrë po te kjo bankë, e çelur më datë 28.12.2006

Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën kushtuar detyrimeve ndaj personave juridikë e fizikë, subjekti ka deklaruar kredinë në vlerën 5.000.000 lekë në Bankën Raiffeisen ShA, kredi në vlerën 600.000 lekë për blerje mobilie në Bankën e Tiranës, më datë 05.06.2006, si dhe “Hua firmës ndërtuese “{***}” për pjesën e papaguar të apartamentit të banimit të blerë. Vlera 2.000.000 lekë.”

Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2007, subjekti ka deklaruar:

Mbyllje depozite në Bankën Raiffeisen në fillim të vitit 2007, për pagesë kësti firmës ndërtuese për apartament banimi dhe prenotim garazhi. Vlera 1.700.000 lekë.

Përfunduar kontrata e shitjes për apartamentin e deklaruar në vitin 2006, regjistruar në ZVRPP me vlerën përfundimtare 5.200.000 lekë (vetëm apartamenti).

¹² Informacion i protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 21.11.2018.

*Prenotim garazhi me vlerë 700.000 lekë brenda vlerës së kontratës së sipërmarrjes me firmën ndërtuese “{***}”, deklarim i vitit të kaluar, sipërfaqe 10 m², në të njëjtën adresë me apartamentin. Vlera 700.000 lekë (brenda shumës 2 milionë paguar detyrim firmës {***}).*

Në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, ka deklaruar:

*Paguar detyrimi firmës “{***}” sipas kontratës së deklaruar në vitin 2006. Detyrimi i përgjithshëm 5.900.000 lekë i përbërë 5.200.000 lekë apartamenti + 700.000 lekë garazhi. Shuma e shlyer nga detyrimi i mëparshëm 2.000.000 lekë.*

Paguar firmës ndërtuese 5.000.0000 lekë nga kredia në RZ Bank e 900.000 lekë nga kursimet e viteve 2004-2006.

47. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar, në përgjigjet e protokolluara në Komision me nr. {***} prot., datë 26.12.2018:

*Shuma 5.000.000 lekë nuk iu pagua menjëherë shoqërisë “{***}” ShA sipas kontratës së sipërmarrjes, pasi u dakordësova me z. A. M. që të shlyeja këtë sasi parash, pasi të lëvrohej kredia ime për strehim, e cila më ishte miratuar, por ende nuk ishte lëvruar. [...] Duke qenë në marrëdhënie mirëbesimi dhe duke qenë se fakti i marrjes së kredisë sime ishte bërë i njohur, z. M. dhe kishte garanci në marrjen e parave që i detyrohesh, nuk kam paguar asnjë penaltitet lidhur me këtë vonesë, nëse konsiderohej si e tillë. [...] Çmimin e plotë të kontratës së sipërmarrjes, siç edhe kam deklaruar në deklaratat vjetore të pasurisë e kam shlyer në fund të vitit 2006, menjëherë pas lëvrimin të kredisë, 3.200.000 lekë dhe meqenëse ishte fundi i vitit 2006, shumën e mbetur ia kam shlyer firmës në vitin 2007. Këto para janë paguar kesh nga ana ime. Dokumentet e lëvizjes dhe tërheqjes së këtyre parave janë pasqyruar në llogarinë time në Bankën Raiffeisen dhe nuk disponoj mandat arkëtimi për këto pagesa nga firma “{***}”. [...] M. Z. ishte bashkëpronar në truallin ku u ndërtua pallati. Firma “{***}” si shoqëri ndërtuese kryente dhe shitjen e apartamenteve në pronësi të pronarëve të truallit, për këtë arsye u përpilua kontrata me shtetasin M. Z.. Nuk i kam paguar asnjë lek detyrime këtij shtetasi, por vetëm firmës “{***}”. [...] Çmimi i shitjes ishte përcaktuar në vlerën 5.900.000 lekë, së bashku me porosinë për blerjen e një garazhi, por unë kam paguar vetëm 5.200.000 lekë, pasi diferenca prej 700.000 lekë do paguhej nëse do merrja garazhin. Ishte menduar se do merrja dhe një garazh, por realisht nuk kam blerë atë dhe asnjëherë nuk u kalua në pronësinë time ky aset.*

*Në pyetësorin drejtuar subjektit të rivlerësimit me e-mail, datë 13.03.2019, Komisioni i ka kërkuar informacion, si vijon: Për blerjen e apartamentit të banimit me kontratë sipërmarrjeje me firmën “{***}”, ju keni deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 vlerën e apartamentit 5.900.000 lekë, për të cilat keni deklaruar se ka mbetur detyrim ndaj shoqërisë në fund të vitit 2006, shuma 2.000.000 lekë. Në deklaratën e vitit 2007 keni deklaruar se keni shlyer detyrimin ndaj firmës “{***}” në shumën 2.000.000 lekë, duke deklaruar se keni paguar nga kredia 5.000.000 lekë dhe 900.000 lekë nga kursimet e vitit 2004-2006, çka vërteton se për blerjen e apartamentit keni paguar 5.900.000 lekë gjithsej. Na vini në dispozicion dokumentin financiar që vërteton se shoqëria e ndërtimit ju ka kthyer shumën 700.000 lekë, diferencë kjo ndërmjet çmimit sipas kontratës së sipërmarrjes dhe kontratës së shitjes për blerjen e apartamentit.*

*Në përgjigjet e protokolluara në Komision me nr. {***} prot., datë 19.03.2019, subjekti ka deklaruar: [...] kam shlyer në fund të vitit 2006, menjëherë pas lëvrimin të kredisë, 3.200.000 lekë dhe meqenëse ishte fundi i vitit 2006, shumën e mbetur prej 2.000.000 lekësh ia kam shlyer firmës në vitin 2007. Këto para janë paguar cash nga ana ime në lekë, z. M.. Çmimi i shitjes ishte përcaktuar në vlerën 5.900.000 lekë, së bashku me porosinë për blerjen e një garazhi, por unë kam paguar vetëm 5.200.000 lekë, pasi nuk e bleva garazhin që kisha porositur në fillim. Kam paguar vetëm 5.200.000 lekë, pasi diferenca prej 700.000 lekësh do të paguhej nëse do merrja garazhin.*

[...] kam deklaruar në vitin 2007 prenotimin e një garazhi dhe ato para ishin cash nga ana ime për t'iu dhënë firmës “{***}”, por meqë garazhi nuk m'u dha, këto para siç sqarova nuk ia dhashë z. M.. Pra, kjo diferencë në çmim, nuk kishte nevojë të dokumentohej, pasi asnjëherë nuk u arkëtua për llogari të z. M., përfaqësues i firmës {***}.

Në përgjigjet e protokolluara në Komision me nr. {***} prot., datë 10.04.2019, për pyetësin e drejtuar më datë 05.04.2019, subjekti ka deklaruar: *Për arredimin e shtëpisë unë, në vitin 2006, kam shpenzuar 400.000 lekë. Për sa i përket mospërputhjes së datave të marrjes së kredisë për mobilim me datën e kontratës së sipërmarrjes, siç kam deklaruar, për shkak të njohjes me ndërtuesin A. M., unë e kam përdorur dhe kam banuar në këtë apartament qysh prej muajit qershor të vitit 2006. Pra, këtë apartament e kam mobiluar në vitin 2006 e jo në vitin 2007. Me ndërtuesin ramë dakord që të filloj ta përdor këtë apartament dhe më pas të përpilonim dokumentacionin përkatës, duke qenë se dhe nga institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme ishte arritur marrëveshja se ne do merrnim kredinë e butë për strehim. Kështu që ndërtuesi e kishte të sigurt marrjen e parave. [...].”*

48. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka deklaruar:

*M. Z. ishte bashkëpronar në truallin ku u ndërtua pallati. Firma “{***}” si shoqëri ndërtuese kryente dhe shitjen e apartamenteve në pronësi të pronarëve të truallit, për këtë arsye u përpilua kontrata me shtetasin M. Z.. Nuk i kam paguar ansjë lek detyrime këtij shtetasi, por vetëm firmës “{***}”. Pra bëhet fjalë për një marrëdhënie mes firmës ndërtuese dhe pronarëve të truallit, ku ndër ta ishte dhe shtetasi M. Z.. Nuk kam bërë asnjë shtrembërim të fakteve për të marrë kredinë e butë, pasi të dyja kontratat i referohen të njëjtit apartament. [...]*

*Nuk kam pasur asnjë arsye për të besuar se firma “{***}” do mohonte pagesën e kryer nga ana ime për llogari të firmës, çka do më bënte të ruaja mandatet e pagesave për një kohë kaq të gjatë. Faktet që unë kam deklaruar pranë ILDKPKI-së, në deklaratat vjetore të viteve 2006 dhe 2007, janë në përputhje dhe me transaksionet e pasqyruara nga Banka Raiffeisen. [...] në lidhje me kredinë e marrë në Tirana Bank, dua të qartësoj se është një keqkuptim, pasi konteksti i përgjigjes lidhet me faktin se ky likuiditet ka pasur si qëllim mobilimin e apartamentit që unë do blija. [...] Në qershor 2006 unë nuk kisha asnjë mundësi strehimi, por fakti që ishte dakordësuar procedura për marrjen e një kredie të butë nga ana ime, më krijoi mundësinë që të arrija një marrëveshje verbale me z. A. M. nga firma “{***}”. Duke qenë se me z. M. kishim njohje të mëparshme dhe pa asnjë konflikt interesi në marrëdhënie me të, ramë dakord që unë dhe familja ime të fillonim të banonim në apartamentin për të cilin më pas do të lidhnim të gjitha kontratat në vijim. Për marrjen e kredisë unë nuk kam përdorur asnjë kontratë tjetër sipërmarrje përveç asaj reale që përputhet me banesën që u strehova nga z. M. dhe që kaloi në pronësinë time. Për sa i përket mospërputhjes së deklarimeve të mia në deklaratën veting dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, ka qenë pasaktësi në deklarim edhe kjo është qartësuar edhe më përpara deklaratës veting, [...] përpara inspektorit të ILDKP, duke u mbajtur dhe procesverbali përkatës. Siç dhe është dokumentuar aty, në kontratën e shitblerjes së apartamentit, vërtetimit hipotekor, por edhe në deklaratimet e mia, çmimi i apartamentit ka qenë 5.200.000 lekë dhe asnjëherë unë nuk mora në pronësi apo në përdorim një garazh.*

49. Të njëjtat pretendime, subjekti i ka ngritur dhe në ankim, në kundërshtim të konkluzioneve të arritura nga Komisioni në vendim. Subjekti ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit se kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.2006, lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë së ndërtimit “{***}.” ShA, është një veprim “fiktiv” midis palëve, nuk është një konkluzion i bazuar në provat ekzistuese, duke përdorur të njëjtat argumente si në shpjegimet mbi

rezultatet e hetimit administrativ. Sipas subjektit, Komisioni ka interpretuar kontratat në mënyrë të padrejtë, çfarë ka sjellë një analizë financiare jologjike, pasi kredia është lëvruar në dhjetor 2006 dhe, për rrjedhojë, këto para kanë qenë të disponueshme për blerjen e apartamentit. Komisioni në tabelën e kësaj analize nuk ka përfshirë vlerën e kontratës së vitit 2007, për vlerën e shitjes së apartamentit, por vlerën e kontratës së sipërmarrjes të bërë në vitin 2006. Për pasojë, subjekti pretendon se, nëse analiza financiare kryhet bazuar në prova dhe në rezultatet e hetimit administrativ, nuk mund të nxjerrë një bilanc të tillë negativ.

50. Në verifikim të situatës faktike dhe të kontratave të cituara si më sipër, trupit gjykues i rezulton se është e njëjta pasuri objekt kontrate, apartamenti me sipërfaqe 82,3 m² i ndodhur në godinën polifunkcionale në rrugën “{***}”. Kontrata e sipërmarrjes e vitit 2006 dhe ajo e shitjes e vitit 2007 për apartamentin me sipërfaqe 82,3 m², janë lidhur nga subjekti i rivlerësimit me palë të ndryshme dhe kanë vlera të ndryshme, por objekti i kontratave është i njëjtë. Por kontrata, e cila ka krijuar pasoja juridike për palët, është kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.06.2007.

Komisionit, konkluzioni se kontrata e sipërmarrjes e vitit 2006 është një kontratë fiktive, e cila nuk ka pasur për qëllim krijimin e efekteve midis palëve, por vetëm plotësimin e kushteve për përfitimin e kredisë së butë nga subjekti i rivlerësimit, i ka shërbyer për të përcaktuar vitin 2007 si periudhë të kryerjes së analizës financiare, për të vlerësuar mjaftueshmërinë e burimeve të subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie, duke u bazuar në kontratën e shitjes së vitit 2007 dhe, për pasojë, nuk ka marrë në konsideratë në përlllogaritje, kredinë në vlerën 5.000.000 lekë, si të ardhur të subjektit të rivlerësimit, duke arsyetuar se kjo kredi e marrë në vitin 2006 nuk është përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2007.

Në ndryshim nga arsyetimi i përdorur prej Komisionit, në raport me situatën faktike të përshkruar më sipër, trupi gjykues arsyeton se rrethanat e faktit nuk të çojnë domosdoshmërisht në konkluzionin se kontrata e sipërmarrjes është një kontratë fiktive, në kushtet kur apartamentet objekt i kontratave [të sipërmarrjes dhe të shitjes] kanë përshkrim të njëjtë, sipërfaqe të njëjtë, ndodhen në të njëjtën godinë të ndërtuar nga shoqëria “{***}.” ShA, si dhe ka një marrëdhënie kontraktuale mes shoqërisë sipërmarrëse “{***}.” ShA dhe shitësit M. Z.. Në momentin e lidhjes së kontratës së shkëmbimit me z. M. Z. në maj 2007, shoqëria “{***}.” ShA ishte në kushtet e shitjes së një apartamenti, për të cilin kishte hyrë në marrëdhënie kontraktuale në tetor 2006, duke marrë përsipër ta ndërtonte për subjektin e rivlerësimit. Fakti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes të datës 23.03.2004, mes shoqërisë së ndërtimit “{***}.” ShA dhe komunitetit të pronarëve të truallit në rrugën “{***}”, mes të cilëve dhe z. Z., dhe lidhja më tej në qershor 2007 të kontratës së shitjes mes subjektit të rivlerësimit dhe z. Z. për të njëjtin apartament, plotëson panoramën e marrëdhënieve mes palëve.

Përpos këtyre argumenteve, trupi gjykues vlerëson se duhet konsideruar gjithashtu edhe fakti se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasuri të paluajtshme në pronësi në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, si dhe nga hetimi administrativ nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që të tregojë se shuma e marrë kredi është përdorur në ndonjë destinacion tjetër, në drejtim të pasurive të paluajtshme. Destinacioni i kredisë, sipas kontratës bankare të marrjes së kredisë, ka qenë përdorimi i saj për blerje apartamenti, pa u specifikuar pasuria konkrete. Ky destinacion është përmbushur, pasi subjekti i rivlerësimit ka blerë apartamentin në rrugën “{***}” sipas kontratës së shitjes, me sipërfaqe dhe adresë të njëjtë me apartamentin sipas kontratës së sipërmarrjes.

Bazuar në këtë arsyetim, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, trupi gjykues vlerëson se shuma e marrë kredi, në formën e kredisë së butë prej 5.000.000 lekësh, duhet të konsiderohet si një burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 82,3 m².

51. Në analizë të pretendimit të subjektit se analiza financiare për vitin 2007 është jologjike, pasi Komisioni në tabelën e kësaj analize nuk ka përfshirë vlerën e kontratës së vitit 2007 për vlerën e shitjes së apartamentit, por vlerën e kontratës së sipërmarrjes të bërë në vitin 2006 e për pasojë, analiza financiare nuk mund të nxjerrë një bilanc të tillë negativ, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues konstaton se subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision ka deklaruar se çmimin e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 82,3 m², në vlerën 5.200.000 lekë, ia ka paguar shoqërisë “{***}.” ShA, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.2006 dhe jo z. M. Z., sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.06.2007.

Subjekti, gjatë hetimit administrativ, ka pretenduar se kjo shumë prej 5.200.000 lekësh është paguar 3.200.000 lekë në vitin 2006 dhe 2.000.000 lekë në vitin 2007.

Sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.10.2006, çmimi total i apartamentit prej 5.900.000 lekësh do të paguhej i ndarë në këstin e parë, i cili do të paguhej me nënshkrimin e kësaj kontrate në shumën 900.000 lekë, ndërsa kësti i dytë do të paguhej deri më 20 dhjetor 2006, në shumën 5.000.000 lekë.

Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë kryerjen e pagesave sipas pretendimit të tij dhe as dokumentacion që të provojë dakordësinë me shoqërinë ndërtuese për riorganizimin e kësteve të pagesave të ndryshme nga parashikimi në kontratën e sipërmarrjes. Edhe shoqëria “{***}.” ShA ka konfirmuar kryerjen e pagesave sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit, por ka deklaruar mungesën e dokumentacionit për kryerjen e pagesave si mandate, fatura etj., për shkak të kohës së gjatë nga momenti i pagesave.

Në vijim të këtij arsytimi, trupi gjykues gjen me vend të theksojë faktin se një burim i rëndësishëm prove në procesin e rivlerësimit është deklarata e interesave privatë vjetorë periodikë, e cila si parashikuar nga neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përbën një dokument me vlerë provuese për këtë proces dhe, për më tepër, Kolegji ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar e koherent rreth vlerës provuese të këtij dokumenti në vendimet e dhëna prej tij.

Në zbatim të këtij kuadri ligjor, në mungesë të një dokumentacioni tjetër provues, trupi gjykues vlerëson se duhet të analizohen deklarimet e subjektit në deklaratat periodike të interesave në vitet 2006 dhe 2007, në lidhje me pagesat e kryera për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 82,3 m².

52. Në deklaratën periodike të vitit 2006, subjekti ka deklaruar se i ka paguar shoqërisë “{***}.” ShA, shumën prej 3.900.000 nga çmimi në total prej 5.900.000 lekë, sipas kontratës së sipërmarrjes për apartamentin me sipërfaqe 82,3 m², ndërsa në deklaratën e vitit 2007 ka deklaruar përfundimin e kontratës së shitjes në vlerën përfundimtare 5.200.000 lekë; pagimin e detyrimit të mbetur shoqërisë “{***}.” ShA në vlerën 2.000.000 lekë. Brenda kësaj shume është edhe vlera 700.000 lekë për prenotimin e një garazhi brenda vlerës së kontratës së sipërmarrjes, në të njëjtën adresë me apartamentin me sipërfaqe 82,3 m².

Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar se shoqërisë “{***}.” ShA i ka paguar 5.900.000 lekë, 5.000.000 nga kredia në Bankën Raiffeisen dhe 900.000 lekë kursimet.

Nga këto deklarime, rezulton se subjekti ka deklaruar se shuma e paguar gjithsej shoqërisë “{***}.” ShA është në vlerën 5.900.000 lekë.

53. Në deklarimet gjatë hetimit administrativ, por edhe në ankim, subjekti ka pretenduar se deklarimi në lidhje me garazhin ka qenë një pasaktësi, pasi ai asnjëherë nuk e ka paguar vlerën 700.000 lekë dhe nuk ka blerë apo marrë në pronësi këtë aset.

Pretendimet e tij në lidhje me pagesat e kryera, subjekti në mungesë të dokumentacionit financiar provues për kryerjen e tyre, i mbështet vetëm në deklaratimet e shoqërisë “{***}.” ShA në informacionin e përcjellë nga kjo shoqëri me kërkesë të Komisionit dhe të protokolluar në këtë të fundit me nr. {***} prot., datë 21.11.2018. Shoqëria “{***}.” ShA informon se ndryshe nga kontrata e sipërmarrjes, ku ishte planifikuar dhe porosia e një garazhi, ky garazh nuk iu dha në pronësi porositësit dhe për këtë arsye ai ka paguar te shoqëria “{***}.” ShA, gjithsej shumën prej 5.200.000 lekësh dhe jo 5.900.000 lekë. Ky deklaram nuk mbështetet në objektin e kontratës së sipërmarrjes, sipas së cilës subjekti kishte porositur vetëm një apartament me vlerë 5.900.000 lekë. Në këtë kuptim, deklaratimet e shoqërisë nuk sjellin asnjë relevancë në drejtim të provueshmërisë së pretendimeve të subjektit, pasi nuk mbështeten në përmbajtjen e akteve të nënshkruara nga vetë palët.

54. Në këto kushte, arrihet në përfundimin se, bazuar në vetë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, shuma e paguar prej tij te shoqëria “{***}” ShA, deri në lidhjen e kontratës së shitjes, datë 11.06.2007, është 5.900.000 lekë.
55. Duke u mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, fotografimi i situatës faktike të vitit 2007, në lidhje me pagesat e kryera prej tij, është pagesa e vlerës totale prej 5.900.000 lekësh kundrejt shoqërisë “{***}.” ShA¹³, vlerë kjo e rëndësishme për periudhën e analizës financiare. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti ka lidhur kontratë sipërmarrjeje apo shitblerjeje për garazhin dhe nuk ka të regjistruar në pronësi të tij një pasuri të tillë. Shuma prej 700.000 lekësh mund t'i jetë kthyer subjektit nga shoqëria “{***}.” ShA pas vitit 2007, megjithëse subjekti nuk e ka deklaruar asnjëherë kthimin e saj, por ky prezumim nuk përbën relevancë për zgjidhjen e çështjes, pasi periudha e analizës financiare është viti 2007. Në konkluzion, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit që ka përfshirë në analizën financiare vlerën 5.900.000 lekë në zërin apartament banimi, duke përfshirë vlerën e kontratës së shitjes prej 5.200.000 lekësh, si dhe pagesën prej 700.000 lekësh për garazhin.
56. Subjekti, në ankim, por edhe gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se shuma prej 3.200.000 lekësh është paguar në vitin 2006 dhe shuma prej 2.000.000 lekësh është paguar në vitin 2007, por pa deklaruar një datë se kur janë kryer këto pagesa. Pagesat e mësipërme, subjekti ka pretenduar se janë në përputhje me deklaratimet e tij në deklaratat periodike 2006 dhe 2007 dhe konfirmohen edhe në transaksionet e pasqyruara nga Banka Raiffeisen. Në verifikim të këtij pretendimi të subjektit, sipas informacionit të përcjellë nga Banka Raiffeisen, tërheqja e kredisë është kryer në një periudhë kohore nga data 27.12.2006 deri më 16.03.2007 dhe frekuenca e tërheqjes së saj është: më datë 27.12.2006 tërhequr *cash* shuma 25.000 euro, ndërsa më datë 28.12.2006 është kaluar në depozitë bankare fleksi shuma 1.700.000 lekë, e cila më pas është tërhequr në shumat prej 500.000 lekësh nga janari deri në mars të vitit 2007.
57. Në përmbushje të parashikimit kontraktor të sipërmarrjes, se shuma prej 5.900.000 lekësh do të shlyhej tërësisht brenda datës 20 dhjetor 2006, si dhe në përputhje me deklaratimet e subjektit se shoqëria “{***}.” ShA ishte në dijeni të marrjes prej tij të një kredie të butë dhe për këtë arsye ishte i sigurt se pagesat do të kryheshin prej tij. Mospagimin e vlerës së plotë të kontratës në vitin 2006, subjekti, gjatë hetimit administrativ, e ka justifikuar me marrëdhëniet e miqësisë që ekzistonin mes tij dhe përfaqësuesit të shoqërisë “{***}.” ShA, z. A. M..

¹³ Duke mbajtur në konsideratë se deklarimi periodik dorëzohet pranë ILDKPKI-së, deri në datën 31 mars të vitit pasardhës të deklaratimit.

58. Bazuar në arsyetimin e bërë në paragrafin 50 të këtij vendimi, pra duke konsideruar se kredia e butë në vlerën 5.000.000 lekë është përdorur nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi i pasurisë objekt shqyrtimi; duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratimet periodike të interesave, në lidhje me mënyrën e kryerjes së pagesave kundrejt shoqërisë “{***}.” ShA, si dhe tërheqjet e pjeshme të kësaj kredie, sipas të dhënave të llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në të cilën është disbursuar kredia, në Bankën Raiffesisen, arrijmë në konkluzionin se vlera prej 3.900.000 lekësh është paguar nga subjekti në vitin 2006 dhe diferenca prej 2.000.000 lekësh është paguar në vitin 2007.
59. Në mbështetje të këtij arsyetimi, në Kolegj u krye analiza financiare për të vlerësuar nëse subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të kryente pagesën e vlerës së mbetur prej 2.000.000 lekësh, si detyrim ndaj shoqërisë “{***}.” ShA, duke konsideruar që këto pagesa duhet të ishte shlyer deri në datën e lidhjes së kontratës së shitjes së kësaj pasurie, më datë 11.06.2007, ndërmjet subjektit dhe z. M. Z.. Si rezultat i kësaj analize, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për pagesën e detyrimit ndaj shoqërisë “{***}.” ShA, në vlerën 221.935 lekë. Kjo mungesë financiare nuk u konsiderua nga trupi gjykues i Kolegjit si një balancë negative e mjaftueshme për t’u ngritur në nivel shkaku shkarkimi.
60. Komisioni, në vendim¹⁴, ka kryer analizën financiare për vitin 2007, bazuar në provat dhe në deklaratimet e subjektit, duke vendosur që shpenzimet për pagesën e shkollës të fëmijës së tij, të llogariten si të kryera nga subjekti i rivlerësimit.
61. Ky konkluzion është kundërshtuar nga subjekti, i cili ka pretenduar se në lidhje me shpenzimet e shkollimit të fëmijës së tij, Komisioni ka interpretuar në mënyrë të njëanshme deklaratimet e tij gjatë hetimit, pasi ai është përgjigjur për aq sa është pyetur, pra për shtatë vitet e fundit, duke mos përfshirë vitin 2007. Subjekti kërkon nga Kolegji që të mos merren në konsideratë në analizën financiare të vitit 2007, shpenzimet e shkollimit të fëmijës së tij, pasi ai ka deklaruar financimin e tyre nga prindërit e bashkëshortes, kur është kërkuar sipas ligjit, ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, nuk kishte si të deklaronte një shpenzim që nuk e kërkonte formulari dhe ligji, pasi shpenzimi për shkollimin e fëmijës atë vit, ishte dukshëm më i ulët se 300.000 lekë që është vlera mbi të cilën deklarohen shpenzimet.
62. Lidhur me këtë pretendim, nga aktet e hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se në përgjigje të pyetësorit standard, pyetjes së Komisionit: *A keni marrë ndonjë dhuratë me vlerë mbi 500 euro apo ka financuar dikush një shpenzim për llogarinë tuaj në një shifër më të lartë se kjo shumë në shtatë vitet e fundit (respektivisht 2011-2017)?* – subjekti ka deklaruar: *Kanë shpenzuar për llogari të shkollimit të fëmijëve të mi [...] shumën prej 108.000 lekësh në vit për secilin nga fëmijët, nga viti 2011 deri në vitin 2014 (gjithsej tri vite shkollore), shuma 648.000 lekë, prindërit e bashkëshortes sime L. dhe Sh. L.. (Burimi: të ardhura nga kursimet e tyre dhe para të dërguara nga dy vajzat e tyre I. L., banuese në {***}, {***}, Kanada dhe E. L., banuese {***} USA).*
63. Në përgjigje të pyetësorit të drejtuar nga Komisioni më datë 17.12.2018, kërkesës së Komisionit: *Ju keni deklaruar se prindërit e bashkëshortes suaj kanë paguar shpenzimet e shkollimit të fëmijëve tuaj në shumën 648.000 mijë lekë. Do t’ju luteshim të na vini në dispozicion dokumentacionin provues mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të bashkëshortes suaj* – subjekti ka deklaruar: *Bashkëlidhur ju kam dërguar kopje të dokumentacionit që vërteton të ardhurat e prindërve të bashkëshortes, ku përfshihen të ardhura nga pensionet e tyre, puna e nënës së bashkëshortes nga një shkollë private në Vlorë, të ardhurat e tyre të përfuara nga firmat*

¹⁴ Lutemi, shihni paragrafët 72-75 të vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, të Komisionit.

piramidale dhe kopje të dokumentacionit që janë ndihmuar këto vite nga dy vajzat e tyre që jetojnë jashtë Shqipërisë.

64. Nga deklaratimet e subjektit si më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti fillimisht ka deklaruar se prindërit e bashkëshortes kanë mbuluar shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij nga viti 2011 – 2014, në shumën prej 648.000 lekësh, si dhe e ka rikonfirmuar këtë fakt edhe në deklaratimet e mëpasshme, duke mos deklaruar në asnjë moment se shpenzimet e shkollimit të fëmijëve janë përballuar nga prindërit e bashkëshortes edhe për vitin 2007.
65. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur në Komision vërtetimin nr. {***} prot., datë 24.10.2018, dhe vërtetimin nr. {***} prot., datë 24.10.2018, të lëshuar nga Kolegji “{***}”, sipas të cilëve shpenzimet e shkollimit për të dy fëmijët e subjektit për periudhën 2007-2014 janë në vlerën totale 1.296.000 lekë, ndërsa vetëm për vitin 2007, nga përlllogaritjet, rezulton të jenë në vlerën 48.000 lekë, sa ka përlllogaritur Komisioni.
66. Pretendimin se shkollimi i fëmijëve është financuar nga prindërit e bashkëshortes së tij për vitin 2007, subjekti e ngre për herë të parë në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në të cilat ka deklaruar: *Në analizën financiare të vitit 2007, ju keni përfshirë si shpenzime të kryera nga unë, shpenzimet për pagesën e shkollës së fëmijës tim. Referuar atyre çfarë kam shpjeguar dhe deklaruar, por referuar edhe deklaratës noteriale të bërë nga prindërit e bashkëshortes sime, ku shpjegojnë se kanë financuar shkollimin e nipërve të tyre, kërkoj nga ju të merret në konsideratë ky fakt dhe për këtë arsye të hiqen nga unë këto shpenzime.*
67. Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.06.2019, të prindërve të bashkëshortes, z. L. L. e znj. Sh. L., të cilët deklarojnë se: *[...] në cilësinë e gjyshit dhe gjyshes së nipërve tanë, deklarojmë se ne të dy kemi qenë financues të shkollimit të tyre pranë Kolegjit “{***}”, Tiranë. [...] Një nga faktorët që kemi pasur mundësinë të përballojmë shkollimin e nipërve tanë kanë qenë dhe pagesa e mirë e pensionit që ne të dy përfitojmë, si dhe punësimi i Sh. L. pranë shkollës jopublike 9-vjeçare “{***}”, Vlorë. Mbështetja financiare nga vajzat tona I. L. dhe E. L. gjatë vizitave të tyre në Shqipëri ose të parave të dërguara nëpërmjet të afërmeve tanë, na kanë bërë të mundur lehtësimin dhe përballimin e shpenzimeve tona. Pagesat e shkollimit të nipërve tanë ia kemi dorëzuar gjithmonë vajzës sonë I. B., sa herë na jepej mundësia të udhëtonim drejt Tiranës, ose anasjelltas, sa herë vajzës i jepej mundësia të udhëtonte drejt Vlorës.*
68. Kjo deklaratë e prindërve të bashkëshortes së subjektit është bërë gjatë hetimit administrativ të Komisionit, dhe jo në kohën e kryerjes së veprimit të financimit të shkollimit të fëmijës së subjektit.
69. Subjekti, në ankim, megjithëse ka pretenduar se shkollimi i fëmijëve është financuar nga prindërit e bashkëshortes, ka argumentuar se ai nuk kishte detyrimin të deklaronte shpenzimet e shkollimit për këtë vit, pasi ato kanë qenë nën nivelin e shpenzimeve të deklarueshme. Ky argument i subjektit vjen si pasojë e konstatimit të Komisionit në vendim se subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 nuk ka deklaruar se është financuar nga prindërit e bashkëshortes për shkollimin e fëmijës në kolegjin “{***}”.
70. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave të subjektit, nga viti 2007 deri në vitin 2014, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka deklaruar në asnjërin prej këtyre deklaratave financimin ose dhurimin e pagesës së shkollimit të fëmijëve të tij nga prindërit e bashkëshortes, në përmbushje të detyrimit për deklarim, sipas formularit të deklarimit në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale”, i cili kërkon përshkrimin hollësisht të

Ilojtit të dhuratës në vlerën mbi 10.000 lekë, nga deklarimi i mëparshëm deri në datën 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si detyrim që rrjedh nga ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, i cili në nenin 15, pika 1, shkronja “b” përcakton se në interesat privatë që deklarohen periodikisht, përfshihen dhuratat a trajtimet preferenciale, si dhe identiteti i personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen ato.

71. Kjo dispozitë përcakton gjithashtu se nuk deklarohen dhurata ose trajtimi preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10.000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi. Në këtë kuptim, deklaratet e prindërve të bashkëshortes së subjektit, në deklaratën noteriale të hartuar prej tyre për efekt të procesit të hetimit administrativ të rivlerësimit, me qëllim justifikimin e burimit të shpenzimeve të kryera nga subjekti për shkollimin e fëmijëve të tij, nuk përputhen me atë që ka deklaruar subjekti në deklaratat periodike të interesave, në vitet kur janë kryer këto shpenzime. Ky arsyetim gjen mbështetje edhe në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit deklaratat e mëparshme të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, mund të përdoren si provë. Bazuar në këtë arsyetim, trupi gjykues arrin në përfundimin se është i drejtë konkluzioni i Komisionit për të përlloritur shpenzimet e shkollimit të fëmijës së subjektit, si shpenzime të kryera nga vetë subjekti i rivlerësimit në vitin 2007.
72. Në vijim të arsyesimit më sipër, u krye analiza financiare në Kolegji sipas së cilës arrihet në konkluzionin se nga analiza financiare e kryer për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit, pavarësisht korrektimit të rezultatit negativ të konkluduar prej Komisionit, mbetet me një balancë negative, në shumën 392.057 lekë. Kjo mungesë financiare nuk u konsiderua nga trupi gjykues i Kolegjit si një balancë negative e mjaftueshme për t'u ngritur në nivel shkaku shkarkimi.
73. Subjekti ka pretenduar në ankim se konkluzionet e nxjerra nga Komisioni në lidhje me këtë pasuri janë të pabazuara në ligj e prova, pasi:
 - a) Aktet juridike, kontratat me akte noteriale, nëse nuk janë deklaruar nga një gjykatë si të pavlefshme, fiktive apo të simuluar, nuk mund të interpretohen dhe cilësohen si të tilla nga Komisioni, i cili në rastin konkret është organ administrativ dhe nuk e ka këtë kompetencë. Një gjë e tillë bëhet vetëm në rrugë gjyqësore, nëse e kërkon njëra nga palët e përfshira në kontratë, në përputhje kjo edhe me atë që parashikon Kodi i Procedurave Administrative se është provë çdo kontratë, deklaratë noteriale, madje edhe pohimet e palëve.
 - b) Veprimet juridike të kryera nuk përbëjnë bazë për masë disiplinore, siç u mor në rastin konkret ndaj subjektit me vendimin nr. 171, datë 26.06.2019.
74. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues arsyeton se është një pretendim i pabazuar, pasi organet e rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit vlerësojnë fakte dhe prova në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, për të vërtetuar nëse në kuptim të legjislacionit në fuqi, a konsiderohet ose jo, si burim i ligjshëm, burimi i deklaruar i krijimit të pasurisë. Vlerësimi dhe cilësimi që u japin fakteve dhe rrethanave organet e rivlerësimit, gjatë procesit të rivlerësimit, vlejné vetëm për këtë proces, me qëllim identifikimin e subjekteve që nuk plotësojnë kushtet për të qëndruar në detyrë, në përputhje me parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Në procesin e rivlerësimit, konstatimi i fiktivitetit të veprimeve juridike nuk ka për qëllim dhe nuk mund të sjellë zgjidhjen e pasojave të palët, por është një analizë e ligjshmërisë ose jo të veprimeve juridike të kryera, të cilat ndikojné në legjitimitetin e pasurisë së krijuar si rezultat i këtyre veprimeve, ku kjo e fundit është objekt verifikimi për sa i përket ligjshmërisë në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

75. Nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, rezulton se Komisioni ka arsyetuar në paragrafin 71 të këtij vendimi: *71. Në kushtet kur kontrata e sipërmarrjes u vlerësua si një kontratë fiktive, e cila nuk pa pasur për qëllim krijimin e efekteve midis palëve, por vetëm plotësimin e kushteve për përfitimin e kredisë së butë nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vendosi, pas rezultateve të hetimit që analizën financiare për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme, ta bëjë duke u bazuar në kontratën e shitjes së vitit 2007.*
76. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se Komisioni, konkluzionin mbi fiktivitetin e kontratës së sipërmarrjes së vitit 2006, e ka përdorur duke analizuar pasojat e saj në analizën financiare për vitin 2007, vit në të cilin është lidhur kontrata e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 82,3 m² dhe jo si bazë për dhënien e masës disiplinore ndaj subjektit. Edhe në konkluzionet mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, dhe në konkluzionet përfundimtare, në vendim, fiktiviteti nuk është përmendur si një nga arsyet e dhënies së masës disiplinore.
77. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konstatimet e Komisionit në lidhje me një kredi të marrë në Bankën e Tiranës, janë rezultat i një keqkuptimi, pasi gjatë hetimit ai ka deklaruar se ky likuiditet ka pasur si qëllim mobilim apartamenti.
78. Komisioni, në vendim, ka konstatuar se në deklaratën periodike të interesave të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e një kredie bankare nga Tirana Bank, në shumën 600.000 lekë, të disbursuar në datën 08.06.2006, për arredim apartamenti. Kjo kredi bankare për arredim apartamenti është shlyer nga subjekti në datën 04.07.2006 nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 607.000 lekë.
79. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e datës 26.12.2018 mbi pyetësonin e drejtuar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se kredinë në Tirana Bank, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.06.2006, e ka marrë me qëllim mobilimin e apartamentit që kishte blerë në rrugën “{***}” dhe e ka shlyer brenda vitit 2006 me të ardhurat dhe kursimet e tij. Në përgjigjet e datës 19.03.2019, në lidhje me të njëjtën kredi, ka deklaruar: *Për të arretuar shtëpinë që kisha marrë në atë vit, kisha menduar se do të më duheshin shumë më tepër para se sa kisha në dispozicion nga kursimet e mia ndër vite dhe, për këtë arsye, kam marrë këtë kredi. Meqenëse kjo shumë e marrë nuk m’u nevojiti për ta përdorur, pasi kisha kursim, një shumë të tillë e shleva menjëherë kredinë me qëllim të mos paguaja dy herë interesa, pasi do të merrja dhe kredinë për blerjen e banesës.*
80. Sipas informacionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja në Komision, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.04.2019, në lidhje me kontrollin e kryer nga ky institucion për deklaratimet e interesave private të subjektit për periudhën 2003-2014, nga procesverbali i datës 05.09.2016, konstatohet se z. Eugen Beçi ka deklaruar se ka marrë në vitin 2006 një kredi në shumën 600.000 lekë në Tirana Bank dhe e ka përdorur për mobilimin e apartamentit.
81. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, ndër të tjera edhe për gjetjen: *Për sa duket se për kredinë e marrë në Tirana Bank, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të rremë gjatë hetimit administrativ.* Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka sqaruar: *Për sa u përket konstatimeve në lidhje me kredinë e marrë në Tirana Bank, dua të qartësoj se është një keqkuptim, pasi konteksti i përgjigjes lidhet me faktin se ky likuiditet ka pasur si qëllim mobilimin e apartamentit që unë do blija. Këtu ka qenë dhe ideja e të dyja përgjigjeve pranë ILDKPKI-së dhe në pyetësonët tuaj.*

82. Në vendim, Komisioni nuk u ka qëndruar rezultateve të hetimit administrativ në lidhje me deklarimin e rremë të konstatuar gjatë procesit të hetimit administrativ, por faktin e marrjes së kredisë nga subjekti, në Tirana Bank, më datë 07.06.2006, për mobilim banese, para lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, datë 03.10.2006, për apartamentin, e ka renditur si një nga rrethanat që e kanë çuar në përfundimin se kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 3.10.2006, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë së ndërtimit “{***}.” ShA, është një veprim fiktiv midis palëve.

Trupi gjykues i Kolegjit në analizë të këtij pretendimi të subjektit, në raport me përmbajtjen e vendimit të Komisionit, vlerëson se, për sa kohë që nuk u gjet i bazuar konkluzioni i Komisionit se kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 3.10.2006, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë së ndërtimit “{***}.” ShA, është një veprim fiktiv midis palëve, si dhe duke qenë se Komisioni nuk e ka konsideruar kredinë e marrë si një nga shkaqet për shkarkimin nga detyra të subjektit, pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë rrethanë nuk është relevant.

83. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni në arsyetimin e tij, në lidhje me kontratën për shkëmbimin e apartamentit me sipërfaqe 83,2 m² me një apartament me sipërfaqe 169,65 m², ka interpretuar pa të drejtë provat e administruara për këtë kontratë dhe, për rrjedhojë, ka arritur në konkluzione të pabazuara në ligj.*

Komisioni, në vendim¹⁵, në lidhje me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 169,65 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se:

- i. subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie, në përputhje me paragrafin 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës;
- ii. bazuar në analizën financiare, subjekti ka mungesë të të ardhurave në vlerën – 4.027.816 lekë, për të justifikuar shkëmbimin e apartamenteve në vitin 2014;
[...]
- iv. subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në deklaratën e rivlerësimit, pasi nuk ka paraqitur si burim për krijimin e kësaj pasurie huan e marrë nga babai i tij.

84. Nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se: Në lidhje me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, se ai ka në pronësi: *Apartment banimi sipërfaqe 169,65 m², me adresë: rruga {***}, {***}, ap. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, përftuar nga shkëmbimi i pasurisë së paluajtshme me z. A. R.. Për shkëmbimin e kësaj prone, në pronësi të z. A. R. kaloi apartamenti im me sipërfaqe 82,3 m², rruga “{***}”, shkalla {***}, kati {***}, ap. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, si dhe shuma prej 7.200.000 lekësh (kontratë shkëmbimi pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2014, deklarata datë 18.02.2014, deklaratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014). Nga kjo shumë dhënë 4.400.000 lekë në vitin 2014. (4.000.000 lekë ua kam marrë vëllezërve të mi, si dhe 400.000 lekë nga kursimet). Pjesën e mbetur ia shlyej çdo vit A. R. me nga 400.000 lekë në vit. Vlera: Shkëmbimi me një apartament me sipërfaqe 82,3 m² me vlerë 5.200.000 lekë, si dhe 7.200.000 lekë. Pjesa takuese 50% (50% bashkëshortja).* Bashkëlidhur deklaratës, subjekti ka paraqitur:

¹⁵Shihni paragrafin 102 të vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, të Komisionit.

84.1 Kontratë shkëmbimi pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2014, e lidhur mes z. A. R. dhe z. Eugen Beçi, të cilët bien dakord që në pronësi të z. A. R. do të kalojë apartamenti me sipërfaqe 82,3 m², me adresë rruga “{***}”, shkalla {***}, kati {***}, ap. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, zona kadastrale {***}, vol. {***}, f. {***}, ndërsa në pronësi të z. Eugen Beçi do të kalojë apartamenti me sipërfaqe 169,65 m², me adresë: rruga {***}, {***}, ap. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, zona kadastrale {***}, vol. {***}, fq. {***}. Meqenëse pronat kanë qenë të lira nga çdo barrë e hipotekë, palët kanë rënë dakord që dorëzimi të bëhet me nënshkrimin e kësaj kontrate shkëmbimi.

84.2 Deklaratë, datë 18.02.2014, e z. A. R. dhe z. Eugen Beçi, të cilët deklarojnë se: *Kemi nënshkruar para noterit kontratën e shkëmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2014 për pasuri të paluajtshme. Në ekzekutim të kësaj kontrate, z. Eugen Beçi deklaroi se përveç apartamentit me sipërfaqe 82,3 m² të përfutur nga kontrata e shkëmbimit, z. A. R. do të përfitojë një vlerë monetare në shumën 7.200.000 lekë, nga të cilat 4.000.000 lekë i jepen z. A. R., sot, cash në dorë, me përpilimin e kësaj deklarate, ndërsa shuma tjetër prej 3.200.000 lekësh do të shlyhet gradualisht për një periudhë 8-vjeçare, sipas kushteve të deklaruara e të përpiluara në një periudhë të mëvonshme përpara noterit.*

84.3 Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014, e z. A. R. dhe z. Eugen Beçi, të cilët deklarojnë se: *Deklaruesit kanë nënshkruar kontratën e shkëmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2014, për pasuri të paluajtshme. Në ekzekutim të kësaj kontrate, z. Eugen Beçi deklaroi se përveç apartamentit me sipërfaqe 82,3 m² të përfutur nga kontrata e shkëmbimit, z. A. R. do të përfitojë edhe një vlerë monetare në shumën 3.200.000 lekë. Kjo shumë do të shlyhet gradualisht për një periudhë 8-vjeçare nga 400.000 lekë çdo vit, veprim i cili do të evidentohet me deklaratë noteriale dhe do të fillojë nga viti 2014.*

84.4 Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.12.2015, e z. A. R. dhe z. Eugen Beçi, të cilët deklarojnë se: *[...] Sot palët deklarojnë se z. Eugen Beçi i ka likuiduar z. A. R. shumën prej 400.000 lekësh që i përket vitit 2015. Deklarimi do të vazhdojë për vitet në vazhdim sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014.*

84.5 Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.11.2016, e z. A. R. dhe z. Eugen Beçi, të cilët deklarojnë se: *[...] Sot palët deklarojnë se z. Eugen Beçi i ka likuiduar z. A. R. shumën prej 400.000 lekësh që i përket vitit 2015. Deklarimi do të vazhdojë për vitet në vazhdim sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014.*

84.6 Deklaratë e z. G. B. dhe z. Eugen Beçi, të cilët deklarojnë se z. G. B., më datë 15.02.2018, me vullnetin e tij të lirë i ka dhënë hua vëllait të tij z. Eugen Beçi, shumën prej 2.000.000 lekësh, për arsye personale, të cilat do t'i kthehen prej tij pa interesa, në momentin më të parë të mundshëm. Huamarrësi deklaroi se këtë shumë e ka marrë dhe do ta kthejë në momentin e parë që do të ketë mundësi objektive për ta bërë, po sigurisht pa kaluar afati prej 15 vjetësh.

84.7 Deklaratë e z. S. B. dhe z. Eugen Beçi, të cilët deklarojnë se z. S. B., më datë 15.02.2018, me vullnetin e tij të lirë i ka dhënë hua vëllait të tij, z. Eugen Beçi, shumën prej 2.000.000 lekësh, për arsye personale, të cilat do t'i kthehen prej tij pa interesa, në momentin më të parë të mundshëm. Huamarrësi deklaroi se këtë shumë e ka marrë dhe do ta kthejë në momentin e parë që do të ketë mundësi objektive për ta bërë, po sigurisht pa kaluar afati prej 15 vjetësh.

85. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, ka rezultuar se, sipas informacionit të përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 16.11.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,

nga regjistrimet hyrje-dalje në sistemin TIMS rezulton se në datën 15.02.2014, e deklaruar si data e dhënies së huas, z. G. B. dhe z. S. B. nuk kanë qenë në Shqipëri.

86. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit të drejtuar nga Komisioni¹⁶, për pasurinë apartament me sipërfaqe 169,65 m², subjekti ka deklaruar:

Shuma prej 7.200.000 lekësh nuk është përfshirë në asnjë nga aktet noteriale që kam përpiluar, pasi me shtetasin A. R. vendosëm të përpilojmë një deklaratë të dy bashkë, ku përmendëm këtë shumë dhe formën e shlyerjes së saj, që ishte se përveç apartamentit të përfutur nga kontrata e shkëmbimit, z. A. R. do të përfitojë një vlerë monetare në shumën 7.200.000 lekë, nga të cilat 4.000.000 lekë i jepen z. A. R., sot, cash në dorë, me përpilimin e kësaj deklarate, ndërsa shuma tjetër prej 3.200.000 lekë do të shlyhen gradualisht për një periudhë 8 vjeçare. Dhe një fakt i tillë lejohej dhe nga Kodi Civil.

Kjo shumë nuk u përfshi në kontratën e shkëmbimit, pasi u mendua që kontrata tip e shkëmbimit të mos prekej e të mbahej sipas standardit të saj, duke plotësuar dokumentacion shtesë për kompensimin e shumës që duhet t'i jepja z. A. R., për shkak të diferencës në sipërfaqe të apartamentit që do përfitoja si rrjedhojë e shkëmbimit. [...] Detyrimet e shlyera në vitin 2014 i kemi bërë cash dhe janë dokumentuar në këtë deklaratë ku shprehemi si palë, që kemi filluar që këtë vit me dhënien e vlerës prej 400.000 lekësh, duke e konsideruar të mjaftueshëm këtë fakt në deklaratën noteriale të datës 27.08.2014 ku shprehemi se ky detyrim shlyhet duke filluar nga ai vit, pra 2014.

*Duke iu referuar marrëdhënies së mirëbesimit dhe njohjeve të vjetra shoqërore familjare me z. R., menduam që referuar dhe neneve 80,81,83, 750 dhe 757 e vijues të Kodit Civil, këtë marrëdhënie detyrimesh ta konsideronim të dokumentuar në këtë formë. Gjithsesi rikonfirmojmë vullnetin tonë të pavesuar me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.12.2018.*

Gjithashtu, në përgjigjet e këtij pyetësori, subjekti ka deklaruar në lidhje me huanë e marrë z. G. e S. B., në vlerën 4.000.000 lekë, si vijon:

Këtë hua unë e kam marrë në shtëpinë e babait tim V. Th. B., në qytetin e Librazhdit, më datë 15.02.2014, me pëlqimin e vëllezërve të mi, G. e S. B., të cilët këto para i kishin sjellë cash në periudha të ndryshme kohore të shtëpia e prindërve, pasi kishin vite që punonin në emigracion në Greqi. Këtë hua e kam marrë cash. Këto para vëllezërit e mi i kanë sjellë në Shqipëri në sasi të ndryshme në gjendje cash, kur kanë udhëtuar për pushime apo për të takuar prindërit dhe meqë kanë qenë shuma që nuk kalonin kufirin e shumës që duhej deklaruar, nuk e kanë deklaruar në kufi kalimin e parave.

Bashkëlidhur përgjigjeve të cituara si më sipër, subjekti ka paraqitur në Komision dokumentacionin si vijon.

86.1 Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.12.2018, e z. A. R. dhe z. Eugen Beçi, të cilët deklarojnë se: *Më datë 18.02.2014, kanë nënshkruar midis tyre një deklaratë, të cilën sot e materializojnë me akt noterial, përmbajtjen e saj si më poshtë: Kemi nënshkruar para noterit kontratën e shkëmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2014, për pasuri të paluajtshme. Në ekzekutim të kësaj kontrate, z. Eugen Beçi deklaroi se përveç apartamentit me sipërfaqe 82,3 m² të përfutur nga kontrata e shkëmbimit, z. A. R. do të përfitojë një vlerë monetare në shumën 7.200.000 lekë, nga të cilat 4.000.000 lekë i jepen z. A. R., sot, cash në dorë, me përpilimin e kësaj deklarate, ndërsa shuma tjetër prej 3.200.000 lekë do të shlyhen gradualisht për një periudhë 8-vjeçare, sipas kushteve të deklaruara e të përpiluara në një periudhë të mëvonshme përpara noterit.*

¹⁶ Përgjigje të protokolluara në Komision me nr. {***} prot., datë 26.12.2018.

86.2 Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2018, e z. G. e S. B., të cilët deklarojnë se: *Më datë 15.02.2014, me vullnetin tonë të lirë i kemi dhënë hua shtetasit Eugen Beçi, vëllait tonë, shumën prej 2.000.000 lekësh secili prej nesh, pra 4.000.000 lekë gjithsej për arsye personale, të cilat do të na i kthejë pa interesa në momentin më të parë të munshëm. Këto para ne i kemi kursyer nga puna jonë në emigracion në Greqi, dhe i kemi sjellë në Shqipëri për t'i mbajtur si depozita kesh, pranë shtëpisë së babait tonë V. B. në Librazhd. Këto para i kemi sjellë gjatë periudhave të ndryshme kohore, pjesë-pjesë, kur kemi ardhur vetë për të takuar prindërit në Shqipëri, dhe për këtë arsye nuk i kemi deklaruar në kufi transportimin e parave, pasi kanë qenë shuma që nuk deklaroheshin dhe me pëlqimin tonë këto para ia kishim dhënë hua vëllait tonë, të cilat ai i ka marrë në banesën e babait tonë në Librazhd. Deklaratën e huasë e kemi bërë në Greqi dhe ia kemi dërguar vëllait tonë me postë në linjat e transportit. Nuk e kemi parë të arsyeshme të përpilonim deklaratë para një noteri, pasi për vetë lidhjen e shumë të afërt familjare e kemi trajtuar këtë huadhënie në mirëbesim të plotë. Sot rikonfirmojmë para noterit publik vullnetin tonë të lirë për dhënien e kësaj sasive lekësh, si hua vëllait tonë. Huamarrësi, pra vëllai ynë, deklaroi se këtë shumë e ka marrë dhe do ta kthejë në momentin e parë që do të ketë mundësi objektive për ta bërë, por sigurisht pa kaluar afati prej 15 vitesh.*

87. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka përsëritur të njëjtat deklaratime të bëra në përgjigjet e pyetësorëve, të depozituara në Komision, por ka theksuar se: *[...] nuk ka asnjë mospërputhje mes deklaratës veting dhe deklaratimeve të mia gjatë hetimit administrativ. Në asnjë rast nuk kam deklaruar se huanë e kam marrë nga babai im, i ndjeri V. B.. Kam deklaruar se e kam marrë në shtëpinë e babait tim në Librazhd, ku paratë i kishin sjellë dy vëllezërit e mi. Pra, i referohem vendit dhe jo faktit që ato para i përkisnin babait tim. Pra, theksoj se shtëpia e babait tim në Librazhd është vendi ku kam marrë fizikisht paratë, por ato u përkisnin vëllezërve të mi. Prandaj dua të shpjegoj se nuk kam kryer asnjëherë deklaratim të pasaktë, pasi ato para i përkisnin vëllezërve të mi dhe jo babait tim. [...] Këto para ua mora borxh vëllezërve të mi me mirëkuptimin e tyre, të pasqyruar në deklaratat të cilat ata i përpiluan në Greqi dhe i dërguan tek unë me linjat e autobusëve. Pas kryerjes së këtyre deklaratave, unë kisha mundësi të merrja paratë të cilat fizikisht ishin në shtëpinë e babait tim.*

88. Nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, trupi gjykues konstaton se:

88.1 Në deklaratën e vitit 2014, subjekti ka deklaruar:

*Apartament banimi, sipërfaqe 169,65 m², me adresë: rruga {***}, {***}, ap. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***} përftuar nga shkëmbimi i pasurisë së paluajtshme me z. A. R.. Për shkëmbimin e kësaj prone, në pronësi të z. A. R. kaloi apartamenti im me sipërfaqe 82,3 m², rruga “{***}”, shkalla {***}, kati {***}, ap. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, si dhe shuma prej 7.200.000 lekësh (kontratë shkëmbimi pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.02.2014, deklarata datë 18.02.2014, deklaratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014). Nga kjo shumë dhënë 4.400.000 lekë në vitin 2014. Vlera: Shkëmbimi me një apartament me sipërfaqe 82,30 m², si dhe 7.200.000 lekë. Pjesa 100%.*

Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar:

Marrë hua vëllait tim G. B. 2.000.000 lekë pa interesa, me qëllim dhënien cash në dorë A. R. për shkëmbimin e apartamenteve. Deklaratë, datë 15.02.2014.

Marrë hua vëllait tim S. B. 2.000.000 lekë pa interesa, me qëllim dhënien cash në dorë A. R. për shkëmbimin e apartamentit. Deklaratë, datë 15.02.2014.

3.200.000 lekë detyrime shtetasit A. R. që rrjedh nga kontrata e shkëmbimit të apartamentit me të. Shumë e cila do të shlyhet për tetë vjet nga 400.000 lekë në vit. Shlyer deri tani 400.000 lekë,

*mbetur 2.800.000 lekë pa shlyer. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014.*

88.2 Në deklaratën e vitit 2015, ka deklaruar:

1.900.000 lekë mbetur pa shlyer nga huaja marrë vëllait tim G. B. pa interesa. Shlyer këtë vit atij 100.000 lekë nga kursimet e mia. Deklaratë, datë 15.02.2014 (dorëzuar në deklarinimin paraardhës).

1.900.000 lekë mbetur pa shlyer nga huaja marrë vëllait tim S. B. pa interesa. Shlyer këtë vit atij 100.000 lekë nga kursimet e mia. Deklaratë, datë 15.02.2014 (dorëzuar në deklarinimin paraardhës).

*2.400.000 lekë detyrime shtetasit A. R. që rrjedh nga kontrata e shkëmbimit të apartamentit me të. (Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014). Shumë e cila do të shlyhet për tetë vjet nga 400.000 lekë në vit. Shlyer dhe këtë vit 400.000 lekë, nga kursimet e mia. Gjithsej shlyer 800.000 lekë. Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.12.2015.*

88.3 Në deklaratën e vitit 2016, ka deklaruar:

1.800.000 lekë mbetur pa shlyer nga huaja marrë vëllait tim G. B. pa interesa. Shlyer këtë vit atij 100.000 lekë nga kursimet e mia. Gjithsej shlyer 200.000 lekë. Deklaratë, datë 15.02.2014 (dorëzuar në deklarinimin paraardhës).

1.800.000 lekë mbetur pa shlyer nga huaja marrë vëllait tim S. B. pa interesa. Shlyer këtë vit atij 100.000 lekë nga kursimet e mia. Gjithsej shlyer 200.000 lekë. Deklaratë, datë 15.02.2014 (dorëzuar në deklarinimin paraardhës).

*2.000.000 lekë mbetur pa shlyer detyrime shtetasit A. R. që rrjedh nga kontrata e shkëmbimit të apartamentit me të. (Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014). Shuma fillestare e detyrimit prej 3.200.000 lekë, e cila do të shlyhet për tetë vjet nga 400.000 lekë në vit. Gjithsej shlyer deri më tani 1.200.000 lekë. Shlyer dhe këtë vit 400.000 lekë, nga kursimet e mia. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014, deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.12.2015, deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.11.2016 (dorëzuar).*

- 89.** Në lidhje me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar disa shkaqe ankimi, të cilat lidhen me arsyetimin e Komisionit në vendim dhe konkluzionet e arritura bazuar në këtë arsyetim. Komisioni, në paragrafët 91 dhe 92 të vendimit ka arsyetuar se: *91. Palët i kanë pasur të gjitha mundësitë që të bënin të mundur parashikimin e pagesës 4.000.000 lekë z. A. R. nga huaja që subjekti i rivlerësimit u ka marrë vëllezërve të tij, në datën 27.8.2014, në kontratën e shkëmbimit, si dhe në deklaratën noteriale nr. {***}, në të cilën ata deklaruan vetëm se z. A. R. do të përfitojë vlerën 3.200.000 lekë.*
- 92. Deklarata noteriale nr. {***}, datë 24.12.2018, e z. R., e paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit ka vlerë të kufizuar provuese, pasi është bërë nga një mik i subjektit dhe gjatë hetimit administrativ.*
- 90.** Ky përfundim është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit është rrjedhojë e interpretimit jo të drejtë të provave të administruara pasi, duke iu referuar marrëdhënies së mirëbesimit dhe njohjeve të vjetra shoqërore familjare me z. A. R., ata menduan që marrëdhënien e detyrimit për shkak të shkëmbimit të pasurive mes tyre, ta konsideronin të dokumentuar në këtë formë. Pavarësisht faktit që e kanë konsideruar të mjaftueshme deklaratën e datës 18.02.2014, vendosën që këtë deklaratë ta formalizonin edhe para noterit, duke rikonfirmuar vullnetin e pavesuar të palëve me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.12.2018. Subjekti i kërkon Kolegjit që të marrë në konsideratë me vlerë të plotë provuese këtë deklaratë noteriale.

91. Në analizë të këtij shkaku ankimi, në mbështetje të situatës faktike të përshkruar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues arsyeton se: Në kontratën e shkëmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.2.2014, për shkëmbimin e apartamentit me sipërfaqe 82,3 m², pronë e subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi, me apartamentin me sipërfaqe 169,65 m², pronë e z. A. R., palët nuk kanë parashikuar asnjë pagesë monetare që do të kryhet mes palëve për këtë shkëmbim. Pagesa e vlerave monetare për shkëmbimin është parashikuar në deklaratat e mëvonshme të palëve, të nënshkruara për këtë qëllim. Në deklaratën e datës 18.02.2014, palët kanë deklaruar se në ekzekutimin e kontratës së shkëmbimit, përveç apartamentit me sipërfaqe 82,3 m², z. A. R. do të përfitojë edhe një vlerë monetare në shumën 7.200.000 lekë, nga të cilat 4.000.000 lekë i jepen *cash* në datën 18.02.2014, ndërsa pjesa tjetër prej 3.200.000 lekësh do të shlyhet gradualisht brenda një periudhe 8-vjeçare, sipas kushteve të deklaruara e të përpiluara në një periudhë të mëvonshme përpara noterit. Në deklaratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014, subjekti dhe z. A. R. deklarojnë se ky i fundit do të përfitojë për shkëmbimin e apartamentit edhe një vlerë monetare në shumën prej 3.200.000 lekësh, e cila do të shlyhet gradualisht brenda një periudhe 8-vjeçare në shumën 400.000 lekë çdo vit, duke filluar nga viti 2014. Shlyerja e kësaj shume me 400.000 lekë në vit është dokumentuar me deklarata noteriale edhe në vitet 2015 dhe 2016.
92. Marrëdhënia e detyrimit mes subjektit të rivlerësimit dhe z. A. R. ka qenë e deklaruar si e tillë që në deklaratën periodike të vitit 2014. Në këtë deklaratë subjekti e ka deklaruar këtë marrëdhënie si në rubrikën në të cilën përshkruhet pasuria dhe burimet e saj, ashtu edhe në rubrikën në të cilën deklarohen detyrimet financiare ndaj personave juridikë e fizikë. Në këtë të fundit, subjekti ka deklaruar jo vetëm ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, por edhe dokumentin shkresor provues të saj, i cili, sipas këtij deklarimi, është deklarata jonoteriale e datës 18.02.2014 dhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2014. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se nga vlera 7.200.000 lekë janë dhënë 4.400.000 lekë në vitin 2014. Në deklaratimet periodike të viteve të mëpasshme 2015 e 2016, subjekti ka deklaruar shlyerjen e shumave prej 400.000 lekësh në vit, sipas deklaratave noteriale përkatëse.
93. Në këtë këndvështrim, ekzistenca e kësaj marrëdhënieje detyrimi dhe pagimi i shumës 4.000.000 lekë, më datë 18.02.2014, z. A. R. nga subjekti i rivlerësimit bëhet e besueshme, duke konsideruar me vlerë provuese deklaratimet e subjektit të rivlerësimit të kryera në deklaratën periodike të vitit 2014, bazuar në parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.*
94. Në këtë kuptim, edhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.12.2018, e z. A. R. dhe z. Eugen Beçi, e paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ, në të cilën palët kanë materializuar me akt noterial deklaratën e datës 18.02.2014, vlerësohet si një konfirmim i deklaratimeve të subjektit në deklaratat periodike të interesave, të cilat kanë tashmë cilësinë e provës. Komisioni, pavarësisht arsyetimit dhe konkluzionit të arritur në paragrafët 91 dhe 92 të vendimit, si më sipërcituar, në analizën financiare të vitit 2014¹⁷, ka përllogaritur shkëmbimin e pasurive të paluajtshme në vlerën 7.200.000 lekë dhe ka konsideruar pagimin e shumës prej 4.400.000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit, përgjatë këtij viti.
95. Për këtë arsye, në analizën financiare të vitit 2014 në Kolegj, vlera prej 4.400.000 lekësh konsiderohet e paguar nga subjekti i rivlerësimit te z. A. R., pasi pagesa e kësaj shume ka rezultuar e provuar nga aktet e hetimit administrativ.

¹⁷Shihni paragrafin 100 të vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, të Komisionit.

96. Komisioni, në vendim, në paragrafët 93 - 99, ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë të ardhurat e ligjshme të vëllezërve të tij në shtetin grek, por ka mbetur e paprovuar nga subjekti i rivlerësimit mënyra se si janë marrë këto hua. Komisioni ka arritur gjithashtu në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument financiar provues për dhënien dhe për kthimin e shumave të huasë, duke vendosur të mos i marrë në konsideratë huatë prej vëllezërve të tij në vlerën 4.000.000 lekë, në analizën ekonomike për shkëmbimin e apartamenteve në vitin 2014.
97. Ky konkluzion i arritur nga Komisioni në vendim është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka pretenduar se shumën prej 4.000.000 lekësh ua ka marrë hua vëllezërve të tij dhe kjo shumë i ka shërbyer si burim krijimi për pagesën e vlerës 4.000.000 lekë kundrejt z. A. R., më datë 18.02.2014.
98. Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se marrëdhënia e huasë mes subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur, vëllezërve të tij G. dhe S. B., ka qenë e deklaruar si e tillë që në deklaratën periodike të vitit 2014. Në këtë deklaratë subjekti e ka deklaruar këtë marrëdhënie në rubrikën në të cilën deklarohen të dhënat konfidenciale. Në këtë të fundit, subjekti ka deklaruar jo vetëm ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, por edhe dokumentet shkresore provuese të saj, të cilat, sipas këtij deklarimi, janë deklaratat në formë shkresore, jonoteriale e subjektit dhe secilit prej vëllezërve të tij, për shumën 2.000.000 lekë dhënë hua, më datë 15.02.2014 nga secili prej vëllezërve kundrejt subjektit të rivlerësimit. Në deklaratimet periodike të viteve të mëpasshme, 2015 e 2016, subjekti ka deklaruar shlyerjen e këtyre huave në vlerën 100.000 lekë secila, për çdo vit.
99. Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se deklaratat e nënshkruara mes subjektit dhe secilit prej vëllezërve të tij më datë 15.02.2014, janë paraqitur nga subjekti bashkëlidhur edhe deklaratës së pasurisë për rivlerësimin.
100. Në analizë të rrethanave të mësipërme të faktit, në raport me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë situatë konkrete, trupi gjykues vëren se marrëdhënia e huasë e konkretizuar në formë shkresore të thjeshtë, është një formë e lejuar për të provuar ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, në kuptim të dispozitave të Kodit Civil, përkatësisht nenet 1050 - 1055. Këto dispozita nuk parashikojnë një formë të caktuar shkresore për efekt të vlefshmërisë së marrëdhënies së huasë, duke e përfshirë këtë veprim juridik te kontrata joformale.
101. Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënieje, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.* Kjo dispozitë kërkon konfirmimin e personit tjetër të lidhur për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së dhurimit apo huasë.
102. Në zbatimin e këtyre dispozitave në rastin konkret, rezulton se subjekti dhe vëllezërit e tij kanë zgjedhur si formë dokumentimi të marrëdhënies së huasë, formën shkresore të thjeshtë, të nënshkruar nga të dy palët, huamarrësi dhe huadhënësi, një marrëdhënie kjo e deklaruar nga subjekti në kohën e krijimit të saj, në deklaratën e pasurisë së vitit 2014. Në këtë kuptim, edhe deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2018, e z. G. e S. B., e paraqitur nga subjekti bashkëlidhur deklarimeve të bëra në përgjigje të pyetësorit¹⁸, lidhur me konstatimin e Komisionit se deklaratat e mëparshme të vëllezërve të subjektit nuk ishin bërë përpara noterit, duhet vlerësuar për qëllimin për të cilin është paraqitur nga subjekti, si një konfirmim i deklarimeve

¹⁸ Pyetësori i është drejtuar subjektit nga Komisioni me e-mail, datë 17.12.2018, ndërsa përgjigjet e subjektit janë protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 26.12.2018.

të tij të mëparshme në deklaratat periodike të interesave dhe si një konfirmim i një marrëdhënieje të formalizuar në formë shkresore në kohën e kryerjes së veprimit juridik, një formë kjo e lejuar nga ligji. Arsyetimi i Komisionit për të mos i dhënë vlerë kësaj deklarate noteriale, në drejtim të provimit të ekzistencës së marrëdhënies së huasë, do të gjendej i drejtë, nëse subjekti do të ndodhej përpara situatës së mosdeklarimit të marrëdhënies së huasë dhe aktit formalizues të saj në deklaratën periodike të vitit 2014, dhe deklarata noteriale do të përdorej prej tij si mjet për të vërtetuar këtë marrëdhënie me qëllim justifikimin e burimit të krijimit të pasurisë, vetëm për efekt të procesit të rivlerësimit.

103. Në vijim të këtij arsytimi, trupi gjykues vlerëson se ekzistenca e marrëdhënies së huasë e dokumentuar dhe e deklaruar në kohën e kryerjes së veprimit, është bindëse, pasi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit të kryera në deklaratën periodike të vitit 2014, kanë vlerë provuese, bazuar në parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.*
104. Në rastin konkret, trupi gjykues çmoi se duhen konsideruar edhe marrëdhëniet e posaçme mes subjektit të rivlerësimit dhe z. S. B. e z. G. B., të cilët janë në lidhje gjinore të ngushtë, janë vëllezërit e tij. Po ashtu, tepër i vlefshëm për çështjen është dhe përfundimi i arritur nga Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit provues të paraqitur nga vëllezërit B., se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë të ardhurat e ligjshme të vëllezërve të tij në shtetin grek, duke u provuar kështu edhe mundësia e tyre për të dhënë hua shumat e pretenduara nga subjekti. Në këto kushte, konkluzioni i arritur nga Komisioni për të mos marrë në konsideratë huanë e marrë nga subjekti në vlerën 4.000.000 lekë, në analizën financiare për shkëmbimin e apartamenteve në vitin 2014, trupi gjykues e gjen të pabazuar në aktet e hetimit administrativ, pasi ky fakt provohet me deklaratën e interesave privatë të vitit 2014.
105. Përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka paraqitur si burim për krijimin e kësaj pasurie huanë e marrë nga babai i tij, Komisioni, në vendim, e ka mbështetur në arsyetimin se subjekti i rivlerësimit ndryshoi deklaram gjatë hetimit administrativ, duke deklaruar se huanë nuk e kishte marrë nga vëllezërit e tij, por nga babai i tij. Gjithashtu, Komisioni ka arsyetuar lidhur me të njëjtin përfundim se *subjekti i rivlerësimit i ka pasur të gjitha mundësitë që në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, të shpjegonte sa parashikohej në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2018, sipas së cilës z. G. dhe S. B., ndër të tjera deklarojnë: “Huatë i kemi bërë në Greqi dhe ia kemi dërguar vëllait përmes linjave të transportit”, duke deklaruar se këto hua i ka marrë nga të ardhurat e vëllezërve nëpërmjet babait të tij¹⁹.*
106. Ky konkluzion është kundërshtuar në ankim nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka pretenduar se nuk ka asnjë mospërputhje mes deklaratës së pasurisë për rivlerësimin dhe deklaratimeve të tij gjatë hetimit administrativ, duke mos qenë në kushtet e deklaramit të rremë, pasi në asnjë rast nuk ka deklaruar se huanë e ka marrë nga babai i tij i ndjerë, por që e ka marrë në shtëpinë e tij në Librazhd, ku paratë i kishin sjellë vëllezërit e tij. Subjekti ka vazhduar më tej me pretendimin e tij, duke sqaruar se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie huaje me babanë e tij, por ai në deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ i është referuar vendit, jo faktit që ato para i përkisnin babait të tij.

¹⁹Shihni paragrafët 97 dhe 99 të vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, të Komisionit.

107. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, në raport me situatën faktike të përshkruar më sipër, trupi gjykues konstaton se gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti, kërkesës së Komisionit për të specifikuar vendin, datën dhe mënyrën e marrjes së secilës hua në vlerën 2.000.000 lekë nga z. G. B. dhe z. S. B., i është përgjigjur se: *Këtë hua unë e kam marrë në shtëpinë e babait tim V. Th. B., në qytetin e Librazhdit, më datë 15.02.2014, me pëlqimin e vëllezërve të mi, G. e S. B., të cilët këto para i kishin sjellë cash në periudha të ndryshme kohore të shtëpia e prindërve, pasi kishin vite që punonin në emigracion në Greqi. Këtë hua e kam marrë cash. Këto para vëllezërit e mi i kanë sjellë në Shqipëri në sasi të ndryshme në gjendje cash, kur kanë udhëtuar për pushime apo për të takuar prindërit dhe meqë kanë qenë shuma që nuk kalonin kufirin e shumës që duhej deklaruar, nuk e kanë deklaruar në kufi kalimin e parave.*
108. Vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2018, konfirmojnë deklaratimet e tyre në deklaratat e mëparshme të datës 15.02.2014, si dhe deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, se paratë e kursyera nga puna në emigracion në Greqi, i kanë sjellë në Shqipëri për t'i mbajtur si depozita *cash*, pranë shtëpisë së babait të tyre V. B. në Librazhd. Ata kanë deklaruar gjithashtu se deklaratat e huasë i kanë bërë në Greqi dhe ia kanë dërguar vëllait të tyre me linjat e transportit, duke argumentuar se për shkak të marrëdhënies së mirëbesimit të tyre si vëllezër, nuk vlerësuan që deklaratat e vitit 2014 t'i bënin përpara një noteri publik.
109. Subjekti, të njëjtin qëndrim në lidhje me marrjen e shumave të parave *cash* të shtëpia e babait të tij në Librazhd, me pëlqimin e vëllezërve të tij, G. e S. Beçi, të cilët këto para i kishin sjellë *cash* në periudha të ndryshme kohore të shtëpia e prindërve, e ka përsëritur edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ.
110. Në analizë të kësaj situatë faktike, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konstatimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ndryshoi deklaratim gjatë hetimit administrativ duke deklaruar se huatë nuk ishin marrë nga vëllezërit e tij, por nga babai i tij, nuk është i saktë. Subjekti ka deklaruar se vendi ku është marrë shuma totale e huasë ka qenë shtëpia e babait të tij, por paratë kanë qenë të vëllezërve të tij emigrantë në Greqi.
111. Subjekti ka qenë konsekuent në gjithë deklaratimet e tij, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në deklaratat periodike të interesave, si dhe në deklaratimet gjatë hetimit administrativ, duke mos e mohuar asnjëherë faktin e marrjes së huasë nga vëllezërit e tij. Babai i tij është bërë pjesë e deklarimeve të subjektit, pasi sipas deklarimeve të tij, paratë e vëllezërve fizikisht kanë qenë të depozituara në shtëpinë e babait të tij të ndjerë. Deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ kanë saktësuar mekanizmin e marrjes së huasë, në kuptim të vendit dhe mënyrës së marrjes së saj, por subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë se këto para kanë qenë të babait të tij.
112. Trupi gjykues vlerëson se argumenti i Komisionit se subjekti, duke mos paraqitur si burim për krijimin e pasurisë apartament 169,65 m² huanë e marrë nga babai i tij, ka kryer deklaratim të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, nuk qëndron, pasi burimi i deklaruar prej subjektit në thelb mbetet një hua, e cila edhe nëse do të ishte marrë nga babai i tij, përsëri rridhte nga paratë e dërguara në Shqipëri nga vëllezërit emigrantë të subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë në këtë arsyetim se kjo formë e transferimit dhe ruajtjes së parave pranë familjeve në Shqipëri është një mënyrë e përdorur zakonisht nga emigrantët shqiptarë. Konstatimi i Komisionit se subjekti kishte mundësi të përshkruante më qartësisht në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin rrethanën e marrjes së huasë fizikisht në shtëpinë e babait të tij, mund të qëndrojë në kuptimin e një deklarimi sa më të plotë, pavarësisht se nuk ishte e detyrueshme referuar përmbajtjes së deklaratës së rivlerësimit për kriterin e pasurisë. Për rrjedhojë, kjo rrethanë nuk mund të vendosë

subjektin në kushtet e deklaramit të rremë në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin. Në këto kushte, pretendimin e subjektit se ai nuk ka kryer deklaramit të rremë në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar në deklaramit e tij gjatë hetimit administrativ.

113. Konstatimi i Komisionit, siç edhe është përshkruar më sipër në këtë vendim, se vëllëzërit e subjektit kanë deklaramit në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2018, se: *Huatë i kemi bërë në Greqi dhe ia kemi dërguar vëllait përmes linjave të transportit, i kundërshtuar nga subjekti në ankim, si i pasaktë, është një lapsus i Komisionit, i cili, nga leximi në tërësi i arsyetimit lidhur me huanë në vlerën 4.000.000 lekë, nuk ka ndikuar në konkluzionin e arritur prej tij.*
114. Bazuar në rezultatin e prodhuar nga analiza financiare e vitit 2014, *Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka mungesë të të ardhurave në vlerën 4.027.816 lekë, për të justifikuar shkëmbimin e apartamenteve në vitin 2014. Ky konkluzion është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, duke kontestuar këtë analizë në dy elemente të saj.*
Së pari, subjekti ka pretenduar se në këtë analizë duhej të merrej në konsideratë huaja e marrë prej tij në vlerën 4.000.000 lekë nga vëllëzërit emigrantë në Greqi. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, bazuar në arsyetimin e bërë më sipër në këtë vendim, rezultoi e provuar ekzistenca e marrëdhënies së huasë mes subjektit dhe vëllëzërve të tij. Për këtë arsye, vlera prej 4.000.000 lekësh e huasë, është përlogaritur në analizën financiare të kryer në Kolegj për të verifikuar nëse qëndrojnë pretendimet e subjektit se ai ka pasur mundësi për të justifikuar pagimin e vlerës 4.400.000 lekë në vitin 2014, si pasojë e shkëmbimit të pasurisë së tij apartament me sipërfaqe 82,3 m² me një apartament me sipërfaqe 169,65 m² në pronësi të z. A. R..
Së dyti, subjekti ka pretenduar se në analizën financiare të këtij viti, Komisioni nuk duhej të kishte konsideruar shpenzimet për shkollimin e fëmijëve të tij, pasi ato janë kryer nga prindërit e bashkëshortes së tij. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, nga verifikimi i analizës së kryer nga Komisioni, rezultoi se Komisioni i ka marrë në konsideratë deklaramit e subjektit gjatë hetimit administrativ, se shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij janë financuar nga prindërit e bashkëshortes së tij, në vlerën 120.000 lekë për vitin 2014, duke e përfshirë këtë vlerë në zërin e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit.
115. Në mbështetje të arsyetimit ligjor të bërë në këtë vendim, u krye analiza financiare në Kolegj, në të cilën u reflektuan disa prej pretendimeve të subjektit të rivlerësimit që u gjenden të drejta, nga ku rezultoi mungesë e burimeve financiare të ligjshme në shumën prej 47.710 lekësh për të justifikuar krijimin e pasurive në vitin 2014. Kjo shumë u konsiderua e pamjaftueshme nga trupi gjykues i Kolegjit për të konkluduar për mungesë burimesh për krijimin e pasurive në vitin 2014.
116. Bazuar në arsyetimin e bërë në këtë vendim, sipas të cilit deklaramit e subjektit gjatë hetimit administrativ se shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij janë financuar nga prindërit e bashkëshortes, nuk përputhen me deklaramit e tij në deklaratat periodike të pasurisë, arrijmë në konkluzionin se Komisioni duhet të kishte vazhduar të mbante të njëjtin qëndrim, duke i konsideruar këto shpenzime si të kryera nga subjekti i rivlerësimit edhe për vitin 2014. Nëse në analizën financiare të vitit 2014, shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij do të konsideroheshin si të kryera nga subjekti i rivlerësimit, atëherë mungesa e burimeve të ligjshme të subjektit për këtë vit, do të ishte 167.710 lekë.
117. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në analizën financiare të vitit 2009, Komisioni nuk duhet të konsideronte shpenzimet për shkollimin e fëmijëve të tij, pasi ato nuk janë kryer prej tij. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, subjekti nuk kishte si të deklaronte një shpenzim që nuk*

e kërkonte formulari dhe ligji, pasi shpenzimi për shkollimin e fëmijëve atë vit, është dukshëm më i ulët se 300.000 lekë që është vlera e kërkuar për deklaram të shpenzimeve.

118. Komisioni, në paragrafët 103-109 të vendimit, ka trajtuar likuiditetet e krijuara nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2009 dhe, pas kryerjes së analizës financiare mbi të ardhurat e shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në këtë vit, ka arritur në konkluzionin se ai nuk ka pasur mundësi financiare për të krijuar likuiditetet për vitin 2009, duke rezultuar me bilanc negativ për këtë vit në vlerën prej 286.251 lekësh.
- Subjekti, në ankim, ka kundërshtuar vetëm një zë të kësaj analize, atë që lidhet me shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij, duke pretenduar se ashtu si në vitin 2007, këto shpenzime janë financuar nga prindërit e bashkëshortes së tij. Të njëjtin pretendim, subjekti e ka parashtruar edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, me të njëjtin argument, si ai i përdorur për analizën financiare të vitit 2007.
119. Nga verifikimi i deklaratës periodike të vitit 2009, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka deklaruar se prindërit e bashkëshortes kanë financuar shkollimin e fëmijëve të tij në kolegjin “{***}”, prandaj çmon se subjekti ndodhet në të njëjtat rrethana me ato të vitit 2007. Në këto kushte, edhe për analizën financiare të vitit 2009, trupi gjykues, bazuar në arsyetimin e bërë në paragrafët 70 dhe 71 të këtij vendimi, arrin në përfundimin se është i drejtë konkluzioni i Komisionit për të përlloritur shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të subjektit, si shpenzime të kryera nga vetë subjekti i rivlerësimit në vitin 2009.
120. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në lidhje me pasurinë e personave të tjerë të lidhur, pavarësisht prapësimeve të tij pas barrës së provës, bindja e brendshme e Komisionit pa u bazuar në asnjë provë, rrethanë apo fakt të administruar gjatë hetimit, ka sjellë një konkluzion të pasaktë mbi burimin e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur. Komisioni nuk ka arsyetuar se cilën pasuri të personave të tjerë të lidhur, subjekti nuk ka deklaruar saktësisht apo plotësisht.*
121. Në lidhje me pasuritë e personave të tjerë të lidhur, Komisioni, në vendim²⁰, ka arritur në përfundimin se:
- i. *subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e personit tjetër të lidhur, sipas paragrafit 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës;*
 - ii. *subjekti i rivlerësimit, bazuar në provat që disponon Komisioni dhe në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, bazuar në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas parashikimeve të paragrafit 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës;*
 - iii. *shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
- Komisioni ka arritur në këto përfundime pas kryerjes së analizës financiare, duke konsideruar se prindërit e bashkëshortes së subjektit janë persona të tjerë të lidhur, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti, gjatë hetimit administrativ, deklaroi se ka jetuar qysh prej shtatorit 2004 deri në qershor 2006 pa qira, në apartamentin në pronësi të tyre, me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë.
122. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, konstatohet situata faktike si më poshtë.

²⁰ *Shih paragrafin 124 të vendimit nr. 117, datë 26.06.2019, të Komisionit.*

Në deklaratimet periodike të interesave në vitet 2004 dhe 2005, subjekti ka deklaruar si adresë banimi: rruga “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, apartamenti {***}, Njësia Administrative nr. {***}, Tiranë.

123. Gjatë hetimit në Komision, deklaratimet e subjektit në lidhje me përdorimin e kësaj pasurie, fillojnë pasi nga Komisioni është konstatuar situata faktike si më sipër dhe në pyetësorin dërguar subjektit më datë 17.12.2018, i ka drejtuar pyetjen: *Bazuar në shkresën e UKT-së rezulton se nëna e bashkëshortes suaj ka kontratë me UKT-në për një apartament në rr. “{***}”²¹. Kjo adresë korrespondon me adresën e deklaruar nga ana juaj në deklaratat e interesave privatë. Kur është blerë ky apartament, shoqëruar me dokumentacionin provues? Cili ka qenë burimi i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti, shoqëruar me dokumentacion? A keni jetuar ju në këtë apartament? Nëse po, specifikoni periudhat.*
124. Në përgjigjet e këtij pyetësori, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 26.12.2018, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Ky apartament është blerë nga nëna e bashkëshortes sime, Sh. L., më datë 09.09.2004, në vlerën 1.900.000 lekë, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2004, dhe është shitur më datë 13.06.2006, në vlerën 2.000.000 lekë, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.06.2006. Burimi i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti kanë qenë kursimet e Sh. L. dhe bashkëshortit të saj, nga puna që kanë bërë prej 34 vjetësh Sh. L. dhe 39 vjet L. L., si dhe të ardhurat që kanë fituar prej kreditimit që kanë bërë prej shoqërive huamarrëse “{***}” dhe “{***}” (vërtetimet nr. {***} prot., datë 19.12.2018 dhe nr. {***} prot., datë 07.05.2018, lëshuar nga Shoqëritë Huamarrëse në Administrim). Unë kam jetuar në këtë apartament qysh prej shtatorit 2004 deri në qershor 2006.*
125. Në pyetësorin drejtuar subjektit, nëpërmjet e-mail-it të datës 05.04.2019, ndër të tjera, Komisioni i ka drejtuar kërkesën për të paraqitur kopje të kontratave noteriale të blerjes dhe shitjes së apartamentit në rr. “{***}”, Tiranë, nga prindërit e bashkëshortes, si dhe emrin e noterit publik ku janë kryer këto kontrata. Komisioni i ka kërkuar, gjithashtu, subjektit të depozitojë burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.
126. Në përgjigjet e këtij pyetësori, të protokolluara në Komision me nr. {***} prot., datë 10.04.2019, subjekti ka deklaruar: *Ky apartament është blerë nga nëna e bashkëshortes sime Sh. L., më datë 09.09.2004, me vlerën 1.900.000 lekë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2004, para noterës Q. Sh. dhe është shitur më datë 13.06.2006, me vlerën 2.000.000 lekë, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.06.2006, para noterës D. K..*
127. Gjatë hetimit administrativ, subjekti, për të provuar deklaratimet e tij, ka paraqitur dokumentacionin si vijon.
- Kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2004, e lidhur mes G. e B. M. në cilësinë e shitësit dhe Sh. L. në cilësinë e blerësit. Objekti i kontratës është shitblerja e një apartamenti me sipërfaqe 53,6 m², i ndodhur në Tiranë, në rrugën “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, kati i {***}, apartamenti {***}, Zona Kadastrale nr. {***}, me nr. pasurie {***}. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes së apartamentit është 1.900.000 lekë dhe është likuiduar i gjithi në dorë, jashtë zyrës noteriale.
 - Kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.06.2006, e lidhur mes znj. Sh. L. në cilësinë e shitëses dhe znj. V. R. në cilësinë e blerëses. Objekti i kontratës është shitblerja e një apartamenti me sipërfaqe 53,6 m², i ndodhur në Tiranë, në rrugën “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, kati i

²¹ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga UKT-ja, me shkresë nr. K-3800/1 prot., datë 10.10.2018.

{***}, apartamenti {***}, Zona Kadastrale nr. {***}, me nr. pasurie {***}. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes së apartamentit është 2.000.000 lekë.

Ky dokumentacion është konfirmuar edhe nga informacioni i dërguar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 06.05.2019, nga ZVRPP Tiranë.

128. Në pyetësin drejtuar subjektit me *e-mail*, datë 13.03.2019, Komisioni i ka drejtuar kërkesën për të paraqitur dokumentacionin vërtetues për paratë e dërguara nga vajzat e tyre kundrejt prindërve të bashkëshortes së tij, duke qenë se subjekti ka deklaruar se këta të fundit kanë mbuluar shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të tij nga viti 2011-2014 e si burim të ardhurash kanë shërbyer dhe paratë e dërguara nga dy vajzat e tyre, I. L. e E. L..

Në përgjigjet e këtij pyetësi, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 19.03.2019, subjekti ka deklaruar: *[...] ndër vite, I. L. ka sjellë ndihmë financiare për prindërit e saj shumë prej rreth 20.000 dollarësh kanadezë, ndërsa vajza tjetër E. L. ndihmën prej 10.000 dollarësh amerikanë. Bashkëlidhur po ju dërgoj deklaratat e dy vajzave, që vërtetojnë se kanë dërguar cash në Shqipëri sasi të hollash si ndihmë për prindërit e tyre ndër vite, si dhe dokumentacionet përkatëse të autoriteteve kanadeze e amerikane që vërtetojnë mundësinë financiare të tyre për të dërguar këto para. Këto para janë sjellë dorazi sa herë kanë ardhur në Shqipëri vajzat apo të afërm të tjerë, konform sasive nga ligjet përkatëse.*

Subjekti ka paraqitur bashkëlidhur këtyre përgjigjeve, dokumentacion:

- në lidhje me të ardhurat e prindërve të bashkëshortes së tij nga puna e tyre, si dhe të ardhurat nga kreditimi prej shoqërive huamarrëse “{***}” dhe “{***}”;
- në lidhje me të ardhurat e motrave të bashkëshortes së tij, të cilat jetojnë e punojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanada.

129. Dokumentacioni i mësipërm përbëhet nga:

a) Një letër, datë 20.12.2018, e z. R. L. dhe znj. I. L., në gjuhën shqipe, në të cilën ata shprehen se: *[...] Ndonëse kemi qenë rreth 21 vjet larg Shqipërisë [...], ne jemi kujdesur për prindërit tanë nga të dyja palët, kujdes që është shprehur edhe në ndihmë financiare për të gjitha nevojat që ata kanë pasur, shpenzime jetese, mjekësore, udhëtimi etj. Mënyra se si është realizuar kalimi i mjeteve monetare të referuara më sipër, është bërë dorazi gjatë vizitave tona në Shqipëri, si dhe nëpërmjet të afërmeve tanë që na kanë vizituar në ShBA dhe Kanada, gjithmonë konform cagueve të lejuara nga ligjet përkatëse. Po bashkëngjisim me këtë letër, dokumente të CRA (Canada Revenue Agency – Agjencia Kanadeze e të Ardhurave).*

Dokumentacioni i paraqitur bashkëlidhur kësaj letre, përbëhet nga formularë të Agjencisë Kanadeze të të Ardhurave, në emër të z. R. L. dhe znj. I. L., për vitet 2007-2017. Dokumentacioni është në gjuhën angleze dhe franceze, i papërkthyer dhe i panoterizuar e i palegalizuar.

b) Një letër e znj. E. L., datë 10.12.2018, në të cilën ajo shprehet: *Unë jam profesore në departamentin e anglishtes në Universitetin Stephen F. Austin në Texas, ShBA dhe taksapague po në ShBA. Kam qenë e punësuar në këtë pozicion duke filluar nga vjeshta 2015. Para këtij pozicioni kam qenë punonjëse në Universitetin Texas A&M, filluar në vjeshtë 2011. Gjatë gjithë këtyre viteve punësimi, tetë vjet total, unë kam ndihmuar vazhdimisht monetarisht, prindërit e mi. Letra e znj. E. L. është paraqitur në gjuhën angleze, e noterizuar nga noteri publik i shtetit të Teksasit A. S. H., më datë 19.12.2018. Letra, në versionin në gjuhën shqipe nuk është e noterizuar. Letra nuk është e legalizuar.*

Dokumentacioni i paraqitur bashkëlidhur kësaj letre përbëhet nga formularë të Shërbimit të të Ardhurave të Brendshme të Departamentit Amerikan të Thesarit, për vitet 2013-2018, në emër të znj. E. L.. Dokumentacioni është në gjuhën angleze, i papërkthyer, i panoterizuar dhe i palegalizuar.

130. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës për të provuar të kundërtën e gjetjes se: *Z. L. dhe znj. Sh. L., persona të tjerë të lidhur me ju, nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, duket se nuk kanë pasur aftësi paguese për blerjen e apartamentit në rr. “{***}”, me vlerën 1.900.000 lekë, duke rezultuar me bilanc negativ në vlerën prej 1.926.156 lekësh.*
131. Në shpjegimet mbi këto rezultate, subjekti ka deklaruar se: *Në analizën tuaj financiare nuk keni përfshirë të ardhurat e fituara nga prindërit e bashkëshortes, si rrjedhojë e punës së tyre prej 34 vjetësh e 10 muaj punë të Sh. L., si arsimtare në Poliçan e Vlorë. Ky fakt provohet nga dokumentacioni i administruar te ju [...]. Nuk keni marrë në konsideratë të ardhurat e punës para daljes në pension të dy bashkëshortëve L. e Sh. L., jo vetëm për vitin 2003, por edhe të gjitha kursimet e jetës së tyre. [...] Në analizën tuaj financiare kërkoj të përfshini të ardhurat e znj. Sh. L. për vitin 2003 dhe për z. L. L. për vitin 2003 dhe 2004, sipas dokumentacionit vërtetues [...]. Bashkëshortët L., për shkak të privatizimit kanë fituar një banesë në qytetin e Poliçanit, Skrapar, në vitin 1994, me vlerë 900 lekë. Këtë banesë e kanë shitur në vlerën 500.000 lekë me transaksionin e datës 20.12.1999. [...] Bashkëshortja dhe djali im i madh, kanë jetuar në Vlorë tek prindërit e bashkëshortes qysh prej vitit 1998 deri në 15.09.2004. Me transferimin tim në qytetin e Vlorës si prokuror më datë 01.02.2002 deri më 06.01.2004, unë së bashku me familjen time kam jetuar së bashku me prindërit e bashkëshortes. Ekonomia e të dyja familjeve ka qenë e përbashkët. Pavarësisht se kam qenë me punë në qytetin e Shkodrës, [...] kam kontribuar për familjen time me të ardhura financiare 20.000 lekë në muaj, gjatë viteve 2000-2001, që në total kapin vlerën 480.000 lekë. Bashkëshortja ka qenë e punësuar si arsimtare në qytetin e Vlorës, duke siguruar të ardhura në vlerën 677.175 lekë. Nga ekonomia e përbashkët e dy familjeve tona, z. L. L. ka mundur të kursejë një sasi prej 1.4 milionë lekësh. Theksoj se këto kursime kanë mbetur si të ardhura tek L. e Sh. L. [...] në analizën e të ardhurave të L. e Sh. L., kërkoj të llogariten jo vetëm të ardhurat nga pensionet, por edhe të ardhurat nga punësimi i znj. Sh. L. pranë shkollës jopublike “{***}” Vlorë, si dhe ndihmën e vajzave të tyre I. L. dhe E. L. [...]. Në total, ndihma e vajzave të tyre kap vlerën rreth 20.000 dollarë kanadezë dhe 10.000 dollarë amerikanë.*

Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin vërtetues për të ardhurat nga puna të prindërve të bashkëshortes së tij, për vitet e pretenduara.

132. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se ndryshe nga sa konkludon Komisioni, ai nuk është përpjekur asnjëherë të fshehtë apo paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, përdorim apo posedim të tij dhe Komisioni nuk ka arsytuar se cilën pasuri të personave të tjerë të lidhur nuk ka deklaruar saktësisht apo plotësisht.
133. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të Komisionit, në lidhje me pasqyrimin e konkluzioneve të arritura për vlerësimin e secilës pasuri, konkluzioneve për kriterin e pasurisë në tërësi, si dhe konkluzioneve përfundimtare, trupi gjykues vëren se:
- Në konkluzionet në lidhje me pasurinë e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit²², Komisioni ka arritur në përfundimin se:
- i. subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e personit tjetër të lidhur, sipas paragrafit 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës;
 - ii. subjekti i rivlerësimit, bazuar në provat që disponon Komisioni dhe në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të

²² Shihni paragrafin 124 të vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

krijimit të pasurive dhe të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, bazuar në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas parashikimeve të paragrafit 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; iii. shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e barrës së provës për këtë pikë të rezultateve të hetimit sipas paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Në konkluzionin për vlerësimin e pasurisë²³, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *Subjekti nuk ka pasur mjete monetare të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera në vitet 2007, 2009 dhe 2014; subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tij dhe është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim të tij; subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e personit tjetër të lidhur, sipas paragrafit 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin subjekti i rivlerësimit, z. Eugen Beçi, nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.*

Në konkluzionin përfundimtar, Komisioni arrin në përfundimin se:

(i) Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e shkronjës “g” të kreut V, “Të dhëna për sigurinë”, si dhe ka fshehur fakte të ndodhura sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

(ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

(iii) Subjekti i rivlerësimit ka ndër marrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe deklaram të rremë në deklaramtën e rivlerësimit, për burimin e krijimit të këtyre pasurive.

(iv) Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe të pasurisë.

Nga pasqyrimi si më sipër i konkluzioneve të Komisionit në vendim, vërehet se qëndrimi i Komisionit ka ndryshuar nga *deklaram i pasaktë dhe mungesë e burimeve të krijimit të pasurive të personit tjetër të lidhur*, në *deklaram të pasaktë* e më pas në asnjë konkluzion në lidhje me këto pasuri.

134. Në këto kushte, vërehet se deklarami i pasaktë apo mungesa e burimeve të krijimit të pasurive të personave të tjerë të lidhur, nuk është vlerësuar nga Komisioni si rrethanë që ka ndikuar në shkakun që i atribuohet subjektit të rivlerësimit në kuadër të legjislacionit të zbatueshëm për rivlerësimin kalimtar – deklarami i pamjaftueshëm – për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Megjithatë, në vijim, trupi gjykues analizon konkluzionet e Komisionit lidhur me pasuritë e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në kuadër të analizimit të pretendimeve të subjektit.

135. Në mbështetje të situatës faktike të cituar më sipër, sipas së cilës subjekti ka deklaruar në deklaramat periodike të interesave e në deklaramet gjatë hetimit administrativ se ka jetuar në vitet 2004-2006 në apartamentin e prindërve të bashkëshortes së tij pa qira, si dhe në analizë të konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e personit tjetër të lidhur, sipas paragrafit 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në raport dhe me legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton se mungesa e deklaramit të kësaj

²³ Po aty, paragrafi 125.

marrëdhënieje në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk konsiderohet si shkelje e ndonjë detyrimi ligjor në kuptim të plotësisht të kësaj deklaratë. Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

136. Sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, “pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Formulari i deklarimit të pasurisë për rivlerësimin – shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016, në faqen 5, vendos detyrimin e subjekteve për deklarimin e: *Të gjitha pasurive të akumuluarra ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11, të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.*
137. Në zbatim të legjisllacionit të sipërcituar, subjekti kishte detyrimin që në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin të deklaronte pasuritë që ndodheshin në përdorim nga ai, në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë banuar në shtëpinë e prindërve të bashkëshortes së tij në periudhën 2004-2006, për pasojë marrëdhënia e përdorimit të banesës i ka përfunduar efektet e saj dhe nuk prodhon më asnjë pasojë ligjore që të mund të deklarohet si e tillë në vitin 2017, në kohën e plotësisht të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit.
138. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me pasuritë në përdorim të tij.
139. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e personit tjetër të lidhur, sipas pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke e analizuar atë në raport me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se ky konkluzion është i paarsyetuar, pasi Komisioni nuk ka qartësuar rrethanat konkrete në të cilat ndodhet subjekti, që e vendosin atë në kushtet e deklarimit të pasaktë e të paplotë të pasurive të personit tjetër të lidhur.
140. Ky konkluzion është edhe i pabazuar në ligj. Pika 1 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, e referuar nga Komisioni në konkluzion, përcakton qëllimin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive të subjekteve të rivlerësimit, për të identifikuar ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Nenet 30-32 të ligjit nr. 84/2016, në detajim të përcaktimit kushtetues, vendosin detyrimin që subjekti i rivlerësimit të deklarojë në mënyrë të plotë e të saktë pasuritë e tij dhe të personave të lidhur. Në lidhje me personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, ligji nr. 84/2016 vendos detyrimin që këta persona dhe subjekti i rivlerësimit, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në këtë kuptim, konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar saktësisht e plotësisht pasuritë e personave të tjerë të lidhur, është në tejkalim të parashikimeve ligjore për procesin e rivlerësimit.

141. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk është përpjekur asnjëherë të fshehtë apo paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, përdorim apo posedim të tij dhe Komisioni nuk ka arsyetuar se cilën pasuri të personave të tjerë të lidhur nuk ka deklaruar saktësisht apo plotësisht, është një pretendim i bazuar.
142. Në lidhje me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson të analizojë marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me pasurinë apartament me sipërfaqe 53,6 m², në pronësi të prindërve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe nëse për shkak të kësaj marrëdhënieje, prindërit e bashkëshortes së subjektit mund të konsiderohen persona të tjerë të lidhur me të.
143. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratimet periodike të interesave në vitet 2004 dhe 2005, ka deklaruar si adresë banimi, adresën e apartamentit me sipërfaqe 53,6 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, apartament në pronësi të prindërve të bashkëshortes së tij, që nga data 09.09.2004. Kjo banesë është shitur nga prindërit e bashkëshortes më datë 13.06.2006²⁴, shkak ky që, sipas pretendimeve të tij, e detyroi subjektin e rivlerësimit të fillonte të banonte në apartamentin me sipërfaqe 82,3 m² në rrugën “{***}”, Tiranë. Subjekti ka pretenduar se, në kushtet kur nuk kishte ku të banonte pas transferimit me punë në Tiranë, ka përdorur banesën e prindërve të bashkëshortes së tij, pa qira, deri në momentin që ata e kanë shitur atë.
144. Komisioni, nisur nga këto deklaratime të subjektit, i ka kualifikuar prindërit e bashkëshortes së tij si persona të tjerë të lidhur me të në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe i ka vendosur subjektit të rivlerësimit detyrimin për të shpjeguar burimin e ligjshëm të pasurisë. Në vlerësim të Kolegjit, kualifikimi i sipërcituar nuk është i drejtë në raport me natyrën dhe objektin e marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri. Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 ngarkon subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të provuar burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë së personave të tjerë të lidhur, kur ata vetë deklarojnë se si burim i krijimit të pasurive të tyre kanë shërbyer shumat e dhëna hua apo dhuruar prej personave të tretë të lidhur sipas kësaj dispozite.
145. Nga analiza e situatës faktike që është e provuar nga hetimi administrativ, nuk rezulton se midis subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të bashkëshortes së tij të ketë një marrëdhënie biznesi në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 dhe as një marrëdhënie huamarrjeje apo dhurimi në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në vijim edhe të jurisprudencës së Kolegjit në këtë drejtim, subjekti i rivlerësimit do të ketë detyrimin të provojë, për llogari të këtij procesi, burimet e ligjshme të pasurisë së personit tjetër të lidhur, në rastin kur ajo pasuri përfaqëson një marrëdhënie për shkak të së cilës personi tjetër konsiderohet si person tjetër i lidhur i subjektit dhe kur ekzistojnë rrethanat e parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në rastin konkret, nuk rezulton, siç u përmend më lart, që subjekti i rivlerësimit të ketë me prindërit e bashkëshortes së tij ndonjë marrëdhënie huaje apo dhurimi në raport me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 53,6 m².
146. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka bërë një vlerësim të gabuar të situatës faktike, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, pasi nuk duhet të kishte arritur në përfundimin se prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit plotësojnë kushtet për t’u kualifikuar si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit.
Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive prej prindërve të bashkëshortes së tij.

²⁴ Kjo pasuri, më datë 20.06.2006, është regjistruar në emër të blerëses, znj. V. R.

147. Në verifikim të akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, rezulton se pasurinë e prindërve të bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit e ka përdorur për një periudhë kohe më pak se dyvjeçare, nga shtatori 2004 deri në qershor 2006, në kushtet kur sapo ishte transferuar nga Vlora në Tiranë, me detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, dhe në kushtet kur nuk kishte banesë të vetën për të jetuar me familjen e tij, ka përdorur pasurinë apartament me sipërfaqe 52,3 m² të prindërve të bashkëshortes. Për më tepër, rrethanë që mund të renditet si favorizuese është edhe shitja e kësaj pasurie nga prindërit e bashkëshortes së subjektit, që në vitin 2006. Pra, në momentin e deklarimit të pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk ka qenë duke e përdorur këtë pasuri, por kjo pasuri nuk ka qenë as në pronësi të prindërve të bashkëshortes së tij që prej rreth 10 vjetësh. Në këto rrethana, në vijim të jurisprudencës së Kolegjit²⁵, duke konstatuar gjithashtu se nuk rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit të Komisionit, të dhëna apo dyshime që kjo pasuri në emër të prindërve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është një pasuri e fshehur e tij, situatë e cila do të legjitimonte Komisionin të bënte hetime në këtë drejtim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit janë trajtuar si persona të tjerë të lidhur jo në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, për pasojë, detyrimi që Komisioni i ngarkon subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të apartamentit me sipërfaqe 53,2 m² është një detyrim në tejkallim të parashikimeve ligjore dhe nuk mund të shërbejë kjo rrethanë si një shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.
148. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi u shqyrtuan shkaqet e ankimit, parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, provat e administruara në dosje, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61, pika 3, për këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
149. Trupi gjykues i Kolegjit, në mbështetje të nenit Dh, pika 4, fjalia e dytë e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se vendimi nr. 171, datë 26.06.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi.

²⁵ Sipas jurisprudencës së Kolegjit, Komisioni nuk kufizohet të bëjë hetimet e duhura për të verifikuar dyshimet e ngritura se pasuritë, të cilat edhe pse nuk ngarkohen me barrën e provimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, janë pasuri të fshehura të vetë subjektit të rivlerësimit.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 09.02.2021.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi – kundër

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Ne – gjyqtaret Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues dhe gjyqtare Rezarta Schuetz, anëtare e trupit gjykues – jemi dakord me shumicën për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 171, datë 26.06.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi, por ndajmë mendim ndryshe lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë në këtë çështje. Në vlerësimin tonë, subjekti ka pasur tendencë të ndërmarrë hapa për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe burimin e krijimit të këtyre pasurive, në kundërshtim me përcaktimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për pasojë, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 edhe për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
2. Ndajmë mendim të ndryshëm me shumicën për sa u përket disa aspekteve të vlerësimit të pasurisë, të cilat duhet të përbënin shkak në mbështetje të lënies në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) për rivlerësimin e këtij subjekti për sa i përket pasurisë apartament banimi [me sip. 169,65 m², rruga {***}, {***}, ap. {***}], Tiranë²⁶ dhe likuiditeteve të deklaruara²⁷. Në konkluzionet përfundimtare, për sa i përket kriterit të kontrollit të pasurisë për këto dy elemente, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij dhe ka kryer deklarim të rremë në deklaratën *vetting* për burimin e krijimit të këtyre pasurive. Sa i përket elementit tjetër përbërës të kriterit pasuror, pasuritë e personave të tjerë të lidhur, ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, e konkretisht që në rastet kur nevojitet të kryhen hetime për të verifikuar dyshime për pasuri të fshehura të vetë subjekteve, Komisioni nuk duhet të kufizohet në kryerjen e hetimeve.
3. Më konkretisht, sa i përket apartamentit me sipërfaqe 169,65 m² në Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë apartament në deklaratën e interesave periodikë vjetorë (në vijim “DIPV”) për vitin 2014. Sipas DIPV-së, është pasuri e përfituar nga shkëmbimi i një apartamenti banimi me sipërfaqe 82,30 m², ndodhur në lagjen {***}, Tiranë [në pronësi të subjektit të rivlerësimit], me një apartament me sipërfaqe 169,65 m² në Tiranë, në pronësi të z. A. R.. Shkëmbimi është kryer nëpërmjet një deklarate noteriale [nr rep- {***}, dhe nr. kol- {***}] të datës 17.02.2014. Vlera e apartamenteve është respektivisht 8.065.400 lekë dhe 22.902.750 lekë. Të nesërmen, më 18.02.2014, palët kanë nënshkruar një deklaratë të *panoterizuar*, sipas së cilës, përveç apartamentit prej 82,3 m², z. R. do të përfitojë nga subjekti edhe një pagesë prej 7.200.000 lekësh, të ndarë në dy pjesë: 4.000.000 lekë në ditën e deklarimit [18.02.2014], ndërsa pjesa tjetër prej 3.200.000 lekësh do të paguhet nga subjekti i rivlerësimit brenda 8 vjetësh, gradualisht, dhe sipas kushteve që do të përcaktoheshin më vonë. Me fjalë të tjera, i vetmi detyrimi financiar që passillte ky transaksion *nuk* është parashikuar nga palët në kontratën e shkëmbimit, që përbën dokumentin më të rëndësishëm në këtë veprim juridik. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm qoftë në procesin e zhvilluar në Komision apo edhe atë në Kolegj, arsyet për këtë zgjedhje të palëve për të heshtur në kontratën e shkëmbimit mbi këtë detyrim. Përpos këtyre

²⁶ Shtjelluar në paragrafët 46-102 të vendimit të Komisionit: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/07/Vendim-Eugen-Beci.pdf>.

²⁷ Shtjelluar në paragrafët 103-109 të vendimit të Komisionit.

rrethanave, është me rëndësi të theksohet se duke pranuar këtë përcaktim joformal të palëve, z. R. ka pranuar të përfitojë një apartament me humbje prej përreth 7,6 milionë lekësh, përpos vlerës së shtuar si detyrim nga palët të nesërmen e kontratës. Konkretisht, z. R. ka dhënë apartamentin me sipërfaqe 169,65 m² dhe vlerë 22.902.750 lekë e në shkëmbim ka përfituar një apartament me sipërfaqe 82,3 m² dhe vlerë 15.265.400 lekë (8.065.400 lekë plus 7.200.000 lekë). Së fundmi, përveç heqjes dorë nga 7,6 milionë lekë, z. R. ka pranuar edhe që vlerën prej 3.200.000 lekësh do ta përfitonte vetëm në vitin 2022 (tetë vjet, sipas kushteve të këmbimit të specifikuar nga palët). Ky kusht i fundit është përcaktuar nëpërmjet një deklarate së cilës i mungojnë gjithë elementet formale e provuese të sa pretendohet, kryer jashtë zyrës noteriale, një ditë pas zyrtarizmit të shkëmbimit të apartamenteve.

4. Subjekti i rivlerësimit nuk ishte bindës për të sqaruar arsyet përse ky këmbim është pranuar nga z. R. në një disfavor të qartë dhe në mospërputhje me çdo logjikë ekonomike. Sipas shpjegimit të subjektit, ky favorizim – minimalisht për një vlerë prej 7,6 milionë lekësh – ishte pasojë e marrëdhënies miqësore mes subjektit të rivlerësimit dhe këtij individi. Në vlerësimin tonë, këto shpjegime ishin të pasinqerta dhe përbëjnë përpjekje për paraqitje në mënyrë të pasaktë të pasurisë. Në konsideratë të faktit që vendimi i Komisionit hesht për këtë element të hetuar gjatë hetimit administrativ, shpjegimet e subjektit dhe faktet e cituara më sipër duhet të vlerësoheshin së bashku me sa shtjellohet në vijim, si pjesë përbërëse e detyrimeve të subjektit për të deklaruar plotësisht e saktësisht pasuritë në pronësi e përdorim dhe burimet e ligjshme të tyre, nën dritën e pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.
5. Po ashtu, rezulton se në deklaratën periodike për vitin 2014 dhe në deklaratën e pasurisë (në vijim “deklarata *vetting*”), subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shuma prej 4,4 milionë lekësh, shlyer z. R. sipas deklaratës jonoteriale të datës 18.02.2014, ka si burim huanë nga dy vëllezërit e subjektit të rivlerësimit, në shumën 2 milionë lekë secili dhe kursimet e subjektit në vlerën 400.000 lekë. Komisioni ka konstatuar se dokumentacioni i sjellë nga subjekti për të provuar huatë prej 4 milionë lekësh nga vëllezërit konsiston në dy deklarata pa datë, pa nënshkrime të vërtetuara, jo në prani të noterit. Së fundmi, asnjëri prej deklaruesve nuk rezulton të ketë qenë në Republikën e Shqipërisë në datën e referuar prej tyre si *data e dhënies së huasë* [15.02.2014], sipas verifikimit në sistemin TIMS të hyrje-daljeve në pikat e kalimit të kufirit. Sipas Komisionit, vullneti i pavesuar i deklaruesve nuk konfirmohet nga këto shkresa të sjella, ndërsa deklaratat noteriale të kryera prej këtyre individëve në vitin 2018, gjatë hetimit administrativ, kanë vlerë të kufizuar provuese. Në përfundim, Komisioni vendosi të mos i merrte në konsideratë huatë në fjalë në dritën e mungesës së dokumentacionit për të provuar kthimin e huave nga subjekti i rivlerësimit, sipas kushteve të përcaktuara në deklaratën fillestare [pa datë] të huadhënësve.

Vlerësojmë se konkluzioni i Komisionit për këtë element, pavarësisht se ka abstraguar nga analiza në tërësi e rrethanave të krijimit të kësaj pasurie (shih edhe më sipër, paragrafin 4), është i saktë dhe duhet të ishte pranuar. Komisioni me të drejtë ka konstatuar se mungojnë prova që të konfirmojnë dhënien apo kthimin e kësaj huaje. Qëndrimi i shumicës së subjektit ishte bindës²⁸, për sa kohë e ka deklaruar huanë në deklaratën për vitin 2014, përbën alogjizëm. Ky vlerësim ka

²⁸ Paragrafi 111 i arsytimit të shumicës për pasurinë.

në konsideratë faktin që, ndërsa pasuri apo të ardhura të cilat *nuk* janë deklaruar në deklaratat periodike, nuk mund të shërbejnë për të provuar ekzistencën e një burimi të ligjshëm pasurish apo të ardhurash në mënyrë prapavepruese [gjatë procesit të rivlerësimit], vetëm fakti që një burim fitimi/marrëdhënie juridike është deklaruar në deklarata/t periodike – dokumente zyrtare të cilat në themel bazohen në thënie të njëanshme – nuk nënkupton automatikisht ekzistencën e burimit në sasinë apo rrethanat e deklaruara. Kjo premisë do të ishte një gabim deduksioni logjik, në të cilin vërtetësia e thënieve do të konstatohej e provuar, meqenëse subjekti ka treguar kujdes të deklarojë një burim të caktuar, pavarësisht nga mungesa e dokumentacionit shoqërues-provues që përmbush kriteret e kërkuara nga ligji lidhur me ligjshmërinë në formë dhe përmbajtje. Me fjalë të tjera, deklaratat periodike vjetore përbëjnë provë. Si çdo provë, në zbatim edhe të përcaktimit të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, deklaratimet e subjektit në vitin 2014 duhet të analizohen për pajtueshmërinë me provat e sjella nga subjekti dhe këto të fundit – deklaratat pa datë të vëllezërve – për besueshmërinë e tyre. Në përmbledhje, theksojmë që në analizë të të gjithë dinamikës dhe elementeve përbërëse të shtjelluar, trupi gjykues i Kolegjit duhet të kishte analizuar shpjegimet e subjektit në mënyrë kritike dhe në tërësi me gjithë elementet e tjera që përbëjnë kriterin e kontrollit pasuror. Në vlerësimin tonë, analiza e shumicës, bazuar për këtë element vetëm te bilanci negativ i reduktuar dhe vetëm për vitin 2014, pas pranimit të gjithë problemeve të evidentuara lidhur me krijimin e kësaj pasurie, përbën qasje fragmentarizuese dhe abstragon nga vlerësimi tërësor i pasurisë për subjektin që duhet të kalonte testin e përcaktuar nga neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 për sa i përket besueshmërisë së subjektit në vlerësimin e pasurisë.

6. Sa i përket apartamentit fillestar²⁹, të blerë në vitin 2007, rezulton se në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim i krijimit ka shërbyer kredia prej 5.000.000 lekësh, e marrë më datë 19.12.2006 pranë bankës Raiffeisen, dhe 200.000 lekë kursime. Sipas dokumentacionit në fashikull, mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShA është lidhur kontrata e sipërmarrjes e datës 03.10.2006. Sipas kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit do të paguante për këtë apartament **vlerën 5.900.000 lekë**, nga të cilat 900.000 lekë me nënshkrimin e kontratës, si dhe 5.000.000 lekë deri më 20 dhjetor 2006.
7. Nga dokumentacioni i administruar, Komisioni ka konstatuar se kontrata e mësipërme ishte fiktive dhe është kryer vetëm për efekt të përfitimit të kredisë në kushte lehtësuese nga subjekti. Ky konkluzion i Komisionit bazohet në tetë (8) elemente, përfshirë transaksionet bankare të kryera nga subjekti në muajt pas marrjes së kredisë, mospërputhjet mes palës shitëse sipas kontratës së sipërmarrjes përkundër asaj të specifikuar në kontratën e shitjes, mospërfshirjen e një garazhi në kontratën e sipërmarrjes që më pas figuron në kontratën e shitjes apo të vlerës së paguar për të, të cilën subjekti nuk e ka provuar me dokumentacion, mungesën e dokumentacionit që provon kryerjen e pagesës sipas kalendarit të përcaktuar nga palët, faktit të pranuar që subjekti ka jetuar në këtë apartament edhe përpara hartimit të kontratës së sipërmarrjes, si dhe kredisë së marrë nga Tirana Bank për mobilim banese dhe shlyer përpara kontratës së sipërmarrjes së tetorit 2006³⁰.

²⁹ Apartamenti me sipërfaqe 82,30 m², *kati i pestë* i godinës 9-katëshe, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.

³⁰ *Shih faqen 10, paragrafi 69 i vendimit të Komisionit: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2019/07/Vendim-Eugen-Beci.pdf>.*

8. Vlerësojmë se konkluzioni i Komisionit se kontrata e sipërmarrjes përbën veprim fiktiv, kryer vetëm për efekt të përfitimit të kredisë në kushte lehtësuese, është i drejtë për të gjitha elementet e shtjelluara më sipër. Nga ana tjetër, arsyetimi i shumicës që në thelb konsiston në argumentin se rrethanat nuk të çojnë domosdoshmërisht në konkluzionin se kontrata e sipërmarrjes ishte fiktive, meqenëse subjekti gjithsesi dispononte një apartament në të njëjtën ndërtesë, në vlerësimin tonë anashkalon rrethana faktike me rëndësi, të shtjelluara në paragrafin 8 (më sipër) dhe në vendimin e Komisionit. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit (ndër të tjera, riprodhuar në faqet 8, 9 dhe 10 të vendimit të Komisionit), edhe për këtë element, ishin jobindëse.
9. Sjellim në vëmendje, së pari, se transaksionet bankare të kryera nga subjekti pas disbursimit të kredisë më 26.12.2006, në harkun kohor mes fund dhjetorit 2006 dhe marsit 2007, haptazi bien ndesh me kushtet e kontratës së sipërmarrjes sipas së cilës, dita e disbursimit të kredisë do të nënkuptonte shlyerjen e gjithë vlerës së detyruar, duke i kaluar gjithë fondet e përfituara nga kredia sipërmarrësit, në momentin e disbursimit. Transaksionet bankare të kryera nga subjekti pas marrjes së kredisë, që konsistojnë të gjitha në tërheqje shumëash që nuk përputhen me asnjë nga dy kështet e kontratës së sipërmarrjes³¹, dhe në mungesë të çdo dokumenti financiar (mandatpagesë apo mandatarkëtim) për të dokumentuar shlyerjen e kësaj vlere ndaj shoqërisë ndërtuese “{***}” ShA, janë vetëm një nga elementet që vë në pikëpyetje vlerën e kontratës së sipërmarrjes. Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit³² se i ka paguar *cash* kështet përfaqësuesit të shoqërisë së ndërtimit me të cilin u lidh kontrata e sipërmarrjes, nuk qartësoi përse mënyra dhe koha e pagesës bie ndesh me kontratën e sipërmarrjes.
10. Së dyti, kontrata e sipërmarrjes bie ndesh edhe me kontratën e shitjes. Konkretisht, ndërsa e para [kontrata e sipërmarrjes, 03.10.2006] është lidhur mes subjektit të rivlerësimit me {***} sh.a., kontrata e shitjes është lidhur me shitësin M. Z. [në datën 11.6.2007]. Vlera e apartamentit sipas kontratës së shitjes, e shlyer *tërësisht jashtë zyrës noteriale*, përcaktohet në 5.200.000 lekë. Pyetur për këtë mospërputhje mes kontratës së porosisë dhe asaj të shitjes sa u përket palëve kontraktore, subjekti i rivlerësimit parashtroi se z. M. Z. ishte bashkëpronar në truallin ku u ndërtua pallati dhe meqenëse firma “{***}” kryente edhe shitjen e apartamenteve në pronësi të pronarëve të truallit, kontrata u hartua në emër të këtij individi. Subjekti u shpreh se pagesat i janë shlyer vetëm ndërtuesit, firmës “{***}”.
11. Së treti, në kontratën e shitjes, palët nuk rezultojnë t’i jenë referuar as kontratës së sipërmarrjes dhe as pagesave të parashikuara atje. Apartamenti është regjistruar më datë 05.06.2007 dhe referohet të jetë në katin e katërt të godinës 9-katëshe në rrugën “{***}”, Tiranë. Në deklaratën e interesave private për vitin 2007, subjekti ka deklaruar vlerën e blerjes së apartamentit dhe regjistrimin në ZVRPP me vlerë përfundimtare 5,2 milionë lekë dhe prenotim garazhi me sip. 10 m² në të njëjtën

³¹ *Shih detajet në faqen 8, paragrafi 51 të vendimit të Komisionit. Subjekti ka konvertuar në euro 3.090.000 lekë ditën e disbursimit të kredisë dhe tërhequr këtë vlerë në euro një ditë më pas. Po ashtu, subjekti ka kaluar një sasi në depozitë fleksi dy ditë më pas (më 28.12.2006) vlerën prej 1.700.000 lekë e tërhequr 1 milionë lekë në 4 dhe 5 janar 2007, 500.000 lekë dhe edhe 201.285 mijë lekë respektivisht në 15 dhe 16 mars 2007, transaksione që nuk përputhen me datat e pagesave sipas kontratës së sipërmarrjes në dy kështe prej 900.000 lekë dhe 5 milionë lekë, përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së tetorit 2006.*

³² *Pyetësori i datës 13.3.2019 gjatë hetimit në Komision.*

adresë me apartamentin me vlerë 700.000 lekë brenda vlerës së kontratës së mësipërme me firmën ndërtuese “{***}”, nga të cilat 200.000 lekë paguar nga shoqëria. Në asnjë deklaratë më pas nuk ka referim të mosmarrja e këtij garazhi sipas porosisë apo kthimi i pagesës së deklaruar si e kryer në DIPV-në e vitit 2007. Pyetur në Komision mbi këtë fakt, subjekti u shpreh se ndërsa çmimi i shitjes ishte përcaktuar në vlerën 5,9 milionë lekë, që përfshinte edhe porosinë për blerjen e një garazhi, ai ka paguar vetëm 5,2 milionë lekë pasi e nuk bleu garazhin asnjëherë. Subjekti nuk provoi me asnjë dokumentacion pagesën e pretenduar të kryer sipas kontratës së sipërmarrjes, apo pagesën dhe më pas kthimin e shumës që i përkiste një garazhi. Këto fakte, shumica i ka vlerësuar vetëm në drejtim të proporcionalitetit të mungesës së burimeve të ligjshme për të kryer pagesën prej 5,9 milionë lekësh, ndërsa shpjegimet e subjektit nuk janë analizuar në drejtim të detyrimeve të tij sipas nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, për sa i përket besueshmërisë së vlerësimit pasuror.

12. Së fundmi, bindja jonë se kontrata e sipërmarrjes e tetorit 2006 ishte fiktive bazohet edhe në faktin që subjekti jetonte në këtë apartament që prej qershorit të atij viti, kohë që përkon edhe me kredinë prej 600.000 lekësh, marrë në Tirana Bank në datën 05.06.2006. Në thelb, rezulton që subjekti ka deklaruar në DIPV-në për vitin 2006 një kredi për blerje mobilieje për një apartament që sipas dokumentacionit u porositi 4 muaj më pas [në tetor 2006]. Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision se kishte qenë një *keqkuptim* dhe kredia kishte për qëllim të shërbente për mobilimin e apartamentit që *do të blinte*, është jobindës. Në përgjigje të pyetësorit³³, lidhur me shlyerjen e kësaj kredie, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se e mori [kreditin] pasi priste që mobilimi të kushtonte më tepër fonde sesa kishte ai nga kursimet dhe e shleu menjëherë pasi konstatoi se në fakt, kishte kursime të mjaftueshme. Përkundër sa më sipër, dy vjet më herët, më datë 05.09.2016, i pyetur nga ILDKPKI-ja, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këtë kredi e ka përdorur në fakt për mobilimin e apartamentit.
13. Në përmbledhje të sa më sipër, rezulton se për të njëjtin apartament janë hartuar dy kontrata të ndryshme për sa i përket vlerës së kontratës dhe për sa u përket palëve. Më tej, transaksionet bankare pas disbursimit të kredisë – disbursimi i së cilës ishte kusht themelor për përmbushjen e kontratës së sipërmarrjes – bien ndesh me përcaktimet e kontratës. Mënyra e kryerjes së pagesës pretenduar nga subjekti, mbeti në nivel deklarativ e nuk mbështetet në asnjë dokumentacion³⁴. Subjekti ka jetuar në apartament disa muaj më herët nga lidhja e kontratës së sipërmarrjes dhe ka marrë një kredi për mobilim – të cilën pretendon në kundërshtim me si është shprehur në ILDKPKI, nuk e ka përdorur – për një apartament që *nuk e kishte*, por që rezulton se e përdorte. Për të gjitha këto fakte dhe mospërputhje, konkluzioni i Komisionit, për sa i përket fiktivitetit të kontratës, është i drejtë, ndërsa konkluzioni i shumicës bie ndesh me logjikën e thjeshtë të fakteve. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit u tregua i pasinqertë, në mospërputhje me detyrimet e tij në procesin e rivlerësimit.

³³ Datë 26.12.2018.

³⁴ Ndërsa në kontratën e shitjes palët janë shprehur se apartamenti është parapaguar jashtë zyrës noteriale – në vlerën 5.200.000 lekë – në deklaratën veting subjekti ka deklaruar se ai ende paguan kredinë për apartamentin që tashmë i ka kaluar në pronësi z. A. R. nëpërmjet kontratës së shkëmbimit.

14. Për këto arsye, për sa i përket apartamentit me sipërfaqe 82,30 m², i cili ka shërbyer si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 169,65 m², ndodhur në Tiranë, subjekti ka rezultuar me pasaktësi në deklarime, deklaram të pasaktë e që bie ndesh me kontratat dhe dokumentacionin e administruar në dosje. Në kushtet kur këto pasaktësi janë shoqëruar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, që tregojnë probleme serioze në vlerësimin e kriterit të pasurisë, të parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe në konsideratë të parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit, vendimi i Kolegjit duhej të mbështetej edhe në kriterin pasuror të vlerësimit për këtë subjekt. Në analizë të këtij elementi dhe deklaramit jobindës nga subjekti në dritën e detyrimeve që rrjedhin nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, së bashku me konkluzionet më sipër për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme, subjekti është në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për kriterin e pasurisë.
15. Në të njëjtën linjë, në mbështetje të qëndrimit të Komisionit për sa i përket mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e likuiditeteve për vitin 2009 dhe pretendimeve të subjektit në *procesin e rivlerësimit* se shkollimi i djalit është financuar nga personat e tjerë të lidhur, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit, edhe për këtë element, duhet të ishte konstatuar se gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë për kriterin e pasurisë dhe të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
16. Bazuar në gjithë elementet e analizuara më sipër, shumica duhej të konkludonte se subjekti nuk kishte arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë³⁵, pasi nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie, siç përcakton neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ka mungesë të të ardhurave për shkëmbimin e apartamenteve në vitin 2014 dhe ka kryer deklaram të rremë në deklaramtën *vetting* për burimin e krijimit të të ardhurave. Ky qëndrim bazohet në analizën e përfitimit nga ana e subjektit të një pasurie me vlerë të konsiderueshme më të lartë sesa ajo që ofronte nëpërmjet shkëmbimit, përcaktimin e të vetmit detyrim monetar në një shkresë joformale një ditë pas kontratës së këmbimit, si dhe problemeve me dokumentacionin provues të huasë së pretenduar të subjektit të rivlerësimit nga vëllezërit apo mungesës së gjurmëve që do të provonin qoftë edhe indirekt dhënien apo marrjen e saj, si dhe elementet e shtjelluara në detaj më sipër sa i përket kontratës fiktive të sipërmarrjes, apo pretendimin e subjektit vetëm *gjatë procesit të rivlerësimit* për përfitime financiare nga personat e tjerë të lidhur për shkollimin privat të djalit dhe, së fundmi, shpjegimet jobindëse të subjektit.
17. Për sa më sipër, vendosëm për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit për deklaram të pamjaftueshëm për dy kritere: atë të kontrollit të figurës dhe atë të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

³⁵ Neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi kundër vendimit nr. 171, datë 26.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), nëpërmjet të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit të mësipërm të Komisionit dhe është konfirmuar shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi, prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda në Tiranë.
2. Në mënyrë të përmbledhur, Komisioni ka mbështetur vendimin e tij të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit Eugen Beçi, bazuar në konkluzione të lidhura me kriteret e kontrollit të figurës dhe të kontrollit të pasurisë, duke konkluduar se:
 - (v) *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me parashikimet e shkronjës “g” të kreut V, “Të dhëna për sigurinë”, si dhe ka fshehur fakte të ndodhura sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.*
 - (vi) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
 - (vii) *Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për burimin e krijimit të këtyre pasurive.*
 - (viii) *Bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe të pasurisë.*
3. Shumica e trupit gjykues në Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ka konkluduar se:
 - i. Konkluzioni i Komisionit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, është i pabazuar, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61, pika 3, për këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
 - ii. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën e rivlerësimit për kontrollin e figurës, në mënyrë të pasaktë dhe jo me vërtetësi për mosdeklarimin nga ana e tij të revokimit të vizës, në kundërshtim me kërkesat e nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ne Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), veprim ky që sjell si pasojë dhe mosbesueshmërinë e këtij subjekti, si dhe papërshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës.
4. Sa u përket fakteve të rezultuara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe të analizuara edhe nga shumica në vendim, ato nuk do të citohen në mënyrë të detajuar, përveçse kur do të nevojiten gjatë arsyetimit në këtë mendim pakice. Gjithashtu çështjet të cilat nuk janë vlerësuar, arsyetuar

dhe konkluduar në mënyrë të posaçme në këtë mendim pakice, i konsideroj të bazuara në ligj dhe prova, ashtu si dhe shumica ka mbajtur qëndrim në vendimin e saj.

5. Lidhur me përfundimin e dhënë në vendim për kontrollin e kriterit të pasurisë, kam të njëjtin qëndrim me shumicën³⁶, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61, pika 3, për këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; pra ai ka arritur nivelin e besueshmërisë sipas nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 për kriterin e pasurisë.
6. Në vlerësimin tim, shkelja e subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi, e konstatuar si pasaktësi në plotësimin e deklaratës së rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës:
 - a. nuk duhej të konsiderohej si një shkelje e cila mund të passillte shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas përcaktimeve të nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016; si dhe
 - b. si e vetme, nuk qëndronte në proporcion të drejtë me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra të magjistratit në kuptim të këtij procesi.
7. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit për kriterin e figurës, revokimin e vizës nga ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Në analizë të këtij fakti, çmoj se çështjet që duhet të vlerësohen për të konkluduar për zgjidhjen, janë si më poshtë.
 1. *A gjendemi para situatës së përpjekjes së subjektit për të paraqitur të dhëna të pasakta me qëllim krijimin e vështirësive për të zbuluar të vërteta dhe fakte rreth figurës së tij, posaçërisht kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar?*
 2. *Deklarimi apo mosdeklarimi i revokimit të vizës/refuzimit të hyrjes, a mund të passjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, si dhe a është i mjaftueshëm për mosarritjen e nivelit të besueshmërisë sipas nenit 59, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016?*
8. Si gjyqtare në pakicë, ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket konkluzionit se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën e rivlerësimit për kontrollin e figurës në mënyrë të pasaktë duke mos deklaruar faktin e revokimit të vizës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), por bazuar në aktet e administruara gjatë procesit në Komision dhe në Kolegj, në interpretim të nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, kam votuar kundër konkluzionit të shumicës për sa i përket zgjidhjes së çështjes.
9. Subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi, me pyetjen e shtruar në deklaratën e rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës, nëse i ishte refuzuar hyrja në një shtet të BE/NATO, do të duhej të kuptonte çdo ndalim të bërë ndaj tij për të hyrë në një shtet të BE/NATO, qoftë nëpërmjet revokimit/refuzimit të një vize, apo nëpërmjet refuzimit fizikisht të hyrjes në një shtet, në pikën e tij kufitare. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit, duke qenë se i ishte revokuar viza e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe pasja e një vize është parakusht i domosdoshëm për të hyrë në këtë shtet, do të duhej që në analizë dhe në një interpretim më të thelluar, t’i ishte përgjigjur me “po” pyetjes së vendosur në pikën 5, shkronja “g” e deklaratës së rivlerësimit, për kontrollin e kriterit të figurës. Në konkluzion të sa arsyetova më sipër, vlen të theksohet se refuzimi i hyrjes në një shtet nuk është i njëjtë me atë të refuzimit/revokimit të vizës, por revokimi apo mospasja e një vize

³⁶ Së bashku me gjyqtarët Ardian Hajdari dhe Sokol Çomo.

të vlefshme përbën një pengesë objektive për të hyrë në territorin e një shteti, pra për rrjedhojë “revokimi i vizës” passjell edhe “refuzimin e hyrjes”.

I. A gjendemi para situatës së përpjekjes së subjektit për të paraqitur të dhëna të pasakta me qëllim krijimin e vështirësive për të zbuluar të vërteta dhe fakte rreth figurës së tij, posaçërisht kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar? Deklarimi apo mosdeklarimi i revokimit të vizës/refuzimit të hyrjes, a mund të passjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë shkarkimin e subjektit të rivlerësimit?

10. Për të vlerësuar nëse ka pasur një përpjekje nga subjekti i rivlerësimit për të paraqitur të dhëna të pasakta me qëllim krijimin e vështirësive për të zbuluar të vërteta dhe fakte në kuadër të procesit të rivlerësimit, fillimisht dëshiroj të ndalem për të arsyetuar se përse është vendosur detyrimi që subjektet të paraqesin të dhëna të sakta në deklaratën e rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës.

Neni Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës përcakton se: *Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, ose të fshehë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.* Ligjvënësi, lidhur me deklaratimet e pavërteta apo të pasakta në deklaratën e rivlerësimit për figurën, kërkon që të provohet “përpjekja” e subjektit të rivlerësimit për këtë mosdeklarim për t’u kualifikuar si shkelje në kuptim të nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, përpjekje kjo që së bashku me deklarinin e pasaktë do të sjellë si pasojë edhe masën e shkarkimit nga detyra. Gjithashtu, ligjvënësi ka bërë një dallim të qartë duke mos e konsideruar mosdeklarimin e çdo fakti prej subjektit të rivlerësimit si “fshehje”, por nocionin e “fshehjes”, ligjvënësi në këtë pikë të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës e ka lidhur ngushtësisht vetëm me atë të fshehjes së kontakteve të papërshtatshme me krimin e organizuar, dhe në asnjë rast me fshehjen e rrethanave të tjera, siç mund të jetë edhe “revokimi i vizës”, sipas pikës 5, germa “g” e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë mënyrë, ligjvënësi i ka dhënë një peshë të rëndësishme faktit të fshehjes së kontaktit të papërshtatshëm me një person të krimit të organizuar, duke e konsideruar atë si të mjaftueshëm për të vendosur masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

11. Vlerësoj se pyetjet e përfshira në pikën 5 të shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 synonin të merrnin nga subjektet e rivlerësimit deklarime lidhur me kontakte të papërshtatshme të krimit të organizuar apo për mënyra ndërveprimi të paligjshme me ta³⁷. Nëse do të mbahen në konsideratë përcaktimet e mësipër arsyetuar të germës Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, dhe të interpretohen ato të ndërlidhura me përcaktimet e pikës 1 të nenit Dh të këtij Aneksi si dhe me nenet 34³⁸, 35³⁹, 37⁴⁰,

³⁷ Për më shumë, referojuni kontekstit në të cilin ato janë formuluar në të gjitha gerrat e pikës 5, përjashtuar nga ky kontekst vetëm gerrat “g” dhe “gj” të saj.

³⁸ Neni 34: “Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës (neni 34 i ligjit)”.

³⁹ Neni 35:

“1. **Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.**

2. **Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar fillon menjëherë procedurën e kontrollit të figurës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4, si dhe të neneve 37 dhe 38 të këtij ligji.”**

⁴⁰ Neni 37: “Grupi i punës, gjatë procedurave të kontrollit të figurës, duhet të bëjë:

a) verifikimin e saktë të identitetit në të shkuarën dhe të tashmen, për çdo individ;

39, pika 2 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoj se në të gjitha këto dispozita kërkohet që pasaktësitë e konstatuara në formularin e kontrollit të figurës, së pari të tregojnë përpjekjen e subjektit të rivlerësimit për të bërë deklaratime të pavërteta apo të pasakta, dhe së dyti një paraqitje e pavërtetë dhe e pasaktë e tyre të bëhet me qëllim që të vështirësojë punën e organeve për të realizuar kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, duke i pamundësuar ato në njohjen e gjithë të vërtetave të subjektit, sa u përket kontakteve të papërshtatshme me krimin e organizuar dhe kriterit të figurës.

12. Ligjvënësi, nëpërmjet përcaktimeve të pikës 5, shkronja “g”⁴¹ e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, ka synuar mbledhjen e informacioneve sa më të vërteta dhe të plota, veçanërisht për të dhëna që nuk janë lehtësisht të verifikueshme apo të zbulueshme. Për këtë qëllim, ligjvënësi ka parashikuar në nenet 35 dhe 37 të ligjit nr. 84/2016, që pas dorëzimit të formularit:
 - a. fillon kryerja e verifikimeve nga grupi i përbashkët i punës i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK-së), në të cilin bëjnë pjesë edhe agjenci ligjzbatuese, për të grumbulluar informacione për subjektin e rivlerësimit;
 - b. mund të kryhen hetime për rrethana të veçanta në të cilat është shfaqur për këto organe subjekti i rivlerësimit;
 - c. mund të bashkëpunohet me agjenci të tjera ligjzbatuese partnere për të mbledhur informacione për subjektin e rivlerësimit.
13. Gjithashtu, institucionet e rivlerësimit, gjatë procesit të hetimit administrativ që ato realizojnë, mbikëqyren nga vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), të cilët, bazuar në nenin 49, pikat 10 dhe 11 të ligjit nr. 84/2016, mund të paraqesin “gjetje” apo “mendim”, nëse ata kanë informacione ose të dhëna lidhur me elemente të veçanta të kontrollit të figurës për subjektet e rivlerësimit, të cilat mund t’i nënshtrohen vlerësimit së bashku me gjithë provat e tjera për të konkluduar lidhur me kontrollin e figurës së tij. Sipas akteve të administruara në dosje, konstatohet se asnjë nga format e sipërcituara të paraqitjes së informacionit apo të dhënave nuk është referuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi.
14. Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi ka vetëdeklaruar në deklaratën e rivlerësimit për kontrollin e figurës, kontaktin e papërshtatshëm me individin F. S., madje dhe formën/mënyrën në të cilën ai ka rënë në kontakt me të. Komisioni në vendimin nr. 171, datë 26.06.2019, ka konkluduar se në bazë të nenit 38, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kontakti i subjektit të rivlerësimit me këtë person duhet konsideruar në rrethana lehtësuese, pra duke mos e konsideruar ekzistencën e këtij kontakti të papërshtatshëm të deklaruar, si shkak shkarkimi nga detyra sipas nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
15. Në raportin e grupit të punës së DSIK-së⁴², bëhet me dije që subjektit të rivlerësimit i është revokuar viza e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por në të si dhe në aktet e administruara në dosje nuk ka asnjë të dhënë tjetër për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me krimin e organizuar, tendenca kriminale për përfshirjen e tij në krimin e organizuar; apo nëse ai

b) verifikimin nëse ka tendenca kriminale për përfshirjen në krimin e organizuar;

c) vlerësimin e përgjithshëm, nëse individi mund të vihet nën presion nga struktura kriminale;

ç) kontrollin nëse ka qenë, është ose tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale”.

⁴¹ Në këtë paragraf të shkronjës “g” parashikohet deklarimi lidhur me refuzimin e hyrjes në një vend të BE/NATO.

⁴² Raporti i prillit 2019 i përgatitur me kontributin e të gjitha agjencive ligjzbatuese në Shqipëri.

mund të vihet nën presion nga struktura kriminale, si dhe të ketë tentuar të angazhohet apo bashkëpunojë me një organizatë kriminale.

16. Vlen të theksohet se subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi dhe institucionet e rivlerësimit, sipas akteve të administruara në dosje, nuk kanë pasur të dhëna lidhur me motivin e revokimit të vizës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në shkresën e datës 27 janar 2021 të zyrës konsullore të ambasadës së ShBA-së në Tiranë⁴³, e administruar në Kolegj në kuadër të gjykimit të çështjes në seancë publike, bëhet me dije se sipas nenit 222 të ligjit të Imigracionit dhe Kombësisë (INA) të ShBA-së, ndalohet dhënia e informacioneve në lidhje me të dhënat e vizës amerikane, pra subjekti i rivlerësimit, ashtu siç edhe pohoi në seancën publike në Kolegj, në momentin e revokimit të vizës nuk ka pasur dijeni për motivin e revokimit të saj.

Gjithashtu, sipas kësaj shkrese të zyrës konsullore të ambasadës së ShBA-së në Tiranë, theksohet se shumica e anulimit/revokimit të vizave bëhet sipas seksionit 214 (b) të këtij ligji. Në dispozitat e këtij seksioni të ligjit INA, konstatohet se shkaqet mund të jenë nga më të ndryshmet, por nuk nënkuptojnë që mbajtësi i vizës të konsiderohet se ka shkelur ndonjë ligj ose ka kryer ndonjë veprim skualifikues. Për më tepër, nëse i referohemi këtij seksioni, refuzimi/anulimi/revokimi i vizës sipas këtij seksioni madje nuk lejon edhe mundësinë e bërjes së një ankimi nga individët të cilët mund të kenë qenë subjekt i këtij veprimi. Duke pasur në konsideratë përcaktimet e seksionit 214 (b) të ligjit INA për shkaqet/rastet e mundshme të revokimit të vizës, si dhe bashkëpunimin e mëtejshëm që ka pasur subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi pas revokimit të vizës me sektorin e hetimeve penale në ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, certifikatën e falënderimit të datës 11 shkurt 2019⁴⁴ të firmosur nga shefi i këtij sektori të ambasadës së ShBA-së⁴⁵, mund të deduktohet që shkaqet e revokimit të vizës së nuk mund të kenë qenë të atij lloji siç e kërkojnë neni Dh i Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 37 dhe 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016⁴⁶.

17. Fakti i revokimit të vizës amerikane për të cilën subjekti është konsideruar i papërshtatshëm nga DSIK-ja, pasi nuk e ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës, lidhet me një informacion që mund të verifikohet nëpërmjet bashkëpunimit të standardizuar për qëllime të këtij procesi ndërmjet DSIK-së me ambasadat e vendeve të BE/NATO. Subjekti i rivlerësimit, siç rezulton nga aktet e administruara në fashikull, në përgjigje të pyetjeve të pyetësorit të parë, datë 21 tetor 2018, ka vetëdeklaruar revokimin e vizës amerikane, si dhe ka paraqitur bashkëngjitur përgjigjeve për këtë pyetësor fotokopjen e faqes së pasaportës ku është shënuar revokimi i vizës, edhe pse raporti i DSIK-së në të cilin evidentohet ky fakt është depozituar në Komision më datë 04.04.2019⁴⁷. Vetëm pas këtij deklarimi të subjektit, Komisioni⁴⁸, për shkak se raporti i datës 30 tetor 2017 i DSIK-së⁴⁹ kishte konkluduar për përshtatshmërinë tij, ka filluar

⁴³ Në përgjigje të kërkesës që përfaqësuesi ligjor i tij i kishte drejtuar në datën 23 janar 2021 zyrës konsullore të ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

⁴⁴ Administruar si provë në seancën publike në Kolegj.

⁴⁵ Certifikatë kjo e lëshuar nga një seksion i ambasadës së ShBA-së, edhe pse subjektit të rivlerësimit i ishte revokuar më 26 janar 2017 viza amerikane nga po kjo ambasadë.

⁴⁶ Kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, tendencë për t'u përfshirë në krimin e organizuar, apo ka ekzistuar mundësia e vënies nën presion nga struktura kriminale, si edhe që ai ka qenë ose tentohet të angazhohet fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale.

⁴⁷ Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. {***} prot., datë 04.04.2019 ka përcjellë në Komision

⁴⁸ Kërkesa është bërë për DSIK-në nga Komisioni me nr. {***} prot., datë 23.10.2018.

⁴⁹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 30.10.2017, është përcjellë në Komision raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Eugen Beçi, me konstatimin për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga ky subjekt rivlerësimi.

një komunikim zyrtar me DSIK-në dhe organet e tjera ligjzbatuese, të cilat kanë sjellë më pas një rishikim të raportit të DSIK-së të datës 30 tetor 2017. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij, në përgjigje të rezultateve paraprake të hetimit, në seancën dëgjimore në Komision, në ankim po edhe në seancën publike në Kolegj, ka theksuar se mosdeklarimi prej tij i revokimit të vizës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka qenë si rrjedhojë e një interpretimi që ai vetë i kishte bërë pyetjes në pikën 5, shkronja “g” e shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, dhe jo sepse ai kishte për qëllim mosdeklarimin e saj.

18. Në përfundim të gjithë sa parashtrova më sipër, duke pranuar se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë, duke dhënë përgjigje të gabuar për pikën 5, shkronja “g” e deklaratës së rivlerësimit për kontrollin e figurës, vlerësoj se nuk provohet përpjekja e tij për të mos deklaruar këtë të dhënë, për rrjedhojë konkludoj që nuk provohet se ekziston shkaku kushtetues i shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, pra përpjekja për të bërë një deklaram të pasaktë dhe të pavërtetë të faktit të revokimit të vizës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

II. Deklarimi apo mosdeklarimi i revokimit të vizës/refuzimit të hyrjes, a mund të passjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, si dhe a është i mjaftueshëm për mosarritjen e nivelit të besueshmërisë sipas nenit 59, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016?

19. Sipas nenit 38, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe në informacione të tjera të disponueshme. Ai duhet të zhvillohet nga institucionet e rivlerësimit në mënyrë objektive dhe pa ndikime të karakterit personal, armiqësor dhe miqësor, të cilat mund të favorizojnë ose disfavorizojnë subjektin e rivlerësimit. Për të realizuar një kontroll objektiv të figurës, duhet të kryhet një vlerësim i provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6 të nenit 38, dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të po këtij neni.
20. Vlerësoj se, nëse do të mbahen në konsideratë përcaktimet e nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, dhe të interpretohen ato të ndërlidhura me përcaktimet e pikës 1 të nenit Dh të këtij Aneksi, si dhe me nenet 34⁵⁰, 35⁵¹, 37⁵², 39 pika 2, dhe 61 pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të mbështetura në një vlerësim objektiv të pavesuar dhe disfavorizues për subjektin e rivlerësimit Eugen Beçi,

⁵⁰ Neni 34: “Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës (neni 34 i ligjit)”.

⁵¹ Neni 35:

“1. Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.

2. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar fillon menjëherë procedurën e kontrollit të figurës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4, si dhe të neneve 37 dhe 38 të këtij ligji”.

⁵² Neni 37: “Grupi i punës, gjatë procedurave të kontrollit të figurës, duhet të bëjë:

a) verifikimin e saktë të identitetit në të shkuarën dhe të tashmen, për çdo individ;

b) verifikimin nëse ka tendenca kriminale për përfshirjen në krimin e organizuar;

c) vlerësimin e përgjithshëm nëse individi mund të vihet nën presion nga struktura kriminale;

ç) kontrollin nëse ka qenë, është ose tenton të angazhohet fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale”.

mosdeklarimi i revokimit të vizës, si një fakt i vetëm, i pashoqëruar në këtë rast me përpjekjen e subjektit për të mos e bërë këtë deklaram, me qëllim fshehjen e një kontakti të papërshtatshëm me person të krimit të organizuar, nuk mund të kualifikohet si shkak shkarkimi nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

21. Sipas nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, një nga konkluzionet që duhet të ketë raporti i grupit të punës së DSIK-së, është ai nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Jurisprudenca e Kolegjit, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk e ka konsideruar një deklaram të pasaktë në kriterin e kontrollit të pasurisë sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, si të vetëm, të mjaftueshëm për t’u kualifikuar në kuptim të nenit 61, pika 3 e këtij ligji, nëse nuk provohet se nëpërmjet këtij deklarami të pasaktë, subjekti është përpjekur të fshehë një pasuri apo të pamundësojë verifikimin e burimit të ligjshëm për krijimin e një pasurie.
22. Bazuar në sa u referua në paragrafin më sipër, për analogji, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, vlerësoj se një deklaram i pasaktë dhe jo i vërtetë i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit për kriterin e figurës, mund të passjellë shkarkimin e tij nga detyra nëse provohet se, si rrjedhojë e këtij mosdeklarami, ai ka fshehur ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm të krimit të organizuar apo çdo rrethanë tjetër të përfshirjes së tij sipas përcaktimeve të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016.
Siç rezultoi e provuar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision dhe gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të krimit të organizuar, tendenca për t’u përfshirë në krimin e organizuar apo për t’u vendosur nën presionin e strukturave kriminale. Pra, mosdeklarimi i faktit të revokimit të vizës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk ka pasur për qëllim fshehjen e kontakteve të papërshtatshme apo vënien në pamundësi të institucioneve të rivlerësimit për verifikimin e figurës së tij.
23. Në vijim të arsytimit të mësipërm, merr rëndësi edhe vlerësimi: Si do të kualifikohej në kuadër të kontrollit të kriterit të figurës, situata hipotetike nëse subjekti i rivlerësimit do të kishte deklaram revokimin e vizës së ShBA-së në deklaratën e rivlerësimit të kontrollit të figurës, por gjatë hetimit nuk do të provohej që ai të kishte kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, apo nuk do të provohej asnjë rrethanë tjetër nga ato të parashikuara në nenin 37 të ligjit nr. 84/2016, si mospasja e tendencës për t’u përfshirë në krimin e organizuar, apo mundësia e vënies nën presion nga struktura kriminale, apo edhe qenia ose tentimi për t’u angazhuar fshehurazi, vetëm, në bashkëpunim, ose në përbërje të një organizate kriminale? A do të mund të vendosej masa “shkarkim nga detyra” vetëm për shkak të ekzistencës së faktit të revokimit të vizës, edhe pse i deklaram ky fakt në deklaratën e rivlerësimit të figurës, si dhe në kushtet kur vetë revokimi i vizës nuk është i parashikuar si një shkak i posaçëm, i vetëm, për shkarkimin nga detyra sipas nenit Dh, pikat 1 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 39 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016?
Në vlerësimin tim, një situatë e tillë faktike, e shoqëruar me një deklaram të saktë të revokimit të vizës në deklaratën e rivlerësimit për figurën, në kushtet e mungesës së ekzistencës së kontaktit të papërshtatshëm, apo situatave të tjera të parashikuara në nenin 37 të ligjit nr. 84/2016, në zbatim të nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të kualifikohej sipas neneve 61, pika 2 dhe 61, pika 3 e ligjit nr.84/2016, për rrjedhojë nuk mund të sillte si pasojë “shkarkimin nga detyra” të subjektit të rivlerësimit për kontrollin e kriterit të figurës.
24. Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, deklarami i pasaktë për faktin e revokimit të vizës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga

subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi në deklaratën e rivlerësimit për kriterin e figurës, si i vetëm, nuk mund të kualifikohet sipas nenit 39, pika 2 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë nuk mund të passjellë shkarkimin e tij nga detyra.

25. Arritja e “besueshmërisë” për kriterin e kontrollit të pasurisë apo dhe të figurës, realizohet nga institucionet e rivlerësimit nëpërmjet një procesi analizimi, vlerësimi dhe më tej konkludimi për çdo kriter, si bindje e tyre në analizë të fakteve, provave të administruara në proces dhe ligjit të zbatueshëm lidhur me to, përfshirë këtu edhe procesin e vlerësimit dhe bindjes që krijohet përfundimisht nëse një apo disa shkelje të subjekteve të rivlerësimit kualifikohen sipas nenit 61, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin tim, arritja e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit në një kriter, përfshirë edhe atë të figurës, është pjesë e bindjes që krijojnë trupat gjykuese, në kuadër të çdo konkluzioni për një fakt të caktuar. Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se për sa kohë që fakti i mosdeklarimit të revokimit të vizës në deklaratën e rivlerësimit për kriterin e figurës, si i vetëm, nuk mund të kualifikohet si shkak shkarkimi, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, mendoj se ky fakt gjithashtu nuk mund të ndikojë edhe në mosarritjen e nivelit të besueshmërisë sipas nenit 59, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

III. Mbi zgjidhjen e çështjes

26. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, në bazë të autoritetit diskrecional të gjykatës për zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, e konsideroj mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi, të faktit të revokimit të vizës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në deklaratën e rivlerësimit për kriterin e figurës:

- a. në mungesë të përpjekjes së tij për të mos bërë këtë deklaram, jo në përputhje me përcaktimet e nenit Dh, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe
- b. të pamjaftueshëm për t’u kualifikuar, si i vetëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Në këto kushte, vlerësoj se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke arritur në një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të figurës.

27. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit Eugen Beçi, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se nuk ka pasur një hetim dhe vlerësim për kriterin e aftësive profesionale, si dhe e gjendur në kushtet e pamundësisë për t’u shprehur me një vendim që zgjidh çështjen përfundimisht, kam çmuar se gjen vend aplikimi i nenit 66, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës vendimi nr. 171, datë 26.06.2019, duhet të priset dhe çështja t’i dërgohet për të vazhduar procesin e rivlerësimit Komisionit për kriterin e aftësive profesionale.
28. Siç edhe jam shprehur në pakicën e vendimit të Kolegjit (JR) nr. 28, datë 30.10.2019: *Kolegji si një gjykatë e shkallës së dytë që ka në juridiksionin e saj shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit, nuk mundet të bëjë një vlerësim parësor të procesit të rivlerësimit për kritere për të cilat Komisioni nuk ka ushtruar kompetencat e tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, edhe për shkak se në këtë mënyrë do të bënte të pazbatueshme të drejtën e subjektit për të ushtruar ankim ndaj këtij vendimi në versionin që do kishte një konkluzion negativ për kriteret e pashqyrtuara më parë, duke cenuar të drejtën për një ankim efektiv të parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Liritë Themelore të Njeriut.*

29. Bazuar në sa më sipër, përfundimisht çmoj se vendimi i Komisionit nr. 171, datë 26.06.2019, duhet të priset e çështja t'i dërgohet Komisionit për të vazhduar më tej me procedurën e rivlerësimit për kriterin e aftësive profesionale, deri në arritjen e një konkluzioni përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, në varësi të rezultateve të hetimit e konkluzioneve të nxjerra prej tyre.

GJYQTARE

ALBANA SHTYLLA

nënshkrimi